



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 6 SHTATOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 6 SEPTEMBRA 2012. GODINE**

**SHTATOR - SEPTEMBAR
2012**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Votimi i Projektrezolutës lidhur me përdorimin e tri (3) kodeve të huaja telefonike në Kosovë,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për kredi dhe projekte ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KFQW) lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtari kërkimore, shkencore, inovacione dhe teknologji,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin profesional,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji,
17. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-049 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Dnevni red

- 1 Vreme za deklarisanje van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Glasanje o N/rezolucije u vezi upotrebe tri (3) strana telefonska koda na Kosovu,
5. Razmatranje N/zakona o ratifikaciji Finansijskog sporazuma za kredit i projekat između Vlade Republike Kosova i Nemačke banke za razvoj (KFW) u vezi fabrike vode u Škabaju,
6. Prvo razmatranje N/zakona o penzijskoj šemi finansirane od države ,
7. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona o osnivanju sistema za osiguranje depozita za finansijske institucije Kosova,
8. Prvo razmatranje N/zakona o registrovanje u registru zaloga za pokretnu imovinu,
9. Prvo razmatranje N/zakona o istraživačkoj, naučnoj , inovativnoj i tehnološkoj delatnosti,
10. Prvo razmatranje N/zakona o profesionalnom obrazovanju i osposobljavanju,
11. Prvo razmatranje N/zakona o vladinim organima o informativnom društvu,
12. Prvo razmatranje N/zakona o davanju na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine,
13. Prvo razmatranje N/zakona o obrazovanju i osposobljavanju u Republici Kosova,
14. Drugo razmatranje N/zakona o putnoj i ekološkoj taksi vozila,
15. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona o štrajku,
16. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona o metrologiji
17. Razmatranje izveštaja Komisije za budžet i finansije za nadgledanje sprovođenja Zakona br. 03/L-049 o sprečavanju pranja novca i finansiranju terorizma.

Seancën e drejton kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, me kryetarët e grupeve parlamentare.

Të pranishëm janë 66 deputetë. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimet në emër të grupit 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta. Replika nuk ka. Fillojmë. Deputeti Berat Buzhala e ka fjalën.

BERAT BUZHALA: Në emrin tim personal.

Brenga që kisha dashur ta ngre lidhet me çmimin e naftës, që ka mbizotëruar gjatë gjithë kësaj vere në tregun e Kosovës, dhe për mënyrën se si këtë po e menaxhon Shoqata e Naftëtarëve. Unë mendoj që kjo shoqatë ka bërë marrëveshje të fshehta monopoliste me të gjithë tregtarët e naftës, e këtë e kanë dëshmuar çmimet gjatë verës që kanë qenë në kundërshtim me çmimin e naftës në tregun botërorë në bursë.

Gjatë muajit prill, çmimi për një barel naftë në bursa ka qenë shumë më i lartë se sa është tash. Ka qenë 130 dollarë, ndërsa gjatë gjithë verës ky çmim në bursë, gjatë korrikut dhe gushtit, ka qenë 113, 115, ose dje është mbyllur më 113. Ndërsa e kundërta ka ndodhur me çmimin e litrit të naftës në pompat e benzinës. Gjatë pranverës ka qenë çmimi maksimal 1 euro e 25 centë, ndërsa tash ka shkuar deri në 1 euro e 40 centë. Pse ka ndodhur kjo, shihet qartë se ka marrëveshje të fshehta dhe është shfrytëzuar, ose është keqpërdorur në mënyrë flagrante prania e Diasporës në Kosovë dhe rritja e kërkesës për naftë nga Diaspora, si dhe veturat e shumta që kanë ardhur këtu. Kjo, në kushte normale të tregut, do të duhej t'u lihej kompanive që shesin naftë, që ato ta përcaktojnë çmimin.

Mirëpo, Shoqata anti-monopol ose Bordi kundër monopolit na ka raportuar si komision para disa muajve sa ka zënë SMS-a të shitësve të naftës, me të cilët ata e përcaktonin çmimin e litrit të naftës. Kjo është në kundërshtim flagrant me ekonominë e lirë të tregut, prandaj në këtë do të duhej të ndërhynte Qeveria, do të duhej të ndërhynte Ministria e Tregtisë e Industrisë dhe Ministria e Ekonomisë, të cilat do të duhej t'ua merrnin licencat gjithë atyre kompanive të cilat janë zënë në marrëveshje të fshehta me njëra-tjetrën.

Çmimi i naftës i ka arritur pothuaj kuotat e Bashkimit Evropian, ku çmimi është diku 1,6 euro - 1,7 euro për litër, kurse këtu 1,4 euro. Mirëpo nëse i konsiderojmë taksat që janë këtu dhe taksat që janë atje, kemi të bëjmë me një dallim jashtëzakonisht të madh.

Prandaj, unë do të kërkoja prej të gjitha autoriteteve këtu që të ndërmarrin masa menjëhershme kundër të gjithë atyre importuesve, sidomos kundër Shoqatës së

Naftëtarëve, e cila për mendimin tim është një shoqatë kriminale, që më shumë merret me marrëveshje të fshehta, se sa me zhvillimin e ekonomisë së tregut. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Anton Quni e ka fjalën, në çfarë cilësie tregon vetë.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë dua ta ngre një shqetësim lidhur me implementimin e Ligjit për të drejtat dhe statusin e dëshmorëve, veteranëve, invalidëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Por, dua të fokusohem në punën e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Veteranëve të UÇK-së.

Ky Komision, sipas nenit 15, paragrafi 7, është në përbërje nga përfaqësuesit e Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale, të Forcës së Sigurisë, ish-Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ish-zonave operative të UÇK-së, Organizatës së Veteranëve, Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Shoqatës së Invalidëve të Luftës, ish-TMK-së, ish-Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe përfaqësuesit e tjerë, për të cilët vendos Qeveria.

Ligji në fjalë dhe nenet e specifikuar janë njëra ndër arsyet për të cilat veteranët që ishin në grevë urie u pajtuan ta lirojnë sheshin para Qeverisë së Kosovës. Ata nuk u larguan se ishin plotësisht të kënaqur me trajtimin me ligj dhe me premtimet nga autoritetet e Qeverisë, por nga fakti se ishin të vetëdijshëm për procedurat që duhet të ndiqen për ta vërtetuar numrin e saktë të veteranëve dhe pjesëmarrësve në luftën çlirimtare.

Po ashtu, u pajtuan që Qeverinë e Kosovës të mos e qesin në pozita të sikletshme në raport me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Edhe pse ishin të patrajtuar me ligj për 12 vjet me radhë, veteranët e UÇK-së u pajtuan që Komisioni për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Veteranit të UÇK-së të fillojë në afatin sa më të shkurtër, me ushtrimin e përgjegjësive të tyre.

Sot, pas një viti, ne ligjvënësit mësojmë që Komisioni i autorizuar ende nuk e ka bërë asnjë hap në përmbushjen e detyrave, përgjegjësive dhe premtimeve.

Nga ky Komision nuk është ftuar asnjë takim, nuk janë hartuar rregulloret e punës, nuk është përcaktuar dinamika e punës, nuk është ngrehur infrastruktura e nevojshme dhe nuk janë kërkuar fonde. Thjesht, Komisioni ishte nën çdo nivel të përgjegjësisë dhe, sipas disa vlerësimeve, ashtu mendohet të mbetet edhe për një kohë.

Unë, me një shembull dua ta ilustruj se si është zgjedhur problemi i veteranëve diku para 2000 vjetëve.

Para 2060 vjetësh, kur Jul Cezari në krye të legjioneve e mposhti Pompeon, imperatorin e Romës në brigjet e Shqipërisë dhe të Greqisë, duke iu falënderuar veteranëve për besnikëri, lojalitet, guxim e tjera ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të grupit?

ANTON QUNI: Faleminderit!

...i liroi nga obligimi ushtarak dhe i shpalli qytetarë të lirë të Romës. Po ashtu, për veteranët e ndërtoi një lagje të tërë, të rrethuar me tokat pjellore në mes Detit Jon dhe Liqenit të Butrintit, ku ata do të ngrinin familjet, ekonomitë e të tjera. Të gjithë ata u risocializuan në shoqërinë civile, duke u marrë me bujqësi, blegtori, peshkim e të tjera. Jo rrallë u bënë skulptorë, arkitektë, shkrimtarë, oratorë, instruktorë dhe këshilltarë të artit luftarak.

Ne sot, në shekullin XXI, në kohën e digjitalizimit, të teknologjisë informative, për 13 vjet me radhë nuk ishim në gjendje së paku ta përcaktonim numrin e saktë të pjesëmarrësve dhe të veteranëve të UÇK-së.

Përgjegjësia më e madhe bie mbi ata që plot me gojën e prezantonin vetveten si alfa dhe omega e zhvillimeve, e ngritjeve, e operacioneve dhe e fitoreve të UÇK-së, kurse sot nuk janë në gjendje ta bëjnë operacionin më të thjeshtë matematikor të mbledhjes dhe zbritjes, për ta vërtetuar numrin e saktë të veteranëve.

Bëj thirrje që në afatin sa më të shkurtër, Komisioni në fjalë të funksionalizohet, ndoshta edhe me riemërimet brenda tij dhe t'i përmbushë obligimet ligjore, por paraprakisht të gjithë të emëruarit e Komisionit të deklarohen menjëherë nëse janë apo jo në gjendje që t'i përmbushin detyrat e ngarkuara.

Nuk dua të flas për gjendjen socio-ekonomike shëndetësore dhe shpirtërore të veteranëve, për të mos e kuptuar si përpjekje për promovim individual, apo partiak. Por, një qasje e tillë e Qeverisë së Kosovës dhe e Komisionit është joserioze ndaj veteranëve, e cila prek thellë në dinjitetin e tyre dhe po ashtu...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar,
Zotëri dhe zonja deputetë,

Së paku tri herë, në seancat e Kuvendit të Kosovës, nënkryetari i këtij Kuvendi, zoti Petar Miletiq, ka ngrehur akuza të drejtpërdrejta drejtuar Policisë së Kosovës, duke e akuzuar

këtë strukturë se nuk po do t'i zbulojë rastet e disa nga krimet që kanë ndodhur në Kosovë.

Natyrisht, edhe vetëm një rast i pazbuluar për Policinë dhe për ne është dhe duhet të jetë punë e pamjaftueshme. Por, kur ky "shqetësim" ngrihet me hile mbi baza etnike, atëherë ky nuk është më shqetësim, por synim.

Të gjitha rastet e pazbuluara duhet të zbulohen dhe të vihen para drejtësisë, por për këtë Policia duhet të ndihmohet dhe të mbështetet, sidomos nga Qeveria, pjesë e secilës Qeveri është edhe zoti Miletiq, si deputet i njërit prej grupeve parlamentare, pjesë e koalicionit qeverisës dhe si nënkryetar i Kuvendit, të cilit i drejtohet me akuza.

Synimi, e jo shqetësimi i nënkryetarit të Kuvendit është që duke e sulmuar Policinë ta sjellë atë si temë të re në tavolinën e bisedimeve me Serbinë, si një strukturë, e cila gjoja nuk mund të veprojë në ambientet ku jeton komuniteti serb.

Zoti nënkryetar, që Policia t'i zbulojë sa më shpejt krimet që ju u referoheni, atëherë komuniteti, të cilin ju e përfaqësoni, do të duhet të bashkëpunojë, e jo ta sabotojë Policinë e Kosovës. E kjo ndihmë, edhe bashkëpunim, do të duhej të fillonte pikërisht nga ju, meqë së paku në njërin prej rasteve të cilave ju u referoheni, keni qenë i përfshirë edhe si viktimë.

Po aq sa jeni të shqetësuar për vetëm disa nga rastet e pazbuluara, do të duhej që të mos përjashtoheshin nga shqetësimi juaj edhe zbulimi i vrasësve të policit të Kosovës, Enver Zymberi, e po ashtu të Selver Haradinajt.

Në të njëjtën kohë, Qeveria e Kosovës, e sidomos ministri i Brendshëm, do të duhej t'i dalë në mbrojtje Policisë së Kosovës në akuzat e padrejta që i drejtohen asaj, sidomos kur këto akuza nuk kanë qëllim ta ndihmojnë Policinë e Kosovës, por ta ndajnë atë mbi baza etnike.

Sot, kur kjo Polici e shënon 13-vjetorin e themelimit të saj, më shumë se kurrë do të kishte nevojë për ta mbështetur dhe për ta mbrojtur atë në punën e saj profesionale.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Burim Ramadani, në emër të grupit.

BURIM RAMADANI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Sot janë bërë 13 vjet prej themelimit të Policisë së Kosovës, njërit prej institucioneve më të rëndësishme të vendit tonë dhe ne si subjekt politik dhe si grup parlamentar i urojmë gjithë zyrtarët e Policisë së Kosovës në këtë ditë të shënuar, duke shprehur mbështetjen tonë të plotë në rrugën drejt profesionalizimit të mëtijshëm dhe zhvillimit të saj.

Të nderuara deputete, të nderuar deputetë,

Në këtë ditë i kujtojmë me nderim të thellë policët e rënë në detyrë gjatë gjithë këtyre viteve prej themelimit, ndërsa ritheksojmë se shteti i Kosovës, respektivisht Qeveria e Kosovës, u ka borxh familjeve të tyre që t'u qëndrojnë afër.

Ne jemi të bindur dhe të njëjtën kohë jemi të lumtur me Policinë e Kosovës, këtë organizatë që tashmë është rritur, është stabilizuar në përgjithësi dhe tashmë është kthyer në njërin prej mekanizmave me të cilët identifikohet Kosova.

Jemi të vetëdijshëm për detyrën specifike që ka secili zyrtar policor dhe të njëjtën kohë jemi të vetëdijshëm edhe për shumë e shumë probleme me të cilat përballen policët e Kosovës.

Nuk janë të pakët zyrtarë policorë të cilët kërkojnë ndryshimet e nevojshme për të mundësuar kushte më të mira të punës, si domosdoshmëri për zhvillimin e Policisë.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është e pakënaqur me qasjen që Qeveria e vendit i ka bërë deri tash Policisë së Kosovës, që prej shpalljes së pavarësisë së vendit.

Qeveria e Kosovës po vazhdon të mos e zbatoj Ligjin për policinë, i cili e përcakton në mënyrë të qartë se cili duhet të jetë trajtimi për zyrtarët e Policisë, jo vetëm sa i përket aspektit të pagave, por edhe për çështje tjera, ta zëmë, për çështjet shëndetësore e të ngjashme.

Duke i lënë kushtet e punës për policët e Kosovës në këtë nivel, ne jemi të bindur se Qeveria e Kosovës po e dëmton mundësinë e motivimit më të madh të policëve të Kosovës në luftën e rëndësishme kundër krimit të organizuar dhe në detyrën për vendosjen e rendit dhe të ligjit.

Qasja e duhur, që është e kundërt me këtë Qeveri, nënkupton përkushtimin për ta zhvilluar Policinë, sidomos në aspektin profesional, në aspektin teknik, atë financiar dhe mirëqenien e policëve të Kosovës.

Pos pagës themelore, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është e vendosur që për pjesëtarët e Policisë së Kosovës duhet të realizohen edhe shpenzimet mjekësore dhe shëndetësore, shpenzimet jetësore për transferim të përkohshëm, pushimet me pagesë, kompensimet në rast të vdekjes, stazhi i benificuar, beneficionet e pensionit, shpenzimet për trajtimet profesionale dhe teknike. Po ashtu, duhet të ketë kujdes të veçantë në formë të veçantë për familjet e pjesëtarëve të rënë në detyrë gjatë gjithë këtyre viteve.

Pa dashur të flas për tema tjera që janë pajisje teknike, trajnime të veçanta apo speciale, çështjet organizative, ne si Aleancë jemi të bindur në nevojën për një reformë strukturore të kujdesshme për Policinë e Kosovës, në mënyrë që ta kemi një polici më funksionale, më të fuqishme dhe më efikase.

Ndër këto reforma, shkurtimisht dua të përmend se të domosdoshme janë komunikimet ndërmjet departamenteve, vënia e Drejtorisë së Inteligjencës dhe Analizës në shërbim të tërë Policisë, e jo vetëm një departamenti, shtrirja e Njësisë Antiterrorizëm në të gjitha rajonet, rritja e numrit të njësisë së vetme speciale FIT, ristrukturimi i njësisë ROSU dhe përdorimi i duhur i tyre, policimi në komunitet e të ngjashme.

Duke uruar edhe një herë 13-vjetorin e themelimit Policisë së Kosovës, ne jemi të bindur se shteti i Kosovës mund ta arrijë në nivel të kënaqshëm të zhvillimit vetëm atëherë kur ekziston një trajtim i kënaqshëm institucional për Policinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Vesna Mikić.

VESNA MIKIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Uvaženi poslanici,

Ovoga puta, moje izlaganje neće biti usmereno ka predstavnicima Vlade Kosova iz razloga što se do sada uglavnom pokazivali indolentan stav kada je u pitanju položaj srpske zajednice i rešavanje problema sa kojima se oni svakodnevno susreću.

Zato ću iskoristiti priliku da se ovoga puta i ovim putem obratim predstavnicima Međunarodne zajednice i Evropske unije, za koje sam sasvim sigurna da pomno prate svaku sednicu.

Gospodo, u poslednja dva meseca mogli smo gotovo svakodnevno da čujemo vaše izjave, kako su kosovsko društvo u celini i Vlada Kosova ispunili vaša očekivanja, te da možete proces nadgledane nezavisnosti privesti kraju. Pri tom, zaboravili ste na garancije koje ste

davali Srpskom narodu da konačnog statusa neće biti dok se ne ispune određeni standardi.

Kao što svi vidimo, od standarda nema ništa, standardi su ostali samo izgovorena reč. Ni najključnija pitanja nisu uzeta na razmatranje do sada, kao što je položaj Srba, i položaj njihovog imovnog stanja.

Gospodo, ako su vaša očekivanja bila nemogućnost povratka 250 hiljada Srba, koji tumaraju širom Srbije na marginama opštine i gradova, ako su vaša očekivanja bila sve učestalija ubistva na etničkoj osnovi, za koje mogu slobodno da kažem da gotovo nije nijedan slučaj nije procesiran do sada;

Ako su vaša očekivanja bila uvođenje Srpskog naroda, Srpske zajednice, u nekakav decentralizacioni sistem koji funkcioniše pri tom samo na papiru, dok je u praksi sasvim drugačije, gde određeni ministri, unutar Vlade, prete opštinama u decentralizovanom sistemu, kako moraju da sprovode ono što im oni naređuju, ako su vaša očekivanja bila brisanje identiteta Srpske zajednice iz ličnih dokumenata sve u cilju stvarane neke virtualne nacije pod nazivom kosovari, što pri tom moram da dodam da na srpskom jeziku nema nikakvom značajne;

Onda gospodo mogu slobodno da vam kažem da ste svoj zadatak uspešno priveli kraju, i da se možete mirno vratiti svojem kućama, ali sam sasvim sigurna da ćete na savesti poneti svaku suzu koji prolivena iz nevinog dečjeg oka srpske dece i za bodljikave žice, koji ste nam vi gospodo sa zapada nametnuli kao jedini model zaštite i sigurnosti u XXI veku.

Sasvim sam sigurno da će se na savesti poneti svaku žrtvu za koji ste bili u obavezi da počinio izvedete pred licem pravde.

I na kraju, mogu slobodno da kažem da ćete biti odgovorni i jedini krivci za još jedan mogući egzodu srpskoga naroda, ali ga ovoga puta u važe režiji, a sve u cilju stvaranja monoetničke države na ovim prostorima. Hvala vam!

KRYETARI: Deputete, standardet janë plotësuar, por në shekullin XXI nuk mund të shkohet me syzat e Milosheviqit. Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ajo që dëshiroj të shtroj ka të bëjë me temën që ne e patëm në debatin e kaluar, por ai debat është shterur dhe sot e kemi vetëm një votim. Është fjala për çështjen e kodit të telefonisë mobile dhe arsyeja pse kërkoj që kjo të shtrohet në këtë pikë, jashtë rendit të ditës, është për faktin se pikërisht sot dhe nesër në Tiranë mbahet bëhet një konferencë jashtëzakonisht e rëndësishme e organizuar nga ITU, dhe për faktin që po ashtu në këtë konferencë është dashur që Qeveria e Shqipërisë, si nikoqire, t'i ftojë institucionet kosovare dhe t'u mundësojë të paktën të kenë në marginat e konferencës takime të natyrave të ndryshme me nivele qeveritare, me ministra, me zëvendëskryeministra dhe me përgjegjës të rregullatorëve nacional të telefonisë.

Për faktin se ju e dini që në debatin e kaluar gati të gjithë deputetët që folën për këtë çështje e kishin gatishmërinë dhe dëshirën që ne ta kemi kodin shtetëror të Shqipërisë, ose ta shfrytëzojmë përkohësisht këtë kod, e në ndërkohë nuk e kemi një gatishmëri të vetë institucioneve shqiptare që të punojnë më shumë në këtë drejtim dhe të paktën, aty ku ka mundësi, pra të paktën ku mbahen konferenca të tilla në Shqipëri, të jemi të ftuar dhe po ashtu ta kemi mundësinë e lobimit më të madh për çështje, që janë me interes për vendin tonë, sidomos deri në anëtarësimin e plotë në këto institucione.

Pra, i ftoj institucionet shqiptare që të mos kenë vetëm retorikë në mbështetjen e pranimit tonë në institucionet e ndryshme ndërkombëtare, por të punohet praktikisht, të punohet më shumë.

E di që rregullatori ynë ka pasur kontakte me rregullatorin e Shqipërisë. Unë ju sugjeroj atyre, meqë ka pasur disa kontakte krejt vonë dhe edhe të ministrit tonë atje, për të gjetur ndonjë mundësi për të bërë ndonjë kontakt, i ftoj që të paktën sot dhe nesër të shkojnë në Shqipëri, pavarësisht ftesave, të kontaktojnë me shumë përfaqësues të shteteve, të cilët do të na ndihmojnë ndoshta që, jo vetëm për çështje të tilla, çfarë ishin kërkesat e deputetëve tanë, por edhe për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me telefoninë mobile dhe, në përgjithësi, me këtë sferë që është me interes për ekonominë kosovare. Faleminderit!

KRYETARI: Do të shohim nëse mund t'i zgjedhim çështjet, të cilat i shtruat në këtë pikë të rendit të ditës. Fjalën e ka deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala poštovani predsjedniče,

Poštovana gospodo poslanici,

29.12.2009. godine konstituisano novo formirana decentralizovana opština Gračanica.

Konstituisana je po sloganom „Šansa za bolji život na Kosovu“, i „Opština će biti servis građana“.

Opštinsko rukovodstvo obećalo je da će građani opštine prvi put imati adresu, na koju će moći da se obrate za sve probleme koji imaju, a koje se tiču direktno njih.

Gospodo poslanici, sve ovo govorim iz samo jedno razloga, a to je da, kada govorimo o procesu decentralizacije, posle tri pune godine, on se nije još završio, i sada slogani pod kojim smo izašli pre svoje građani više ne važe.

Prenos nadležnosti sa centralnog opštinskog nivo nije završen. Kao što znamo, centralne vlasti treba da povere neke odgovornosti opštinama u skladu sa Zakonom, a pomenuću samo neke: katastarske knjige, matične knjige, registracija građani, i tako dalje.

Sadašnji prvi problem nekompletna baza podataka civilne registracije, što znači da sada građani u opštini Gračanici vade lične karte i druga dokumenta u opštinama gde su živeli pre formiranja decentralizovane Opštine Gračanica, što moram reći da je nedopustivo.

Drugi problem je što opština nema kancelariju civilne registracije, koja bi bila u službi građana, tako da sada građani odlaze da vade i zamenjuju svoje dokumente u Prištini, što dodatno komplikuje i tako težak život građana.

Još jedan u nizu problema svih nas je da se ne poštuje Zakon o upotrebi jezika, jer zgrada gde je smeštan civilni registar građana nema nijedan šalter na kom stoji i na srpskom, koja je njegova namena.

Moram napomenuti nesrednja sa MUP-om, konkretan je problem oko dobijanja službenih tablica za vozilo opštine.

Gospodo poslanici,

To je samo deo problema koji sam pomenuo, a koji se odnosi na nedovršeni proces decentralizacije u novim opštinama, a koji direktno utiče na život građana u opštini.

Zato morim sve relevantne činioce ovog procesa da se drže zakona, i da nadležnosti koji treba preneti na opštine prenesu, kako bi opštine i stvarno bile servis u službi građana. Hvala!

KRYETARI: Deputeti Hashim Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari kryetar i Kuvendit, zoti Krasniqi,
Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Kjo verë po kalon me pasoja të rënda, si nga zjarri, ashtu edhe nga thatësira. Në këto rrethana, edhe më shumë është forcuar bindja se mekanizmat e pushtetit të të gjitha niveleve nuk kanë dëshmuar përgjegjësi e gatishmëri që të menaxhojnë me situatat që bartin rreziqe serioze.

Të dhënat e fundit tregojnë se në Kosovë janë djegur 3 400 hektarë pyje, prej të cilave 900 hektarë ishin me dru cilësor. Janë djegur kryesisht pyjet pa zot, përkatësisht 2 900 hektarë pyje në pronësi publike, kurse vetëm 500 hektarë në pronësi private.

Në tërësi, 20 komuna kanë qenë të ballafaquara me stuhinë e zjarrit. Më e prekura ka qenë komuna e Deçanit, e cila ka 800 hektarë me pyje malore, kurse në malet e Koretnikut 600 hektarë.

Por, nuk ka shpëtuar lehtë ta zëmë as Prishtina, madje zjarr ka pasur edhe në disa paralagje e qytetit, siç janë Lagjja e Spitalit, Lagjja e Kolovicës, por me mobilizimin dhe intervenimin e shpejtë të strukturave komunale, situata është vënë nën kontroll.

Ndërkaq, në rajonin e Anamoravës zjarri ka gëlltitur afro 600 hektarë, por pasojat do të ishin shumë të vogla sikur organizimi në nivel lokal të ishte më i mirë dhe më efikas. Mirëpo, stuhia e zjarrit, pos dëmeve materiale, ka lënë pas vetes shumë dilema e dyshime, por edhe ka nxjerrë në pah dobësi të shumta.

E para, dyshimet prej nga erdhën zjarret. Ka pasur informata se në disa zona kufitare zjarri është importuar nga Shqipëria, por nuk ka konfirmim zyrtar për këtë. Mirëpo, as për zonat e brendshme nuk ka hetim për shkaktarët e zjarrit. Dyshimet janë të shumta. Pos shkaktarëve të nxitur nga fenomenet natyrore, ka dyshime për zjarrvënie të qëllimshme, pastaj djegie të pyjeve nëpërmjet tenderëve, kinse për pastrimin e tyre nga drunjtë e mbetur. Por, ka indikacione se zjarri i është futur malit për t'i humbur gjurmët e prerjes ilegale, apo të veprimeve tjera të paligjshme, meqenëse zjarri i djeg edhe dëshmitë, edhe gjurmët.

E dyta, sado që nuk ka munguar mobilizimi i popullatës, i zjarrfikësve dhe i pjesëtarëve të FSK-së, që është për falënderim, konfuzion ka shkaktuar moskordinimi dhe mosorganizimi i veprimeve ndërmjet institucioneve.

Edhe pse përgjegjësia për pyjet bie mbi autoritetet lokale e rajonale, niveli qendror nuk guxon të heshtë në situatat kur paraqitet rreziku, që kërcënon me pasoja të mëdha. Qeveria ka heshtur, derisa pyjet digjeshin.

U pa se ajo nuk ka investuar për sigurimin e pajisjeve të domosdoshme për situata të këtilla, por as nuk ka kërkuar ndihmë, madje as nga KFOR-i.

E treta, pasojat. Dëmet materiale janë të mëdha, është kanosur seriozisht ambienti, por edhe industria e përpunimit të drurit, dhe blegtoaria, si potencial për zhvillimin e vendit.

Edhe më tutje do t'i vuajmë pasojat, nëse autoritetet sillen me këtë papërgjegjësi. Këtu ka dështuar Qeveria, e cila nuk ka reaguar me kohë, ashtu që të ketë një koordinim më të mirë ndërmjet të gjitha hallkave të pushtetit, në mënyrë që situata të vihet nën kontroll.

Hetuesia ka dështuar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Agim Kuleta.

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ndoshta është jokorrekte përderisa nuk lejohet replika gjatë kësaj pike të rendit të ditës, mirëpo duke qenë se u lidh me një çështje që është trajtuar, ka pasur mungesë të deputetëve dhe prapë është në rend të ditës më vonë, unë do të reagoja vetëm ndaj asaj që tha, më vjen keq që nuk është këtu tash, zoti Pajaziti.

Është jokorrekte dhe jo mirënjohëse të flitet me një gjuhë të tillë për shembull ndaj Republikës së Shqipërisë, kur dihet shumë mirë kontributi që ka dhënë dhe po jep vazhdimisht. Nuk po them që është duke e bërë më të mirë, por gjuha nihiliste nuk është e dobishme për askënd.

Sa i përket aspektit të retorikës, edhe motivi i këtij mocioni ka qenë i tillë, që të dalim edhe ne nga retorika, që jemi duke bërë diçka, por të bëjmë diçka konkretisht në këtë drejtim.

Prandaj, ju ftoj që nëse dëshirojmë të dalim nga retorika, të paktën ne, dhe ta nxjerrim më tepër në spikamë retorikën e Republikës së Shqipërisë, ta votojmë këtë mocion dhe ta vëmë në provë këtë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

U përmend edhe nga kolegët e mi deputetë se sot është 13-vjetori i themelimit të Policisë së Kosovës, një organizatë, një segment i drejtësisë, i ndërtuar me mund dhe profesionalizëm.

Por, unë, krahas kujtimeve për ata të cilët kanë kontribuar në ngritjen dhe profesionalizmin e kësaj strukture, mendoj që sot Policia e Kosovës duhet t'i kujtojë kolegët e vet, jo vetëm Enver Zymberin, i cili ka rënë në një aksion duke e mbrojtur territorin e Republikës së Kosovës me shumë respekt, por duhet t'i kujtojë edhe policët të cilët kanë rënë në krye të detyrës duke e hetuar krimin e organizuar dhe vrasjet për motive politike.

Andaj, ata sot, në këtë 13 vjetor mendoj që duhet të jenë shumë më vigjilentë, sidomos eprorët e tyre të shkarkohen nga ndikimet politike. Në këtë 13-vjetor t'i kujtojmë drejt sidomos Sebahate Tolajn dhe Isuf Haklajn, Arben Sejdiun, i vrarë para pak kohësh, luftëtar në Koshare, po ashtu në shtëpinë e vet, para familjes, por edhe Hajdar Ahmetajn, Arsim Rustollin dhe disa të tjerë.

Andaj, Policia e Kosovës dhe Qeveria e Kosovës mund të themi se janë kujdesur pjesërisht për ta, për familjet e tyre dhe për kolegët e tyre, duke kujtuar edhe aktet makabre që ka ndodhur në vjedhjen në Dhomën e Dëshmive në Prishtinë dhe në Pejë, e kjo tregon rezultatin konkret se ku është Policia e Kosovës në këtë 13-vjetor.

Unë e kam këtë shqetësim dhe bëj thirrje që t'i mbrojnë kolegët e vet, ta mbrojnë ligjin, ta avancojnë ligjin në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, të mos bëjnë drejtësi selektive, por të punojnë ashtu siç u ka hije dhe për çka janë të thirrur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti i fundit, Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryetar,

Seanca e votimit të pakos së ligjeve për të ashtuquajturën heqje të mbikëqyrjes së pavarësisë, që ndodhi javën që shkoi, është dëshmia e radhës për rrugëtimin e Kosovës.

Në vend të një rrjedhe politike të rregullt, që e shpie Kosovën drejt një shteti normal, po ndodh saktësisht e kundërta.

Së pari, cili është ai shtet që do të mund ta quanim normal, e drejt të cilit të gjithë qytetarët do të donim ta shihnim Kosovën. Është sovraniteti që nënkupton të drejtën e bashkimit me Shqipërinë, integriteti territorial, ushtria, demokracia në institucione e në shoqëri dhe zhvillimi ekonomik, elementet që do përbënin atë. E, ne, jo vetëm që nuk i kemi, por me politikën aktuale po shkatërrohet çdo mundësi e rrugëtimit në këtë drejtim.

Pamë dhe po shohim kompromise shtesë, po shohim depërtim edhe më të thellë të Serbisë në Kosovë, po shohim dobësim të moralit dhe të potencialit shqiptar gjithandej, varfëri, në njërën anë, dhe pasurim të tmerrshëm, në anën tjetër. Vetëm ndërtim të shtetit, në fakt, nuk po shohim.

Po përmendet heqja e mbikëqyrjes e, në fakt, sundimin ndërkombëtar, që është vazhdimësi e UNMIK-ut, Qeveria këtë po e fut brenda institucioneve të Kosovës dhe misioneve të tij. Po ia zgjat afatin. Jo vetëm që Kosova nuk po bëhet sovranë, por edhe perspektiva për sovranitet në të ardhmen po errësohet.

Pra, e tëra është që po mbyllet Zyra e ICO-s, e kjo po quhet heqje e mbikëqyrjes. Përse po hiqet dhe me çfarë motivi? Fakti që një gjë e tillë po ndodh në kohën kur po bëhen përgatitje për dialog politik me Serbinë për veriun e Kosovës, tregon se nuk po ngjan e ashtuquajtura përmbyllje e mbikëqyrjes për të shtuar pavarësi për shtetin, por për t'i hequr territor vendit tonë.

Kompromiset që do të bëhen do të jenë përtej pakos së Ahtisarit dhe, meqë këta duan të shkojnë edhe përtej pakos së Ahtisarit, kjo i bie se duhet të shkojnë edhe përtej Piter Fejtit. Dhe, jo se zoti Fejt nuk është dakord politikisht me këtë gjë, por ai paraqet pengesë juridike për Ahtisarin Plus. Ai ishte këtu për pakon, është këtu për pakon dhe ndryshimet e pakos nuk mund të ndodhin bashkë më të, duhet të ndodhin pra pa të. Pra, Fejt po shkon që Qeveria të mund të bëjë kompromise të tjera.

Kjo pra është rrjedha politike në të cilën gjendet Kosova. Dhe po mbyllet Zyra e ICO-s, kur përgatitjet për shitjen e KEK-ut, të PTK-së dhe të Trepçës janë rritur si asnjëherë më parë. Krahaz pazareve politike, po ndodhin me shpejtësi edhe pazaret e shitjes së pasurive të interesit kombëtar dhe strategjik të popullit tonë. Populli po zhvishet fare si faktor. Nga pazaret po rrezikohet që atij t'i humbë identiteti, pasi shtetit po i humb identiteti; po i humb pasuritë dhe po rrezikon tani t'i humbë edhe territori.

Në politikën e Qeverisë ndryshimet janë të mundshme vetëm në një kah, në atë drejt Serbisë. Votimi i pakos së ligjeve dhe e drejta e shumicës së dyfishtë e dëshmojnë këtë trend. Pra, tendenca për një ndryshim normal të ligjit u minua nga shumica e dyfishtë. Çfarë u kërkua në amendamentin e rrëzuar nga shumica e dyfishtë? U kërkua barazia, u kërkua liria, madje edhe e institucionit fetar, por një gjë e tillë nuk kaloi, sepse dora e Beogradit patjetër duhet të jetë këtu. Pra, në vend që të ketë ndryshime pozitive të Kushtetutës, kur e heqim nenin 1.3 dhe kur Kosova fillon të bëhet shtet normal, këtu ndryshimet në Kushtetutë janë të lejuara vetëm në një drejtim. Dhe, në politikën e Qeverisë, pakoja e Ahtisarit mund të ndryshojë pra vetëm në një kah. Dhe, me këtë politikë të Qeverisë kjo gjë është e pashmangshme.

Çdo lëvizje, më të voglën që do ta bëjë Qeveria, të thotë kompromis shtesë. Çdo negociatë, çdo takim, çdo tentativë për ndryshim të gjendjes, shpie në kompromis shtesë. Tani do të kemi çdo herë pazare, duke kërkuar ulëse shtesë, kërkojnë komuna shtesë, kërkojnë kompetenca shtesë për komunat, kërkojnë zona të veçanta shtesë, kërkojnë mbyllje hermetike të këtyre zonave, kërkohet status i veçantë për veriun, dhe të gjitha janë të mundshme. Në këtë politikë, vetëm një gjë nuk është e mundshme: ndryshimet në drejtimin e duhur.

Për këto ndryshime, kompromiset e mëhershme dhe të tanishmet e kanë mbyllë rrugën. Hapur ka mbetur vetëm rruga e ndryshimeve në favor të Serbisë.

Në përmbylljen e pavarësisë së mbikëqyrur, mbikëqyrja po synon të përfundohet në vitin 2014, ndërkohë që koncesionet shtesë ndaj ndërkombëtarëve dhe Serbisë, si pozita e Kishës Ortodokse, Ligji për Prizrenin, Ligji për Hoçën e Madhe, marrëveshjet e Brukselit, dialogu politik, po marrin efekt të menjëhershëm juridik e praktik. Pra, për ne janë e premtimet, e për Serbinë në fakt është pushteti real.

Dhe, e tërë kjo rrjedhë po pritet tani të kulmojë nën festë, nën tingujt e defeve dhe tarabukeve, të përgatitur enkas nga Qeveria.

KRYETARI: Me këtë e përfunduam këtë rend të ditës. Liburn, disa formulime bëji më të sakta, se nuk ka sundim ndërkombëtar askund në botë.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë janë parashtruar 6 pyetje. Po fillojmë me pyetjen e parë, deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Ministër,

Në konkursin paraprak për drejtor të klinikave në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës janë bërë shkelje ligjore dhe procedurale.

Pas debatimit në Kuvendin e Kosovës për këtë çështje, ju në disa klinika i anuluar zgjedhjet e drejtorit dhe e përsëritët konkursin.

Pse kur është përsëritur konkursi në ato klinika i keni eliminuar veç shkeljet procedurale? Pra, keni dërguar persona nga Ministria e Shëndetësisë në intervistë, që kanë munguar në intervistat e para. Ndërsa nuk i keni eliminuar rastet kur është bërë shkelja e Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

I nderuar Kabinet qeveritar,

E nderuara deputete,

Gjatë verifikimit të procedurave të përzgjedhjes së drejtorëve të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë evidentuar parregullsi minore procedurale nga Komisioni, i formuar prej Ministrisë së Shëndetësisë enkas për këtë qëllim.

Ky komision ka konstatuar që një pjesë e konkursit për përzgjedhjen e drejtorëve të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës ka pasur mangësi procedurale dhe këto mangësi, sipas komisionit, janë eliminuar me përsëritjen e pjesshme të procedurave të përzgjedhjes.

Konstatimi se është dashur që të hyhet më thellë edhe në ndryshimet përmbajtjesore të procesit të përzgjedhjes dhe rezultateve të përzgjedhjes, me arsyetimin se ka pasur shkelje të statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, nuk qëndron, sepse në çdo aspekt janë respektuar dispozitat e statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës me rastin e përzgjedhjes së drejtorëve të klinikave dhe instituteve të kësaj qendre.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shitesë?

TIME KADRIJAJ: Ministër,

Keni thënë se drejtorët e Qendrës Klinike Universitare i nënshtrohen Ligjit për shërbyesit civilë. Ndërsa ata që kanë kërkuar opinion ligjor e kanë marrë atë nga Ministria e Administratës Publike me numër 6381, i cili thotë se drejtorët e klinikave janë shërbyes civilë. Të njëjtën e kanë marrë edhe nga Inspektorati i Punës.

Ministër, është bërë shkelja e nenit 23.8. Në kushtet e konkursit, thuhet se përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen për drejtorë të klinikave janë: zgjidhen nga radhët e specialistëve të fushave përkatëse me thirrje akademike të profesorit, ose në raste të caktuara me thirrje shkencore, e në mungesë të tyre vijnë në shprehje edhe specialistë të fushave përkatëse, me vlerësim më të mirë gjatë përzgjedhjes.

Unë e di një numër shumë të madh të drejtorëve të klinikave, që janë anuluar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara zonja deputete,
Në Ligjin e punës, të gjithë punëtorët shëndetësorë në Republikën e Kosovës nuk konsiderohen më shërbyes civilë.

Drejtorët e klinikave dhe të instituteve klinikave universitare të Kosovës nuk kanë kurrfarë kompetencash menaxheriale të veçanta të menaxhimit të buxhetit, ose të resurseve njerëzore. Këto kompetenca i takojnë drejtorit ekzekutiv të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

Me Statutin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës specifikohet qartë që drejtori ekzekutiv i QKUK-së zgjidhet në bazë të Ligjit për shërbimin civil. Ndërsa, kur bëhet fjalë për zgjedhjen e drejtorëve të klinikave dhe të instituteve, specifikohet se zgjedhja e tyre bëhet në pajtim me ligjet në fuqi, që nënkupton Ligjin e punës, sipas interpretimit të Ministrisë së Shëndetësisë. Dhe, kjo është plotësisht në pajtim me politikat reformuese të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat synojnë që të sigurojnë një shkallë të lartë të autonomisë menaxheriale për institucionet shëndetësore.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Deputete, e kreve fjalën? Në rregull, deputet përgjigju.

FERID AGANI: Neni 23 i Statutit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës e specifikon qartë mundësinë që në pozita udhëheqëse, në rastet e veçanta, sipas vlerësimit të Komisionit përzgjedhës, të zgjidhen edhe kandidatët, të cilët nuk janë nga radhët e

profesorëve të Fakultetit të Mjekësisë. E, në qoftë se e shikoni përzgjedhjen e drejtorëve, do të shihni që shumica absolute e drejtorëve të klinikave dhe të instituteve të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë nga radhët e profesorëve të Fakultetit të Mjekësisë.

KRYETARI: Ju lutem, respektojeni kohën! Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj, pyetje për ministrin Agani.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Pyetja është për Ministrinë e Shëndetësisë, përkatësisht për zotin Agani. Zoti ministër, gjendja e furnizimit me barna esenciale në QKUK është shumë shqetësuese, sepse kohëve të fundit në këtë klinikë, e cila është e vetmja qendër në Kosovë, që u ofron pacientëve shërbime terciare, po ballafaqohet me një mungesë shumë të madhe të barnave.

Mungojnë infuzionet e gjilpërat. Këto janë ato të cilat nuk është dashur të mungojnë kurrë. E po ashtu, ju e dini mirë, se barnat e listës esenciale duhet të sigurohen nga shteti, pra nga Ministria e Shëndetësisë. Por, me keqardhje e them, deri më tani nuk ka përmirësim të gjendjes. Pra, zoti ministër, na tregoni, ju lutem, kur do të ndryshojë kjo gjendje, kur do të ketë furnizim më adekuat me barna esenciale nga ministria juaj?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

E nderuara zonja deputete,

Unë jam pjesë e shqetësimeve tuaja përkitazi me furnizimin me barna dhe material harxhues në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe nëpër spitalet tjera në Kosovë.

Në radhë të parë, vështirësitë përkitazi me furnizimin adekuat nga lista esenciale vijnë nga buxheti tejet i mangët që e ka Ministria e Shëndetësisë. Një argument: Tërë buxheti për barna dhe material harxhues, i përcaktuar me Buxhetin e Republikës së Kosovës, është 18,5 milionë euro. Krahësuar me shtetet e rajonit, kemi të bëjmë me një shumë, e cila disa dhjetëra herë është më e vogël se sa është e nevojshme. Megjithatë, ne jemi duke arritur që t'i furnizojmë këto institucione vazhdimisht në nivelin 60 deri 70% të nevojave të tyre.

Është fakt se në muajin e kaluar ka pasur vështirësi të theksuara në furnizimin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës me materialet që i përmenda, e arsyeja për këtë, në radhë të parë, kanë qenë vështirësitë menaxheriale, me të cilën Ministria e Shëndetësisë është kah ballafaqohet në sektorin e prokurimit të medikamenteve. Ju e dini, vështirësitë e mëdha që i kemi pasur në shërbimin civil të ministrisë, ndryshimet radikale, emërimi i ushtruesve të detyrës në këtë departament. Kjo ka shënuar vështirësi edhe në procedurat e prokurimit dhe të planifikimit të medikamenteve dhe të materialit harxhues.

Faktori i tretë pse kjo po ndodh janë procedurat tejet të komplikuar të prokurimit, të cilat nuk i respektojnë specifikat e prokurimit të barnave dhe materialit harxhues për Sektorin

e Shëndetësisë. Kemi procedura të ankimit, të cilat zgjasin me muaj të tërë, e ne nuk jemi në gjendje t'i tejkalojmë obligimet ligjore që dalin nga Ligji i prokurimit. Përgjigjja ime konkrete në pyetjen e juaj se kur do të tejkalohet kjo situatë, është në momentin kur ne ta miratojmë Ligjin e shëndetësisë në Kuvendin e Kosovës, ta reformojmë sistemin shëndetësor, të sigurojmë autonomi menaxheriale të institucioneve shëndetësore dhe t'i bëjmë ato përgjegjëse për prokurimin e barnave dhe të materialit harxhues.

Në atë moment, Ministria e Shëndetësisë më nuk do të jetë blerëse e barnave dhe materialit harxhues, por do të jetë mbikëqyrëse dhe kontrolluese e këtij procesi. Faleminderit!

KRYETARI: Ke pyetje shtesë, deputete?

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Zoti ministër, kur ju keni ardhur ministër e keni ditur sa është buxheti në Ministrinë e Shëndetësisë, e kurrë më i madh nuk ka qenë. Viteve të kaluara ka qenë shumë më i vogël se tani. E keni ditur shumë mirë se sa është shuma për barnat esenciale. Çka nënkuptoni, zoti ministër, me termin "listë e barnave esenciale", kurse ato mungojnë? Kurrë në historinë e Ministrisë së Shëndetësisë nuk ka ndodhur që të ndërpritet puna e operacioneve, pra të pezullohet puna e operacioneve brenda ditës dhe pacientët të mos gjejnë zgjidhje në qendrën e vetme në shtetin tonë.

Unë mendoj se është një gjendje jashtëzakonisht katastrofale. Si pasojë e kësaj është janë edhe vizitat e pacientëve tanë nëpër klinikat private. Si duket, kjo gjendje po i konvenon dikujt. Megjithatë, ju e dini shumë mirë, në Klinikën e Kardiologjisë Invazive, herë prishet aparati, herë nuk ka stenda. Kur mungojnë stendat, prishet aparati, kur ka stenda nuk punon aparati. Kur do të funksionojë Kardiologjia invazive...?

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

FERID AGANI: Zonja deputete,

Kardiologjia Invazive ka filluar sot të funksionojë, është fakt pas një periudhe kohore, nën një. E dyta, buxheti për barna tash e disa vjet është i njëjtë, nuk ka qenë shumë herë më i vogël. Edhe vitin e kaluar ka qenë i njëjtë, në të njëjtin nivel dhe parashihet që edhe vitin e ardhshëm të jetë i njëjtë.

Gjendja nuk është katastrofale. Unë thashë, kemi të bëjmë me një ditë, në të cilën ka pasur rënie të zinxhirit të furnizimit dhe atë ditë asnjë jetë e pacientit nuk ka qenë e cenuar në asnjë mënyrë. Pra, janë gjetur zgjidhjet për furnizim adekuat dhe furnizimi është stabilizuar shumë shpejt. Unë prapë po e them se gjetja e rrugëdaljes prej situatës aktuale me këto resurse financiare ekziston vetëm në rrafshin e ndryshimeve sistimore, të cilat i kemi projektuar me Ligjin e shëndetësisë, me rritjen e autonomisë menaxheriale dhe me rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies në institucionet shëndetësore.

Në këtë moment, tërë përgjegjësia menaxheriale mbi sistemin shëndetësor qëndron në Ministrinë e Shëndetësisë, pra niveli politik, që është anakronike dhe reflekton situatë

emergjente, zgjidhje emergjente për periudhën pas vitit 1999. Prandaj, miratimi i Ligjit të shëndetësisë në Kuvendin e Kosovës në procedurë sa më të shpejtë është një “condicio sin ecuanon”, pra kusht para çdo kushti, për të parë ndryshim në këtë sektor.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputet, a do ta lexosh pyetjen? Mirë!

AFRIM KASOLLI: Po e lexoj pyetjen se të paktën për një javë ndoshta ka kohë që në seancën e ardhshme të përgjigjet. Por, megjithatë, duke e njohur që është i papërgjegjshëm si kryeministër, pak ka shpresa që të përgjigjet.

Në emisionin “Target” në RTK, të datës 25 mars 2012, keni deklaruar se e keni përmendur në bisedime me Serbinë në Bruksel edhe Luginën e Preshevës. Pyetja parlamentare është: Kur dhe si e keni përmendur dhe cili është rezultati i këtyre bisedimeve? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministrin Memli Krasniqi. Deputet, e ke fjalën.

LIBURN ALIU: Ministri, sa po shoh, nuk qenka këtu. Pyetja ime ka të bëjë me financimin nga Federata Ruse në fushën e trashëgimisë kulturore, siç është publikuar në një raport të UNMIK-ut, por meqë ai nuk qenka po e lëmë për herën tjetër.

KRYETARI: E ke mundësinë ta lexosh, por është çështje e jotja. Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministren Mimoza Kusari-Lila.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryetar!

Unë i kam dy pyetje për ministren, që kanë të bëjnë me të njëjtën çështje. Është fjala për masën e mbrojtjes së prodhimit të çimentos në Kosovë të “Sharrcemit” dhe pyetja ime ka të bëjë me atë se çfarë përfitimesh ka realizuar realisht kompania “Titan” nëpërmjet “Sharrcemit”, si pasojë e kësaj mase dhe, në anën tjetër, sa ka qenë dhe sa vazhdon të jetë rënia e importit të çimentos nga Shqipëria, si rrjedhojë e kësaj mase. Por, meqenëse ministrja nuk është këtu, atëherë do t’ia shtroj në seancën e ardhshme, duke shpresuar që do të vijë të përgjigjet.

KRYETARI: E përfunduam edhe këtë pikë të rendit të ditës. Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 12 dhe 13 korrik 2012 dhe më 30 dhe 31 gusht 2012

A keni vërejtje në procesverbale? Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Kryetar!
Të nderuar deputetë,
Ministra,

Më lejoni që të sjell në vëmendjen tuaj pjesën e procesverbalit lidhur me votimin e Projektligjit për amendamentet e miratuara për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, dhe sidomos tekstualisht votimin e Projektligjit me amendamentet e miratuara në tërësi.

Nuk sqarohet kjo: ç'është miratimi i amendamenteve në tërësi? Janë një veprim që të theksoj se gjatë votimit dhe miratimit të këtij ligji, Kuvendi ka qenë i vënë në lajthitje dhe është vënë lajthitje edhe në pikëpamje procedurale, edhe substanciale, me interpretimin e gabuar të referencës.

Referencën në nenin 81 të Kushtetutës, që bën fjalë për të ashtuquajturën e të famshmen “shumicë e dyfishtë”, nuk është së pari e nevojshme në atë rast, s’ka qenë as e saktë dhe është e mangët. Nuk është lexuar dhe nuk është marrë parasysh paragrafi 2 i këtij neni, që e lejon shumicën e dyfishtë. Vini re, ju lutem, për ligjet të cilat i zbatojnë të drejtat e komunitetit dhe nënvizon, me përjashtim të atyre që përcaktohen në Kushtetutë.

Çështjet që ne i kemi shqyrtuar atë ditë janë të rregulluara me Kushtetutë. Ligjet nuk mund ta ndryshojnë Kushtetutën. Kjo është elementare. Për më tepër, kjo dispozitë është edhe në dokumentin e Ahtisarit. E njëjta gjë është edhe me dispozitën 149, te dispozitat kalimtare të Kushtetutës, e cila e saktëson edhe më shumë këtë çështje. Ju lutem, për vëmendjen tuaj, ajo thotë tekstualisht: “Miratimi fillestar i ligjeve me interes vital, pavarësisht nga dispozitat e nenit 81 të kësaj Kushtetute, ligjet me interes vital të radhitura në këtë nen, do të miratohen fillimisht me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm në Kuvend dhe që votojnë”. Do të thotë, miratimin e tyre inicial, siç është në anglisht, ato nuk i nënshtrohen shumicës së dyfishtë, siç nuk janë nënshtuar edhe në rastet e mëparshme, që ne i kemi miratuar në këtë Kuvend. Vetëm në procesin e ndryshimit, atëherë vjen në shprehje kjo dispozitë.

Për më tepër, kjo dispozitë ka të bëjë logjikisht me ndryshimet eventuale që janë restriktive, që i zvogëlojnë të drejtat e komuniteteve. Amendamentet e deputetëve nuk kanë qenë restriktive, përkundrazi i kanë plotësuar dhe madje i kanë pasuruar amendamentet kushtetuese. Si të tilla, nuk kanë mundur t’i nënshtrohen votimit sakatues të shumicës së dyfishtë. Por, edhe një çështje që mendoj se është edhe më e rëndësishme se kjo, është e natyrës procedurale: Le t’i lëmë këto, por mendoj që s’mund t’i lëmë se na detyron Kushtetuta. Po kërkohet shumica e dyfishtë, por është harruar edhe një gjë: shumica e dyfishtë e deputetëve dhe e deputetëve të vendeve të rezervuara. Amendamentet e Qeverisë nuk bëjnë pjesë në ligjet, të cilat duhet të ishin të mbrojtura me instrumentin e shumicës, sepse nuk kanë qenë miratuar, nuk janë në listën e paraparë në Kushtetutë, dhe amendamentet mund të thuhet që kanë qenë restriktive dhe kanë qenë diskriminuese, por amendamentet e deputetëve janë amendamente në amendamentet e Qeverisë, ende të pamiratuara. Prandaj, ato s’mund t’i nënshtroreshin këtij instrumenti edhe nga ky aspekt. Mirëpo, edhe po t’i nënshtrohen, megjithatë shumica e dyfishtë kërkon votat e shumicës së deputetëve, së pari, dhe votat e shumicës së vendeve të rezervuara.

Nëse amendamentet e mia nuk e kanë pasur votën e shumicës së vendeve të rezervuara, amendamentet e propozuara nga sponsoruesi nuk e kanë pasur ashiqare votën e shumicës së deputetëve. Prandaj, interpretimi i saktë eventualisht mund të jetë që asnjëri variant, as varianti tjetër, nuk i ka pasur votat e nevojshme. Në këtë rast, interpretimi i saktë mbetet varianti i ligjeve të mëparshme dhe ai variant është shumë i mirë. Kështu është vepruar gjithmonë, sa herë një amendament i sponsoruesit nuk kalon, nuk e merr shumicën dhe amendamenti i Qeverisë, 2-3 amendamente që kam propozuar unë, janë rrëzuar me votën e shumicës së deputetëve. Në këtë rast, të dyja duhet të shpallen të pamiratuara, e të mbetet në fuqi dispozita e ligjit fillestar, që është zgjidhje shumë e mirë.

Unë angazhohem që kjo çështje të shqyrtohet në Komisionin e Kuvendit për Rregulloren e Kuvendit, duke përfshirë dhe procedurat - a mund të numërohen votat gjatë votimit? Rregullorja jonë e thotë shprehimisht: Pas përfundimit të votimit numërohen votat. A mund të ndërhyhet në atë mënyrë siç u ndërhy dhe të efektohet rezultati i votimit? Është shkelle e procedurës. Prandaj, kërkoj që po ashtu ligji të mos nënshkruhet nga kryetari i Kuvendit me këto defekte, nëse është nënshkruar do të ishte në rregull që Presidentja të mos e nënshkruajë, sepse është në kundërshtim me Kushtetutën dhe me konventat ndërkombëtare, në mënyrë që të mos detyrohem që këtë çështje ta procedoj edhe në Gjykatën Kushtetuese. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Hydajet! Por, shpjegimet nuk janë të sakta. Neni 81 i Kushtetutës e përcakton këtë, dhe paragrafi 2, dhe pikat në vazhdim tregojnë se amendamentet është dashur ta kenë votimin e dyfishtë.

Paragrafi 2 thotë: “Ligjet, të cilat i zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë”. Numërohen disa ligje, nën 3: Ligji për përdorimin e gjuhëve, Ligji për zgjedhjet lokale, Ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, Ligji për liritë fetare dhe për marrëveshjet me komunitetet fetare, Ligji për arsimin. Këto ligje i nënshtrohen votimit të dyfishtë, që do të thotë të vendeve të rezervuara, dhe nenet që i ke propozuar ti mund të më pëlqejnë mua dhe shumica ka votuar për to, por komunitetet pakicë kanë votuar kundër.

Shikojini rezultatet e votimit, ato flasin. Por, ajo është një çështje që është kryer dhe unë pyes për vërejtjet në procesverbal. Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar, a mund të flas rreth rendit të ditës, sepse e kam një kërkesë. Apo, pas përfundimit të miratimit të procesverbalit, nëse ma jepni fjalën, unë e kam një kërkesë. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, po. Fjalën e ka Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Është e pamundur ai që logjikon me germa të mos pajtohet me atë që tha zoti Hydajet Hyseni. Zoti Hydajet, edhe një herë të përgëzoj hapur në këtë Kuvend, që parimisht i ke shtruar edhe po i mbron idetë tua.

Pikërisht tash, nëse është puna që ta pranojmë këtë procesverbal, apo jo, është puna të sqarohen këto probleme, sepse formulimi nuk e thotë të vërtetën. U diskutua edhe atë ditë në Kryesi dhe është e saktë ajo që kam thënë unë, e që e mbron Hydajeti, sepse ndryshe s'mund të ndodhë. Meqë nuk kanë kaluar ato amendamente, vlen ligji fillestar dhe çdo interpretim kushtetues e ligjor, kushdo që do ta bëjë, do të mbërrijë atje, nëse ka vullnet të mbërrihet. Unë nuk di a ka vullnet, por nëse ka, mbërrihet atje. Edhe e dyta, që është shumë me rëndësi, që është shumë e dukshme, nëse nuk e ka fituar shumicën e atyre që kanë vende të rezervuara, të fala, qysh të doni quani, varianti e ka marrë shumicën e deputetëve, zotëri, dhe ju keni harruar që nuk është votuar dyfish dhe prandaj unë s'kam votuar herën e dytë, sepse ka qenë një mosmarrëveshje totale, sepse varianti i Hydajet Hysenit e ka marrë shumicën e deputetëve. Një krah është kryer, ai tjetri s'e ka marrë shumicën e deputetëve.

Gjendja siç ka mbaruar është që vlen vetëm ligji fillestar, i paamendamentuar, as prej Qeverisë, as prej zotit Hysenit, as prej votimeve tjera. Nuk mund të bëhet votimi i dyfishtë bisht i votimit. Njëri prej tij ta dominojë edhe votimin e përgjithshëm të Kuvendit. Amendamentet e Hysenit e kanë marrë shumicën në këtë Kuvend dhe ekzistojnë regjistrimet, shqyrt, besoj që ekzistojnë, nuk fshihen, dhe fjalët dalin në letër, e nuk ka nevojë t'i shes mend kurrkush kurrkujt. Le të merret dokumentacioni, le të analizohet, e unë po ju them që ligjërisht do të mbërrijnë këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Komisionit, Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Për herë të parë, kryetar, ma dhe fjalën pa e kërkuar. Po e marr, edhe pse nuk jam paraqitur.

Ok, po e marr fjalën, respekt. Tash është koha e miratimit të procesverbalit, e ne po ngremë tema të sfidimit të Rregullores. Nuk e di a ka pasur ndonjë mocion me të cilën është sfiduar Rregullorja. Ndoshta ka pasur. Nuk jam i informuar. Dhe, nuk dua të marr pjesë në këtë debat, por po dua ta cek atë që nuk është koha e shfaqjeve patriotike. Ne të gjithë jemi patriotë të mëdhenj, jemi dëshmuar për këtë, por gjithë këtij ligji i jemi qasur me përgjegjësi politike. Dhe, në fakt, nëse themi "ligji mbetet në fuqi", atëherë mbetet në fuqi Projektligji që e ka sjellë Qeveria, sepse amendamentet janë bërë në atë projektligj, e jo në projektligjin e vjetër, por në projektligjin që e ka dhënë Qeveria dhe nëse amendamenti s'ka kaluar, atëherë është varianti i Qeverisë, i cili në fakt e thotë atë që e ka thënë edhe Komisioni Funksional.

KRYETARI: Kuvendi i ka miratuar amendamentet dhe caktohen amendamentet që i ka votuar Kuvendi: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7a, 8a, 9a, 10a, 11, 12, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 29, 31, 34, 41a, 42a, 43, 44, 45, 46, 47, 48 dhe 49. Këto amendamente i ka miratuar Kuvendi. Këto amendamente e kanë marrë shumicën. Kuvendi nuk i miratoi këto amendamente: 7b, 8b, 9b, 10b, 13, 20, 28, 30, 32, 33, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41b dhe 42b.

Në fund, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara në tërësi dhe rezultati është 63 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Kjo çështje është kryer.

A keni vërejtje tjera në procesverbal? Jo çështje u krye. A keni vërejtje tjera në procesverbal? Mirë!

Kush është për miratimin e këtij procesverbali? Faleminderit! Kundër? Të pranishëm janë 78 deputetë, kundër kanë votuar 28. Do të thotë miratohet procesverbali.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës. Para se të vazhdojmë, fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

(Ndërhyrje)

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Ju lutem, ju lutem! Deputeti nuk është për t'i larguar njerëzit prej punës, ta keni parasysh. Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

SABRI HAMITI: E largon ligji!

KRYETARI: Deputeti nuk mund ta largojë. Ligji është diçka tjetër. Nuk jemi këtu për të larguar njerëz prej punës, por për të punësuar. Ismet Beqiri, e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Kur falsifikohen shifrat shkon në burg, e jo në punë.

ISMET BEQIRI: A mund të vazhdoj, kryetar? Po! Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që me këtë rast t'ju drejtohem, pse jo dhe pensionistëve të Republikës së Kosovës.

Ne si grup parlamentar kemi shpresuar se sot do ta marrim fjalën dhe në prag të heqjes së mbikëqyrjes së pavarësisë të jua japim edhe ndonjë lajm të mirë, që kërkesat tuaja për plotësimin e Ligjit për pensionet e financuara nga shteti janë marrë parasysh nga Qeveria, por fatkeqësisht kjo nuk ka ndodhur. Sot këtu para nesh e kemi po të njëjtin projektligj, që nuk ka pësuar kurrfarë ndryshimi pozitiv nga versioni i mëparshëm, që ky Kuvend e ka kthyer në Qeveri për ridraftim. Kërkesa jonë ka qenë që ky ligj të rishikohet dhe të merren në konsideratë kërkesat e arsyeshme të pensionistëve. Mund të themi me përgjegjësi të plotë se versioni aktual, përkundrazi ka pësuar përkeqësim në raport me versionin e mëparshëm. Tash vërejmë që kategoria e personave të larguar me dhunë nga puna në vitet e '90-ta është lënë jashtë këtij ligji.

KRYETARI: Ismet, kur të vijë ligji, fol për ligjin. Unë ta dhashë fjalën për mirëkuptim, ju lutem!

ISMET BEQIRI: Mirë, atëherë po e shkurtoj. Zoti kryetar, duke i pasur parasysh këto, nuk po e zgjas atëherë, sepse desha ta jap arsyeshmërinë çka po kërkojmë, në fund, ne si grup parlamentar. Ne si Grup Parlamentar i LDK-së, për arsye që, megjithatë po më kërkon ta shkurtoj, se janë shumë të fuqishme, , ne kërkojmë që ky projektligj t'i kthehet përsëri Qeverisë, sepse nuk i plotëson kërkesat elementare të parashtruara nga pensionistët, kërkesa këto të mundshme dhe të realizueshme. Ju e dini se, vetëm edhe këtë po e them, ka pasur ngritje të pagave të shërbyesve civilë, gjë që është në rregull, pa kurrfarë ndryshimi të projektligjeve të caktuara, ndërkaq edhe sot e kësaj dite, 20 për qind, sa është premtuar ngritja, dhënia e një shtese për pensionistët, kjo asnjëherë nuk është bërë, me arsyetime të ndryshme.

Prandaj, si grup parlamentar, meqenëse nuk po kam mundësi ta them deri në fund arsyeshmërinë, po e them vetëm kërkesën: Ne kërkojmë, pra ngremë mocion, në emër të grupit parlamentar, që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet, përkatësisht Projektligji t'i kthehet Qeverisë për ridraftim dhe plotësim me kërkesat elementare dhe të mundshme, e të realizueshme për pensionistët. Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Unë po kam respekt për ju, por deputetët e dinë se si bëhen mocionet për të tërhequr. Nganjëherë është mirë të bëhet me shkrim, për ta respektuar Rregulloren, të citohet neni 42 i Rregullos dhe nëse Kuvendi pajtohet ta heqë nga rendi i ditës, ne e heqim, por nuk besoj që është as në interesin e pensionistëve ta heqim këtë ligj nga rendi i ditës.

Kur të vijë kjo pikë e rendit të ditës, grupi juaj parlamentar le ta thotë përsëri fjalën e vetë. Unë jam për atë që vërtet ta krijojmë një kulturë debati, nën një, dhe nën dy, e kemi një Rregullore që e kemi miratuar, e lexojmë atë dhe kërkesat t'i bëjmë mbi bazën saj. Ne e kemi rekomandimin e komisionit përkatës për ta futur në rend dite dhe për ta miratuar në parim këtë projektligj. Ky është mendimi i komisionit përkatës. Neni 42, përcaktimi i rendit të ditës, pika 2, thotë: "Rendi i ditës konsiderohet i miratuar, përveçse kur në fillim të mbledhjes, një ose më shumë grupe parlamentare, përfaqësues të një ose më shumë komisioneve, së paku 6 deputetë, i propozojnë me shkrim kryetarit një amendament për rendin e ditës, përkatësisht nëse një deputet e ngre një çështje të ngutshme dhe e merr miratimin e shumicës". Pra, është e përcaktuar me shkrim, kurse ne me shkrim nuk e kemi pasur një kërkesë të tillë.

(Ndërhyrje)

Po nuk është kjo situatë e jashtëzakonshme të ngresh bash kur teket këso gjërash. Ka rend, nuk është kjo... Kur të vijë në rend të ditës, atëherë bisedojmë këtë çështje. Unë e lexova nenin 42, paragrafi 2 të Rregullos. Unë jam i obliguar ta respektoj Rregulloren. Ti e pate fjalën në emër të grupit, o deputet! Urdhëro, fjalën e ka Ismet Beqiri, kryetari i grupit.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar, ju lus, nuk është hera e parë kjo. Ju e dini mirë, e dinë edhe deputetët, që kemi pasur mocione të tilla dhe kemi votuar. Kjo është një e drejtë e grupit parlamentar ta ngrejë mocionin. A e merr votën, a nuk e merr, është çështje e

Kuvendit. Mos na e mohoni një drejtë elementare të grupit parlamentar. Ju e lexuat një pjesë të Rregullores, për të cilën ne jemi të vetëdijshëm se çfarë thotë, por edhe kjo tjetra pjesë është e ligjshme, është e drejtë e grupit parlamentar, jo vetëm tonit, por e çdo grupi parlamentar të ngrejë mocion në seancë, e deputetët deklarohen.

Kjo është e drejtë elementare. Prandaj, duke mos dëshiruar nga vendi ta themi secili nga një fjalë, mos na detyroni që ne të mos mund të marrim pjesë në seancë, nëse na shkelet një e drejtë elementare, një kërkesë elementare, edhe në bazë të Rregullores. Hidheni në një votim këtë, nëse nuk kalon - nuk kalon. Ajo është e drejtë e deputetëve. Por, ka arsye të plotë që kjo të hidhet në votim. Prandaj, kërkoj që ta hidhni në votim këtë kërkesë, përkatësisht këtë mocion të grupit tonë parlamentar.

Bëhet precedent nëse kjo nuk ndodh. Faleminderit!

KRYETARI: Cila është kërkesa juaj? Heqja nga rendi i ditës, apo kthimi në Qeveri? Nuk është njësoj! Regjia, fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Përshëndetje për ju, për Kabinetin qeveritar dhe deputetët, Ligji në fjalë, neni 8, pika 1, 2, ju lutem, urdhëroni lexojeni! Është një nen diskriminues në baza nacionale, dhe është turp që kemi arritur në këtë nivel. Ka kaluar nëpër instanca qeveritare, e kemi edhe memorandumin shpjegues prej Qeverisë. Lexojeni nenin 4. E vërteton të njëjtën gjë. Periudha dhjetëvjeçare - kur njerëzit largohen me dhunë nga puna, u merret e drejta për punë. Tash, jo që nuk luftohet për t'ua kthyer ato kompensime, por u hiqet edhe nga mundësia të trajtohet si pjesë e stazhit pensional.

Në atë kohë ka funksionuar arsimi. Pse nuk i ka paguar Qeveria serbe që ia rrjep këtij populli lëkurën, ky popull ka gjetur forcë i ka paguar arsimtarët. Ajo kohë nuk u merret si stazh pensional, kur ka funksionuar arsimi, kanë ekzistuar disa segmente të jetës. Prandaj, është diskriminim nacional, sepse vetëm shqiptarët kanë qenë të larguar. Po të kalojë një ligj i tillë, e turpëron këtë Parlament të shenjtë për mu.

KRYETARI: Ju lutem, ju lutem! Unë nuk po dua ta lexoj atë, se nuk e kam sot për detyrë. Ne kemi për detyrë rekomandimin e komisionit.

(Ndërhyrje)

Edhe atë e hedhim, por unë jam duke e drejtuar seancën. Kur të jesh ti, drejtoje qysh të duash ti! E unë po e drejtoj me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Unë ua lexova nenet, kurse ti bile nuk dihet as mbi bazën e cilit nen po e bën kërkesën. Nuk ka mocion të jashtëzakonshëm, se grupi juaj parlamentar ka qenë në komision.

(Ndërhyrje)

Jo, unë tash nuk jua lexoj Rregulloren, jua lexoj rekomandimin e komisionit.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e mbajtur më 4 korrik 2012, e shqyrtoi Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe

me shumicë votash vendosi që t'i rekomandojë Kuvendit projektligjin të miratohet në parim, ndërsa vërejtjet e deputetëve të adresohen në formë të amendamenteve gjatë shqyrtimit në komision. Ky është rekomandimi i komisionit. Mirë! Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri. Precizojë çfarë kërkon, cili është mocioni yt.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar, unë kërkoj që mocioni ynë të hidhet në votim dhe kërkesa është që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës dhe Qeverisë t'i kthehet Projektligji për ridraftim dhe përmirësim. Kjo është kërkesë dhe edhe njëherë po e them është një e drejtë e grupit parlamentar dhe praktikë që është zbatuar edhe më herët dhe nuk shkel kurrfarë procedure a rregullore. Kjo është kërkesa jonë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetë! Ky ligj mund të hiqet nga rendi i ditës dhe të vijë në seancën e ardhshme. Dëgjoni, ky ligj mund t'i kthehet Qeverisë pas debatit që bëhet këtu dhe votimit në parim. E dini këtë, sepse nuk jeni prej sot deputetë këtu!

Ju lutem! Unë po hedh në votim, por ju do ta bëni mocionin të saktë. A doni ta shtyjme? E shtyni në këtë seancë, por vjen në seancën tjetër. Për t'ia kthyer Qeverisë duhet të zhvillohet debati, e në fund, pati të bëhet votimi, i kthehet nëse kalon. Kështu është kjo rregull. Atëherë, kur të vijë në rend të ditës votojmë në parim. Ju mos votoni dhe ia kthejmë Qeverisë. Kjo është procedura.

Kërkesën për ta shtyrë mund ta hedhim në votim, kurse për t'ia kthyer Qeverisë jo. Jo! Qeverisë mund t'ia kthejmë kur të bëhet debati për ligjin. Kjo është rregull! E ministri ka të drejtë. Ministër, a do ta tërheqësh ligjin?

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Absolutisht, jo!

KRYETARI: E, ju lutem! Prandaj...

Unë po e di që ju po mundoheni diçka të bëni, por nuk keni të drejtë sipas Rregullores. Ju po doni t'ia ktheni Qeverisë? E bëjmë debatin, është në rend të ditës, votojmë në parim, nëse i ke votat me shumicë t'ia kthesh Qeverisë, ia kthejmë.

Unë e kam një votë, nuk kam më shumë, por rendi është kështu. Deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar,

Herën e kaluar e njëjta kërkesë ka qenë, t'i kthehet Qeverisë projektligji, për të cilin po flasim dhe kemi votuar, pa hyrë në këto, që tash s'po e them ju, po ndoshta edhe me sugjerime po i komplikoni. Kërkesa jonë është t'i kthehet ky projektligj Qeverisë. Ky projektligj nuk i plotëson kushtet dhe nevojat e kam fjalën, të atyre për të cilët është i dedikuar.

Unë e kuptoj se zoti Rashiq s'guxon ta tërheqë, ai është problem i tij, se i ka thënë ta qesë, por kërkesa e një grupi parlamentar është e ligjshme dhe ky Kuvend le të vendosë. Kurrfarë shkeljesh procedurale s'po bëhen.

KRYETARI: Kuvendi ka të drejtë të vendosë dhe s'po e mohoj këtë, por pasi të zhvillohet debati në parim për ligjin. Mund ta qes në votim që të shtyhet, por për t'ia kthyer Qeverisë, pa debat, nuk e kthej në këtë fazë, se e kemi raportin e Komisionit për këtë. E kemi ministrin këtu, që po e mbron ligjin dhe duhet të zhvillohet debati dhe mbas debatit mund t'i kthehet Qeverisë. Urdhëro fjalën, edhe një herë Ismet.

ISMET BEQIRI: Atëherë, ne kërkojmë që sot të hiqet nga rendi i ditës kjo pikë, për të tjerat jemi në seancat tjera, flasim.

KRYETARI: Faleminderit! Pra, kërkesa e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike është për ta shtyrë ligjin. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, ose të deklarohen edhe grupet tjera. Në emër të Partisë Demokratike, Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah shtyrjen për seancën e radhës.

KRYETARI: Nga "Vetëvendosje", fjalën e ka Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Ne e përkrahim dhe do ta përkrahim heqjen dhe kthimin e këtij ligji Qeverisë, për shkak se natyrisht, që nuk është askund në përputhje as me interesat e as me nevojat dhe kërkesat e pensionistëve. Por, këtu meqenëse tash u reduktua ky mocion, do të votojmë për ta shtyrë, por sinjerisht mendojmë se do t'i kthehet Qeverisë edhe njëherë dhe do t'i bënim thirrje Qeverisë që t'i hapë sytë dhe t'ua bëjë një zgjidhje këtyre njerëzve, për shkak se me këto ligje që po i sjell në Kuvend, vetëm sa po e rëndon edhe më shumë pozitën e tyre, tashmë të rëndë.

KRYETARI: Unë nuk jam as për, as kundër. Po, unë jam i obliguar t'i respektoj procedurat dhe për këtë jam këtu, përndryshe, këtu mund ta udhëheqë kushdo tjetër. Por, unë procedurat jam duke i respektuar, ligji mund t'i kthehet Qeverisë, por pasi të debatohet në parim. Fjalën e ka në emër të AAK-së, kryetari i Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Aleanca mendon se po bëhet gabim sot, se është dashur të diskutohet për ligjin edhe të votojmë kundër. Ne e kemi pasur në plan të votojmë kundër, me iu kthye ligji Qeverisë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundshme të vijë i përmirësuar. Nëse sot e shtyjme ligjin për një seancë tjetër, krejt çka mbërrijmë të bëjmë është ta shtyjme procedurën që ligji të përmirësohet. Edhe e thërrasim Kuvendin e Kosovës, të mos e shtyj ligjin, kur të vijë në rend të ditës të votojë kundër, t'ia kthej Qeverisë, në mënyrë që sa më shpejt ky ligj të përmirësohet.

Shtyrja është vetëm shtyrje e përmirësimit të ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Megjithatë, unë pajtohem me këtë që e tha Ardiani.

Fjalën e ka kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Qeverinë dhe për deputetët!

Duke marrë parasysh se është i njëjti ligj, identik siç ka qenë herën e kaluar, atëherë zgjedhja e këtij ligji për një seancë të ardhshme, me propozimin e përfaqësuesit të LDK-së, PDK-së, unë them se i vetmi vend, ku mund të plotësohet dhe ndryshohet ligji janë Kuvendi i Kosovës dhe Komisioni Parlamentar.

Na jemi kah e shohim që është ligji i njëjtë dhe në rast se dëshirojmë të ndryshojmë atë çka po e kërkojnë edhe pensionistët edhe grupet parlamentare, atëherë i vetmi vend është Komisioni Parlamentar dhe Kuvendi i Kosovës.

Atëherë e shohim, e shtyjme për një seancë të ardhshme, por nuk e di sa do të ketë zgjidhje të këtij problemi.

KRYETARI: Në emër të SLS-së, kryetari Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Mi smatramo da su svi uslovi ispunjeni da ova tačka dnevnog reda bude danas na Skupštini Kosova.

KRYETARI: Edhe me ty pajtohem, Sashë. Në emër të Grupit “6+”, a ka? Nuk ka.

A po pajtoheni të kalojmë në rend të ditës, apo ta shtyjme? Ta shtyjme. Atëherë lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë mocionin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

Votojmë tash.

Me 61 vota për, 19 kundër, 3 abstenime, shtyhet për seancën e radhës.

Unë e kam fjalën, jo për seancën që e kemi thirrur, por për atë që duhet ta thërrasim. Unë po pajtohem me Arsimin, që tha për patriotizmin, e lëmë njëherë, nuk jemi këtu për atë, jemi për të miratuar ligje.

(Ndërhyrje)

Po, mirë u bë. Mirë, po pajtohem që ajo është gjithë, po duhet të jemi pak më racionalë, më gjakftohtë.

4. Votimi i Projektrezolutës lidhur me përdorimin e tri kodeve të huaja telefonike në Kosovë

(Ndërhyrje)

Po, koha është shumë faktor i rëndësishëm. Debatimi është kryer. Propozimin e Rezolutës. 84 deputetë jemi të pranishëm. Unë s’kisha shkuar më në debat sepse e kemi kryer. Me votë flisni të gjithë. Lus deputetët dhe regjinë dhe votojmë tash.

Me 47 vota për, 9 kundër, 2 abstenime, Kuvendi e miratoi Rezolutën.

Materialin e keni pasur përpara dhe kjo u krye.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve financiare për kredi dhe projekte ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj

Presidentja e Republikës së Kosovës në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës së Kosovës ka proceduar në Kuvend projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes financiare për kredi dhe projekt ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka paraqitur për rekomandim. Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza si propozues i çështjes.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministra, ministra

Kam kënaqësinë që sot para jush të paraqes një projekt shumë me rëndësi për jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ministria e Financave në bazë të autorizimeve të dhëna me Ligjin për borxhin publik dhe pas negociatave intensive të zhvilluara me Bankën Gjermane për Zhvillim, ka arritur që të hyjë në marrëveshjen financiare për kredi në shumë prej 20.000.000 euro dhe në marrëveshje për kontribut financiar grand në shumë prej 4.900.000 euro.

Këto mjete kanë qëllim të caktuar, përkatësisht dedikohen për projektin faza 3, furnizimi komunal me ujë, ujëra të zeza në Prishtinë. Këto fonde do t'i dedikohen projektit të sektorit të ujit në Komunën e Prishtinës.

Ky projekt në vete përmban këta komponentë:

- ndërtimin e fabrikës së re të ujit në Shkabaj,
- ndërtimin e rrjetit të ri të ujit,
- stacionin e pompimit që mundëson kyçjen e fabrikës së re të ujit në kanalin e Ibrit dhe në rrjetin tjetër ekzistues.

Ky projektligj gjithashtu përmban investime për mbrojtjen e kanalit të Ibrit. Kapacitetet e instaluara të fabrikës së ujit do të jenë 1.200 litra në sekondë. Projekti parashihet të finalizohet brenda dy fazave.

Faza e parë do të prodhojë 700 litra ujë në sekondë, kurse faza e dytë do të prodhojë 500 litra ujë në sekondë. Kështu që do të përmbyllet projekti i fabrikës së ujit, për prodhimin e 1.200 litrave në sekondë, që do të siguronte furnizim me ujë për tërë regjionin e Prishtinës.

Marrëveshja është negociuar me kushte të volitshme. Norma e interesit sillet rreth 4.5% dhe do të aplikohet në shumën e tërhequr të kredisë. Norma e taksës zotuese është 0.25% dhe do të aplikohet në shumën e pa tërhequr të kredisë.

Kredia e ka një grejs-periudhë prej tre vjetësh dhe një afat pagese po ashtu, prej 9 vjetësh të tjera, duke filluar me pagesa nga viti 2015 dhe duke përfunduar kthimin në vitin 2024.

Të nderuar deputetë, është e rëndësishme të theksohet se këto kapacitete të ujit do të jenë të mjaftueshme që të ketë furnizim me ujë të pijshëm 24 orë, për 20 - 30 vjetët e ardhshme për regjionin e Prishtinës.

Me këtë projekt përfitojnë 40% e popullsisë së Kosovës. Përveç që rregullon problemin e ujit të pijes për vitet në vijim, po ashtu mundëson që të shfrytëzohet si burim i ujit alternativ, në rast të thatësisë që do ta kemi të pranishme në periudhën e ardhshme.

Kjo fabrikë do ta shfrytëzojë ujin e Liqenit të Gazivodës. Në rast se sot paraqitet mungesa e ujit në Liqenin e Badocit dhe Batllavës, Prishtina dhe rrethina do të mbetet pa alternativë të shfrytëzimit të resurseve ujore.

Ky investim i mundëson alternativë shtesë, që parashikohet të jetë i mjaftueshëm dhe i domosdoshëm për këtë regjion. Po ashtu, vlen të theksohet se kjo kredi do të kthehet nga Kompania e Ujësjellësit Rajonal "Prishtina". Qeveria e Republikës së Kosovës në këtë marrëveshje është garantues. Ky investim është komplet investim kapital dhe është vazhdimësi e dy fazave të mëhershme, që po ashtu janë donacion i Qeverisë gjermane dhe Komisionit Evropian, që implementohen nëpërmjet Bankës Gjermane për Zhvillim.

Investimet në Kompaninë e Ujësjellësit rajonal "Prishtina" janë ndarë në tri faza. Kjo që po diskutohet sot është faza e tretë. Faza e parë dhe e dytë janë duke u implementuar dhe me këto dy faza paraprake do të rehabilitohet pjesa më e madhe e rrjetit, pompave, stacionit të filtrimit, që kanë objektiv zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe rritjen e shkallës së inkasimit dhe mbrojtjen e burimeve ujore.

Këto masa që janë duke u implementuar në fazën e parë dhe të dytë i mundësojnë kompanisë të ngre performansën financiare dhe teknike dhe të jenë në gjendje ta kthejnë këtë kredi pa asnjë vështirësi.

Prandaj, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projekti për qytetarët e Republikës së Kosovës, për qytetarët e regjionit të Prishtinës, rekomandoj që e njëjta të aprovohet. Duke ju falënderuar dhe duke iu lutur që të votohet, nevojiten 80 vota. Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: ...Fjalën kryetares së Komisionit dhe kryetarëve të grupeve parlamentare. Ju bëj me dije, deputetë të nderuar, ne si Kuvend kemi votuar dhe kemi pasur të drejtë të votojmë vetëm Rezolutën e deputetit Agim Kuleta. Kështu që, asnjë rezolutë tjetër ne nuk do ta qitshim në votim. Kështu që mos u bëni merak. Kemi votuar një rezolutë, për të cilën kemi pasur të drejtë ta votojmë.

Asnjë rezolutë tjetër, përveç Rezolutës së Agim Kuletës s'kemi pasur të drejtë ta votojmë.

(Ndërhyrje: Kur të jenë dy...)

Jo, jo, ne veç e kemi votuar vetëm një rezolutë, Rezolutën e deputetit Agim Kuleta, mbi bazën e të cilit është bërë debati. Asnjë rezolutë tjetër, kurrë nuk do ta hedh në votim para rezolutës, që propozohet e para. Se ka fituar e para.

A e keni të qartë tash? Po, mësoni se këto rregulla janë. S'i kam përcaktuar unë, të gjithë i kemi përcaktuar.

Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa në bazë të dispozitave të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 10 korrik 2012 e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për kredi dhe projekt, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim, lidhur me fabrikën e ujit në Shkabaj, ku ka qenë i pranishëm edhe ministri i Financave zoti Hamza. Anëtarët e Komisionit kanë marrë përgjigje, të cilat kanë e parë të arsyeshme t'i marrin nga ministri i Financave dhe në fund kanë rekomanduar që të miratohet Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes financiare për kredi dhe projekte ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim, lidhur me fabrikën e ujit në Shkabaj.

Ftojme deputetët që ta miratojnë këtë marrëveshje, këtë projektligj për marrëveshjen.

KRYETARI: A fole edhe në emër të Grupit Parlamentar...?

SAFETE HADËRGJONAJ: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar po ashtu këtë projektligj për marrëveshjen financiare për kredi dhe kemi ardhur në përfundim, që kjo marrëveshje të votohet.

Prandaj, e përkrahim rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

KRYETARI: Faleminderit!

Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Pa elaboruar, u tha nga ministri, u tha edhe nga kryetarja e Komisionit, është një marrëveshje, mund të thuhet jetike dhe shumë e rëndësishme. Grupi Parlamentar i LDK-së do të votojë pro. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të “Vetëvendosjes”, kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” do të votojë për këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Ardian Gjini i AAK-së.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Aleanca e mbështet ratifikimin e marrëveshjes. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kryetarja e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e përkrah Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes financiare për kredi për projektin ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe përfaqësuesve nga Banka Gjermane KfG, lidhur me Fabrikën e Ujit në Shkabaj.

Duke ditur rëndësinë e kësaj, shpresoj se do të merr votat e mjaftueshme në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së. Sasha ku është. Mirë, pajtohet Sasha. “6+”i? Gjithashtu. Mirë, faleminderit!

Është mirë, deputetët që janë këtu pari, të kthehen dhe të votojmë.

Pra, në bazë të nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e 2/3-ve të të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare.

Kemi prezentë 85 deputetë. Edhe një erdhi 86, 90. Mirë, atëherë shkojmë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash. Faleminderit!

Me 88 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes financiare për kredi dhe projekte ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Gjermane për Zhvillim, lidhur me fabrikën e ujit në Shkabaj.

Pika e gjashtë u shty nga rendi i ditës për sot. Pika e shtatë:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra, deputetë të nderuar,

Duke marrë parasysh kornizën strategjike për procesin e integritit evropian të Republikës së Kosovës dhe obligimet e parapara të vendit për përafrimin e legjislacionit tonë me atë të BE-së, Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur në strategjinë legjislative për vitin 2012 ndryshim-plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Ndryshim-plotësimet e propozuara në Ligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave, për institucionet financiare në Kosovë, synojnë avancimin e sistemit për sigurimin e depozitave në përputhje me direktivën e re të BE-s, për skemat e sigurimit të depozitave të propozuara nga Komisioni Evropian për ndryshim të direktivës 94/19 duke përfshirë këtu edhe praktikën më të mira për eliminimin e mangësive, gjë që sigurojë një pagesë më të shpejtë dhe efikase.

Miratimi i ndryshimeve të propozuara të ligjit do t'i mundësojë Fondit të sigurimit të depozitave në Kosovë, që të mbrojë depozituesit e vegjël në mënyrë më efikase dhe që të ruajë besimin e depozituesit në sistemin bankar dhe në këtë mënyrë ta ndihmojë stabilitetin financiar në Kosovë.

Në vitin 2010, ne për herë të parë e sollëm në fuqi Ligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë, si rezultat i ndryshimeve të Ligjit për bankat në vitin 2011, si dhe duke marrë parasysh direktivat e fundit të BE-së, të cilat hyjnë në fuqi për sistemin e sigurimit të depozitave dhe praktikën më të avancuar ndërkombëtare për skemat e sigurimit të depozitave, ne u detyruam t'i paraqesim plotësim-ndryshimet e Ligjit për themelimin e sistemit të sigurimit të depozitave për institucionet financiare në Kosovë, që ta avancojmë bazën ligjore ekzistuese.

Përveç kësaj, në ndryshimet e propozuara janë përfshirë edhe dispozitat, të cilat mbështesin implementimin e plotë të ligjit bazë.

Ministria e Financave gjatë draftimit të ndryshimeve të ligjit ka zhvilluar konsultime të gjëra, përfshirë Bankën Qendrore, Fondin për sigurimin e depozitave në Kosovë, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe institucione tjera vendore dhe ndërkombëtare, të lidhura në këtë fushë.

Të gjitha palët e konsultuara e kanë pasur draftligjin me komente, rekomandime dhe propozime. Po ashtu, ndryshimi i Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave, për institucionet financiare në Kosovë është planifikuar nga Qeveria e Kosovës dhe është në letrën e qëllimeve drejtuar Fondit Monetar, me synim të harmonizimit të këtij ligji me Ligjin për bankat. Prandaj, miratimi i këtij projektligji i siguron që Kosova të vazhdojë të ketë një stabilitet në sistemin financiar.

Konsiderojmë se ky projektligj është në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e sigurimit të depozitave dhe si i tillë, i lus deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, që ta aprovojnë.

Ju faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Faleminderit! Hapim debatin lidhur me ligjin. Kryetarja e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, deputetja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit Qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për instrumentet financiare në Kosovë dhe ka rekomanduar miratimin e këtij projektligji.

Në këtë projektligj pasqyrohen ndryshimet, që rrjedhin nga Ligji i ri për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet jobankare si dhe merren parasysh ndryshimet në direktivën e Bashkimit Evropian, për skemat e sigurimit të depozitave të propozuara nga Komisioni i Bashkimit Evropian, më 2 korrik të vitit 2010.

Plotësim-ndryshimet në Ligjin për sigurimin e depozitave synojnë në avancimin e sistemit të Kosovës për sigurimin e depozitave në përputhje me direktivat e Bashkësisë Evropiane dhe janë të përfshira praktikat më të mira për eliminimin e mangësive, gjë që do të sigurojë një pagim më të shpejtë dhe më efikas.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka qenë i mendimit që ligji përgjithësisht është i përgatitur mirë, kështu që ka rekomanduar që deputetët t'i përkrahin këto plotësim-ndryshime të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, zonja Hasime Krasniqi e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për ndryshimin e Ligjit me numër 03/L-216 për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave në institucionet financiare në Kosovë ka për qëllim ndërtimin e infrastrukturës ligjore për ta sjellë fondin e sigurimit të depozitave në Kosovë, në transaksionet e blerjes dhe marrjes në përputhje me ligjin e ri për bankat, si një nga metodat e zgjedhjes të bankave për të promovuar një sistem të shëndoshë dhe të qëndrueshëm bankar dhe financiar, si dhe për të siguruar një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së interesave të depozitarëve.

Me këto ndryshimet e propozuara në këtë projektligj janë përfshirë praktikrat më të mira për eliminimin e mangësive gjë që do të sigurojë një pagim më të shpejtë dhe më efikas në rast të dështimit të ndonjë banke dhe afati i pagesës do të zvogëlohet nga 60 në 30 ditë. Si dhe ligji do të bëhet më efektiv në interes të depozitarëve të vegjël.

Projektligji është në harmoni të plotë me praktikrat dhe standardet më të mira ndërkombëtare dhe në harmoni të plotë me direktivat e BE-së për skemat e sigurimit të depozitave. Po ashtu, projektligji nuk ka kosto shtesë buxhetore përpos kostos fillestare të paraparë dhe për këtë arsye Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës në parim do ta mbështesë këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin Funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Konsiderojmë që ndryshimi i Ligjit për sigurimin e depozitave që kemi përpara është në harmoni të plotë me ligjin bazik, të cilin e kemi aprovuar më herët. Është fjala për Ligjin për bankat, institucionet financiare dhe i cili e sqaron në mënyrë shumë të detajuar në përgjithësi që ka të bëjë me krijimin e Fondit për sigurimin e depozitave.

Është për të diskutuar vlera prej 2.000 euro, domethënë pse është kjo vlerë 2.000 edhe është për t'u diskutuar 5% i Fondit duke e krahasuar vlerën e të gjitha mjeteve të deponuara. Përndryshe, është mirë i punuar, ka vetëm nevojë për disa detale në ndërhyrjen e Komisionit Funksional dhe ne do ta përkrahim si të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e mbështet në parim këtë ligj dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin Funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit! I nderuar zoti kryesues!

Të nderuar ministra dhe kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës e mbështet këtë projektligj dhe shpresojmë se do të ketë një avancim më të mirë të këtij projektligji që përfarohet me ligjet e BE-së.

Gjithashtu do të arrihet edhe një stabilitet financiar, prandaj Grupi i Aleancës do ta përkrahë dhe do të japë kontributin e vetë me komisionet përkatëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, zoti Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra

Kolegë deputetë,

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah këtë projektligj. Kontributin e vet do ta japë në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Balje, “6+”.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna Grupa „6+“ podržace Nacrt zakona o izmenama i dopunama Zakona za osnivanje za osiguranje depozita i za finansijske institucije Kosova i svoj doprinos daće kroz rad u Funkcionalnoj Komisiji.

KRYESUESI: Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës, nuk ka kuorum për ta votuar. Të shohim në fund ta votojmë pikën e shtatë, pasi që të ketë kuorum në sallë.

Pika e tetë e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime. Ftoj ministren e Tregtisë dhe Industrisë, zonjën Mimoza Kusari Lila, që para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. E keni fjalën zonja ministresh.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Ministrisë Tregtisë dhe Industrisë si bartëse e këtij projekti legjislativ, shkurtimisht të paraqes: qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme.

Arsyeshmëria për këtë projektligj është vendosja e bazës juridike dhe administrative për procedurën dhe kushtet e regjistrimit të pengut në regjistër për sendet e luajtshme, ndryshimi, kërkimi i informacionit si dhe administrimi i regjistrit të pengut. Regjistrimi i

pengut do të jetë regjistër publik, i cili themelohet me qëllim të regjistrimit të pengut për sendet e luajtshme të personave fizikë dhe juridikë, si dhe marrjen e informatave për pengjet në pajtim me këtë ligj. Në të drejtën evropiane, përkatësisht në aquí comunitare të BU-së e drejta e regjistrimit të pengut nuk është e rregulluar me ndonjë direktivë apo rregullore përkatëse dhe të gjitha shtetet anëtare këtë të drejtë e rregullojnë sipas kushteve dhe rrethanave specifike të çdo shteti anëtar. Regjistri i pengut lehtëson transaksionet financiare duke ofruar informata dhe besim për kreditorët në lidhje me pretendimet ndaj interesave pronësore në sendet e luajtshme që ka efektin e zvogëlimit të rreziqeve të kreditimit, si dhe rritjes së qasjes në kredi. Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren nr. 09 2011 për punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar deklarata financiare nga Ministria e Financave dhe deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian nga Ministria e Integritetit Evropian.

Projektligji ka 32 nene dhe ka formën standarde që parashihet për aktet juridike në Republikën e Kosovës dhe është i përgatitur në tri gjuhë. Projektligji për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme ka kaluar të gjitha fazat e dëgjimeve publike. Janë organizuar takime të ndryshme me palët e jashtme të interesit, Shoqata e Bankave të Kosovës duke përfaqësuar anëtarët e vet ka kontribuar duke ia paraqitur Kuvendit dhe propozimet të tyre të cilat janë përfshirë në këtë projektligj. Regjistri i pengut parashihet t'i lehtësojë transaksionet financiare duke ofruar informata, parashikueshmëri për kreditorët në lidhje me pretendimet ndaj interesave pronësore në pronën e luajtshme që ka për qëllim efektin e zvogëlimit të rreziqeve të kreditimit dhe rritjes së qasjes në kredi.

Karakteristikat dhe përparësitë e këtij projektligji janë: regjistri shërben si depo për ruajtje dhe qarkullim të informacionit, përputhshmëria me praktikën më të mirë ndërkombëtare, procedura e thjeshtë dhe efikase, qasja elektronike në regjistër, qasje më e lehtë nga institucionet financiare dhe në fund lehtësimi i mbledhjes së të hyrave qeveritare. Hartimi i projektligjit në fjalë konsiderohet se është i arsyeshëm dhe i domosdoshëm pasi nuk ka legjislacion të aplikueshëm që e mbulon fushën e regjistrimit të pengut për sendet e luajtshme.

Të nderuar deputetë,

Duke qenë të vetëdijshëm se nuk ka legjislacion të aplikueshëm që e mbulon fushën e regjistrimit të pengut në regjistër për sendet e luajtshme dhe duke pasur parasysh se projektligji i propozuar është draftuar në përputhje me standarde dhe praktikën më të mira ndërkombëtare dhe evropiane, ju propozoj që këtë projektligj ta shqyrtoni dhe miratoni në këtë seancë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Kusari! Radhën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka trajtuar këtë projektligj në javën që shkoi. Rrjedhimisht e ka aprovuar në parim dhe kërkon nga Kuvendi që ta procedojë më tej.

Dëshiroj të theksoj vetëm diçka, atë që edhe zonja ministre e tha që nuk ka në legjislacionin e BE-së ndonjë ligj ose ndonjë amendament që e përcakton këtë projektligj ose një diçka që duhet përputhur plotësisht, por ka vetëm praktika të ndryshme të shteteve të ndryshme. Kërkoj që në procesin në vijim edhe brenda Komisionit Funkcional, por edhe deputetët që janë të interesuar t'i japin propozimet e tyre në mënyrë që në ndërkohë të mos na dalë që të bëjmë ndonjë praktikë ose të bëjmë diçka që nesër nuk do të mund të përputhej eventualisht me ndonjë draft ose me ligj të ri që mund të jetë nga legjislacioni i BE-së.

Po ashtu, dëshiroj të theksoj që kemi pasur një mangësi të madhe nga ky ligj. Ka pasur procedura të mëdha burokratike. Ky ligj tanimë nëse vjen sa më shpejt i miratuar në Kuvend, do të jetë një bazë elektronike, ku do të hiqen procedurat e ndryshme burokratike dhe do të jetë shumë më lehtë edhe për qytetarët, por edhe për kredi dhënës për shkak të informacioneve të sakta në një vend që do të jenë në shfrytëzim për të gjithë ata. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i PDK-së e ka një emër të paraqitur më duket, që nuk është në sallë, Berat Buzhala. Zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Grupi Parlamentar i PDK-së e mbështet dhe do të japim kontributin tonë në komision lidhur me këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku, në emër të LDK-së.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar kryesues, zoti Haliti!

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,

Projektligjin për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme, Grupi Parlamentar i LDK-së, të cilin sot e kemi në shqyrtim e ka shqyrtuar me vëmendje.

Për LDK-në ky projektligj e ka rëndësinë e vetë pasi që vjen nga pakoja e ligjeve që duhet të jetë në funksion të krijimit të një ambienti më tërheqës për bizneset. Më saktësisht, nëpërmjet regjistrimit të pasurisë së luajtshme pengu ndikon në krijimin e balancës në tregun e kredive. Nisur nga këto qëllime, atëherë projektligji i përmbush objektivat që synon, kjo del nga fakti se me të përcaktohen procedurat me kushtet e regjistrimit të pengut në regjistër për sendet e luajtshme, ndryshimi i informacionit, si dhe administrimi i regjistrimit të pengut. Ndërkaq ai qëndron ngushtë i lidhur me Ligjin për pronësi dhe të drejtat e tjera sendore. Fakt i cili vërehet që nga neni 3, pika 1.2 që ka të bëjë me përkufizimet. Gjatë shqyrtimit të këtij ligji, LDK-ja në përgjithësi nuk ka ndonjë vërejtje thelbësore, meqenëse gjuha dhe shprehjet e përdorura janë mjaftë të qarta dhe nuk krijojnë konfuzion. LDK-ja ka vetëm disa vërejtje, të cilat më shumë janë të natyrës teknike, përkatësisht që meritojnë të sqarohen edhe më shumë ashtu që ky dokument të jetë më i kuptueshëm dhe më i zbatueshëm.

Në nenin 4 të projektligjit thuhet se organizimi dhe funksionimi i Divizionit të regjistrimit të pengut rregullohet me akte nënligjore për organizimin dhe strukturimin e brendshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Këtu mungon përkufizimi kohor,

përkatësisht caktimi i afatit se kur duhen të jetë gati aktet nënligjore ashtu që të mos humbet kohë me zbatimin e ligjit. Nën 2, neni 8 pika 4, thuhet se sistemi i regjistrimit të pengut i jep pronarit të llogarisë së përdoruesit arsyet e refuzimit të një regjistrimi. Kjo zgjidhje krijon mundësinë e vendosjes në bazë të bindjes individuale të personit përgjegjës, meqenëse nuk saktëson se nën cilat rrethana mund të refuzohet regjistrimi. Nën 3 - neni 12, rregullimi i çështjeve kontestuese në këtë nen rregullohet mënyra e parashtrimit të ankesave nëse personi ka vërejtje në punën e Divizionit për regjistrimin e pengut. Rreth kësaj çështje kam dy vërejtje, e para, kush mund të jetë personi që mund të ketë vërejtje, a mund të jetë secili qytetarë apo ai që kërkon një shërbim nga divizioni, propozoj që kjo çështje të precizohet dhe të thuhet - personi që kërkon regjistrimin e një pengu. E dyta ka të bëjë me pikën 3 të këtij neni që kjo të jetë më e qartë po përmend pikat tjera, sipas të cilat personi fillimisht mund t'i drejtohet kryeshefit të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, ai e ka kompetencë të shqyrtojë rastin dhe të kërkojë ndërmarrjen e masave me qëllim të zgjedhjes së tij. Në pikën 3 thuhet se, citoj: “nëse nuk ka zgjidhje brenda 3 dite pune nga pranimi i kërkesës, aplikuesi mund t'i drejtohet Komisionit për shqyrtimin e ankesave në kuadër të Agjencisë dhe këtu përfundon e tërë çështja. Pra, mjafton që ai t'i drejtohet Komisionit, por nuk thuhet kur duhet të marrë përgjigje dhe çka do të thotë nëse ai nuk është i kënaqur me këtë përgjigje.

Nga kjo vërehet se mënyrë e zgjedhjes së një kontesti mbetet e mbyllur brenda një institucioni, e në këtë rast është Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve pa i dhënë mundësi palës që të drejtën e vet ta kërkojë edhe diku tjetër. Përkatësisht nëpërmjet ndonjë mekanizimi të pavarur që mund të jetë arbitrazhi apo edhe gjykata duke iu afuar palës këtë mundësi atë e sigurojnë që nuk do të mbetet vetëm në mëshirën e një mekanizimi administrativ e burokratik. Propozoj që këtij neni t'i shtohet edhe pika 4, me të cilin palës i mundësohet që në rastin kur është i pakënaqur me përgjigjen nga Komisioni t'i drejtohet arbitrazhit të Odës Ekonomike të Kosovës.

Në nenin 16, për vlefshmërinë e regjistrimit të pengut është një gabim i vogël teknik, por vërejtja ime kryesore qëndron në faktin se aty thuhet se regjistrimi është i pavlefshëm nëse nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e këtij ligji. Por, cilat janë kërkesat e ligjit apo në cilin nen të këtij ligji përshkruhen kërkesat që duhet të plotësohen? Përafërsisht zgjedhje e njëjtë përshkruhet edhe në pikën 1.4 të nenit 18, ku nga personi që bën regjistrimin, kërkohet të dorëzojë tërë informacionin e kërkuar sipas këtij ligji. Edhe këtu mungon precizimi i informacionit, përkatësisht ky nen me të cilin nen, me nenet tjera të këtij ligji është në ndërlidhje.

Grupi Parlamentar i LDK-së në parim do ta përkrahë Projektligjin për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme. Grupi Parlamentar i LDK-së nëpërmjet anëtarëve të vet në komisionet që do të jenë do t'i paraqesë edhe disa rekomandime tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, kryetari i Grupit, zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” e ka shqyrtuar ligjin dhe në parim do ta votojë atë. Vërejtjet tona që i kemi nuk janë shumë, janë teknike nuk dua t’i lexoj këtu por do t’i jap ato nëpërmjet Komisionit Funkcional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar AAK, s’është askush i paraqitur. Koalicioni Kosova e Re, kryetarja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin e pengut në regjistër të sendeve të paluajtshme duke e parë se ministrja e dha pasqyrën e vet në lidhje me çështjen e këtij ligji dhe rëndësinë e këtij ligji dhe miratimi nga deputetët e Koalicionit për Kosovë të Re që të jepet përkrahja këtij ligji për arsye shumë të rëndësishme të zhvillimit të ambientit biznesor dhe plotësimit të konditave të BE-së, atëherë Koalicioni për Kosovë të Re jep përkrahjen këtij ligji. Mirëpo, ka mundësi që gjatë amendamentimit lëshimet teknike që kanë ndodh në ligj të përmirësohen.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmeti e ka fjalën.

AMIR AHMETI: Faleminderit, nënkryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

E mirëpresim qysh e tha edhe shefja e grupit, si grup parlamentar do ta votojmë në parim këtë projektligj dhe konsiderojmë që është shumë i rëndësishëm që ka ardhur në Parlament për t’u votua, sepse ka qenë mungesë e madhe për institucionet financiare sidomos. Kjo ka rezultuar edhe me shumë kredi të këqija dhe ngarkesë të gjykatave të Kosovës për problemin e këtij regjistrimit të pengut.

Edhe pse ka pasur një rregullore të brendshme të institucione financiare në koordinim me Bankën Qendrore për regjistrimin e pengut, megjithatë për interes të institucioneve financiare të cilat kanë dashur të japin kredi dhe ndoshta nuk i kanë dhënë shumë rëndësi të madhe në mungesë Ligjit- regjistrimit të pengut, kemi pasur kredi të këqija gjatë kësaj periudhe dhe këto kanë shkaktuar probleme shumë të mëdha nëpër gjykata. Konsideroj se me miratimin e këtij ligji do të pakësohen këto probleme dhe do të kemi edhe më pak probleme edhe më pak kredi të këqija.

Unë këtu do të përmend vetëm një vlerësim timin për nenin 23, ku shkruan kohëzgjatja e regjistrimit të pengut, pika 1 e nenit 23 thotë: “Një regjistrim është i vlefshëm për një periudhë deri në 25 vjet, varësisht prej zgjedhjes së pronarit të llogarisë së përdoruesit përmes përdorimit të SRP-së” dhe nën dy, thotë: “Kohëzgjatja mund të vazhdohet sipas dispozitave të këtij ligji”.

Nëse një peng është i vlefshëm për 25 vjet, a ka qenë qëllimi i përpiluesve të Ligjit për vlefshmërinë e pengut apo për dokumentimin e saj si në arkiv deri në 25 vjet, sepse nuk është e specifikuar këtu. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja ministreshë, e doni fjalën? Jo. Edhe për këtë pikë të rendit ditës për të votuar nuk ka kuorum. Unë ju lus që të paktën para se ta marrim pauzën deputetët të kthehen në sallë, i lus kryetarët e grupeve që të komunikojnë me grupet e tyre. Për të votuar tani është ligji i tretë që s'ka kuorum. Pika e nëntë e rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtari kërkimore, shkencore, inovacione dhe teknologji

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zotin Ramë Buja, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Buja e keni fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues,
Të nderuar ministra,
Të respektuar dhe të nderuar deputetë,
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nëpërmjet Projektligjit për veprimtarinë kërkimore-shkencore, inovacione dhe teknologji, ka trajtuar këto çështje kryesore: kërkimet shkencore, shkencën si veçanti, inovacionin dhe teknologjinë.

Përafrimi i legjislacionit nga fusha e veprimtarisë kërkimore- shkencore, inovacione e teknologji, me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, është prioritet i Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke pasur për bazë edhe faktin se edhe në Raportin e Progresit të vitit 201 është rekomanduar një përafrim i tillë i legjislacionit.

Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka vendosur që ky akt ligjor të jetë një ndër ligjet me prioritet për t'u plotësuar dhe ndryshuar dhe është përfshirë në programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2012.

Ndër sfidat kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës është krijimi i një sistemi të mirëfilltë ligjor dhe efikas në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, si rezultat i mospërputhjes të disa standardeve ndërkombëtare, përkatësisht mungesës së mirëfilltë të konkretizimit të disa normave juridike që rregullojnë veprimtarinë kërkimore shkencore, si dhe normat e reja për inovacione dhe teknologji.

Duke i pasur parasysh këto fakte, ndërhyrja e Qeverisë për rregullimin e organizimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, inovacione dhe teknologji, është e domosdoshme dhe shumë e nevojshme për t'i përcaktuar rregullat standarde të organizimit të veprimtarisë kërkimore, shkencore, inovacionit dhe teknologjisë, për të evituar veprimet e kundërligjshme në këto fusha. Andaj duke u mbështetur në këto fakte, opinionimi më i rekomanduar i Qeverisë është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit 2004/42 dhe propozohet që Projektligji për veprimtarinë kërkimore- shkencore, inovacione e teknologji të ndryshohet për aq sa është bërë ndryshimi.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2004/42 për veprimtarinë kërkimore-shkencore përmban gjithsej 91 nene.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nëpërmjet mekanizmave të saj monitoron zbatimin e këtij ligji, është e nënkuptuar.

Zbatimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimtarinë kërkimore-shkencore, inovacion dhe teknologji parasheh implikime buxhetore nga buxheti i Republikës së Kosovës, por obligimet buxhetore janë bartur në vitin 2016.

Po qe se krijohen kushtet financiare dhe pas një vlerësimi ekzakt të kostos financiare të periudhës vijuese, deklarata financiare e miratuar nga Ministria e Financave, e bashkangjitur projektligjit është bashkë me atë draft që ju e keni përpara.

Konsultimet janë bërë me të gjitha ministrinë që në fakt gjithsesi duhet të jenë të implikuara në këtë projektligj dhe ligj më pastaj, siç janë: Ministria e Financave, Ministria e Integrimeve Evropiane, Zyra Ligjore e Kryeministrit, Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Zyra për Planifikim Strategjik dhe Zyra për Informim e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Ndërsa, sa i përket procesit të konsultimeve publike, ky proces është zhvilluar me grupe të interesit, përkatësisht me partnerët si Akademia e Shkencave dhe Arteve, Instituti Albanologjik, Instituti i Historisë, Universiteti publik, universitetet publike faktikisht dhe kolegjet private, OSBE-në dhe shoqërinë civile. Gjithashtu janë mbajtur debate publike me grupet e interesit dhe partnerët si dhe është hapur një linjë në ueb-faqen e Ministrisë për konsultim më të gjerë publik.

Një pjesë e komenteve kanë qenë të arsyeshme dhe janë inkorporuar në këtë projektligj.

Komentet kanë qenë kryesisht për kompetenca dhe përgjegjësi të institucioneve, autonomi të institucioneve, për inovacionin, teknologjinë, financimin dhe publikimin e rezultateve të kësaj fushe.

Unë ju kisha ftuar që edhe të debatohet, por gjithsesi edhe të aprovohet për ta proceduar pastaj në proces më tutje këtë projektligj, që të bëhet pastaj ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Kulturë, Rini, Sport e Administratë Publike, zoti Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27.8.2012, e shqyrtoi në parim Projektligjin në fjalë dhe vendosi që Kuvendit t'ia bëjë këtë rekomandim, që ky projektligj të miratohet në parim.

Po ashtu duke pasur parasysh rëndësinë që ka ky projektligj, në emër të Komisionit funksional, lus të gjithë deputetët dhe grupet parlamentare, që vërejtjet e tyre, sugjerimet dhe amendamentet, t'ia paraqesin Komisionit funksional në mënyrë që ky ligj të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i zbatueshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Ramë Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligjin për veprimtarinë kërkimore-shkencore, inovacion dhe teknologji, Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar me interes dhe kujdesin e duhur, duke u nisur nga fakti se veprimtaria kërkimore-shkencore dhe zhvillimi teknologjik janë të rëndësishë së veçantë për zhvillimin e një shteti.

Në shtetet e zhvilluara hulumtimet shkencore dhe zhvillimi teknologjik janë prioritet kombëtarë dhe në politikat shtetërore, në objektivat dhe strategjitë e tyre zhvillimore janë të përfshira edhe orientimi i hulumtimeve shkencore dhe kahet e zhvillimit teknologjik, prandaj edhe synimi i këtyre shteteve është përmbushja e objektivave të vendeve të Bashkimit Evropian, që të ndahen 3% e bruto-prodhimit vendor për hulumtime shkencore dhe zhvillimi i një hapësire të përbashkët për hulumtime.

Meqenëse puna kryesore bëhet në Komisionin funksional, këtu do t'i përmend disa prej gjërave kryesore që do t'i propozojmë për t'u futur në këtë ligj.

Duhet të themelohet Agjencia e Kosovës për Shkencë dhe Fondi për kërkime shkencore si institucione të pavarura. Fondi për kërkime shkencore duhet të shërbejë si referencë e drejtpërdrejtë e Drejtorisë së Përgjithshme të Kërkimit Shkencor të BE-s. Po ashtu, shuma prej 0,7% e buxhetit vjetor të shtetit tonë, e cila propozohet të ndahet sipas këtij ligji, duhet të vendoset në këtë fond e jo të vazhdojë praktika e deritanishme që mjetet për veprimtari kërkimore-shkencore të ndahen nga buxheti i MASHT-it në kuadër të mallrave dhe shërbimeve.

Në këtë ligj duhet të përfshihet edhe Instituti Pedagogjik i Kosovës, i cili është themeluar prej vitit 2007 dhe merret kryekëput me hulumtime shkencore në fushën e arsimit.

Mendojmë që në këshillat drejtuese të institucioneve shkencore, Ministria përkatëse për shkencë duhet të emërojë tre nga 7 anëtarë, e jo 4, siç është propozuar në këtë projektligj.

Në nenin 49, paragrafi 4 është propozuar që ministri ose ndonjë i deleguar i tij, në këtë rast është udhëheqësi i Departamentit të Shkencës, në kuadër të Ministrisë, të jenë anëtarë të Këshillit Kombëtar të Shkencës. Kur e dimë që anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shkencës emërohen nga Kuvendi i Kosovës dhe Këshilli Kombëtar i Shkencës i përgjigjet Kuvendit të Kosovës, jo Ministrisë, këto gjëra nuk mund të shkojnë së bashku,

por mund të propozojmë në këtë rast që secili apo cilido prej tyre të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Shkencës, por pa të drejtë vote.

Krejt në fund, mund të them se ky ligj ka shprehje dhe frazeologji të tepërta dhe përzierje të koncepteve. Janë futur në ligj formulime të tëra nga Manuali i Fraskatit, që do ta kishin vendin në ndonjë rregullore apo në ndonjë manual pune, por jo në këtë ligj.

Shpeshherë për të njëjtën gjë përdoren shprehje të ndryshme. Për shembull, herë thuhet Këshilli Kombëtar i Shkencës, herë Këshilli Kombëtar Shkencor, apo Programi kombëtar i shkencës dhe herë tjetër Programi kombëtar kërkimor-shkencor, prandaj ne duhet t'i marrim parasysh këto gjëra se Këshilli është themeluar në vitin 2007 dhe dihet me çfarë emri, e po ashtu edhe Programi kombëtar i shkencës është i hartuar më 2010 dhe dihet me çfarë emri është emërtuar.

Prandaj, Grupi ynë parlamentar e përkrah në parim këtë projektligj dhe kontributin tonë për plotësimin e tij do ta japim më tutje në Komisionin funksional. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Përshëndetje, i nderuar kryesues!

Ministra, deputetë,

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës, duke çmuar vlerën e këtij ligji, e ka shikuar me kujdes dhe këtë ligj duke dashur që gjithnjë dhe në vazhdimësi gjatë punës së amendamentimit t'i japë vërejtjet konkrete. Vërehet një nguti e Ministrisë në këtë rast për ta përmbushur atë që del sa për t'u evidentuar në Raportin e Progresit si përmbushje, ngase siç e tha edhe ministri në fjalën e vet, deri në vitin 2016 nuk kemi realizim të tij, prandaj për katër vjet sigurisht se do të shihen me kohë edhe krejt ato që mund të dalin edhe si vërejtje, ndoshta edhe si defekte të tij.

Ndërsa, në anën tjetër, ajo që na gëzon pak më shumë, janë edhe vërejtjet e deputetit Vataj, të cilat i ka paraqitur në Komision për të cilat jemi dakorduar edhe vetë ne, për korrigjimet që duhet t'i bëhen. Thashë, përveç ngutjes së Ministrisë për ta nxjerrë, sa për Raportin e Progresit, del edhe ngutja në këtë rast për t'i bërë disa këshilla apo për ta vënë diktatin në shumë këshilla drejtuese, siç vërehet, me dominimin që vijnë nga emërimet dhe dëshira e Ministrisë për ta vënë diktatin në këto këshilla, ngase aty shumica vjen me emërim dhe nuk delegohen nga institutet që shkelen shumë rregulla në këtë drejtim.

Ne do të punojmë me shumë kujdes në vazhdimësi për t'i evituar këto defekte të cilat do ta kishin vënë diktatin e Ministrisë dhe do ta cenonin pavarësinë e këtyre institucioneve prestigjioze të shtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", zoti Afrim Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit kryesues dhe të nderuar deputetë.

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar Projektligjin për veprimtarinë kërkimore-shkencore, inovacione dhe teknologji dhe si e tillë ajo ka disa vërejtje serioze lidhur me përmbajtjen, qëllimet dhe strukturën e këtij projektligji, defekte këto të cilat edhe shpresojmë se do të përmirësohen në fazat e mëtejshme të procedimit të këtij projektligji.

Fillimisht, ky projektligj është i ngarkuar me përsëritje dhe stërpërsëritje të neneve të caktuara me fjali të stërzgjatura, çfarë e bën atë shpeshherë konfuz në shumë prej aspekteve qenësore të tij. Bie fjala, vetëm sikur pak të ishte konsultuar Ligji për shkencën dhe zhvillimin teknologjik i Republikës së Shqipërisë, shumë nga këto anomali do të ishte e mundur të evitoheshin dhe kështu ky projektligj do të kishte një përmbajtje më koncize të fushës të cilën e normativizon në aspektin juridik. Po ashtu, fakt tjetër është se edhe pjesa më e madhe e këtij projektligji është përsëritje e ligjit aktual që është në fuqi.

Fillimisht, vetë neni 5, i cili përfshin mënyrën e financimit të veprimtarisë kërkimore dhe shkencore mbetet problematik. Aty thuhet se Qeveria ndan deri në 0,7% të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës për veprimtarinë kërkimore dhe shkencore. Kjo mënyrë e përcaktimit të masës buxhetore nuk merr parasysh nevojat e zhvillimit të shkencës dhe me të edhe të shoqërisë, por i mohon mundësitë e mbështetjes për zhvillim të mëtejshëm nëpërmjet përcaktimit strikt, sepse siç dihet se çdo përcaktim është mohim. Pra, nuk mund të thuhet se vetëm 0,7% e buxhetit është e caktuar njëherë e përgjithmonë, por buxheti duhet të caktohet në përputhje me nevojat e shkencës. Këtë vit mund të jetë 0,7%, vitin tjetër mund të jetë 0,12%, ose diçka më shumë, varësisht se çfarë nevojë mund të ketë shkenca.

E para, po ashtu, përcaktimi i buxhetit për shkencë nuk duhet të jetë e drejtë ekskluzive vetëm e Ministrisë së Financave, por edhe shumë aktorëve të tjerë relevantë. Bie fjala, në ligjin e cekur të Republikës së Shqipërisë, Komiteti për Shkencë dhe Teknologji është ai që ndër të tjera, në bashkëpunim me Ministrinë dhe Akademinë e Shkencave, përgatit dhe i propozon Këshillit të Ministrave Projektbuxhetin e shtetit për veprimtarinë shkencore dhe teknologjike, disponon dhe shpërndanë, për shembull fondet për veprimtarinë që mbulon vet, fondet për projektin në bazë të konkurrimit, fondit për veprimtari sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit tekniko- shkencor, me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare që mbulon vetë, si dhe disponon një fond rezervë për veprimtari e projekte të rëndësishme të paparashikuara, tipare këto të cilat plotësisht mungojnë në projektligj.

Madje ajo që spikat si brengosje, qëndron në faktin se pikërisht shumë nga dispozitat e këtij neni, e që janë fundamentale, të cilat, për të mos ju marrë shumë kohë, nuk do t'i përmendja, që parashihet të fillojnë së zbatuari deri në vitin 2016, kurse te dispozitat kalimtare thuhet se ato mund të zbatohen vetëm në qoftë se krijohen kushtet financiare. Kështu, në këtë mënyrë, kjo veprimtari vihet në pikëpyetje të madhe edhe për vitet në vijim.

Sidoqoftë, në një projektligj me mundësi të shndërrimit në ligj, nuk duhet vetëm të përshkruajë gjendja aktuale të një shoqërie, por ai duhet të përmbajë edhe një vizion se si mund të zhvillohet ajo shoqëri.

Kështu, në nenin 9, ku bëhet përkufizimi i personave juridikë dhe fizikë, kërkimor dhe shkencor, bëhet vetëm përshkrimi i institucioneve aktuale që merren me këtë veprimtari, por mungon një vizion më i qartë i mundësive të reja për zhvillim të mëtutjeshëm të kësaj veprimtarie.

Bie fjala, nëse e marrim shembull vetëm Republikën e Turqisë, me të cilën këta politikanë edhe ashtu kanë prirje për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale, konkretisht Qeverinë e saj, sot thuaj se çdo ministri brenda saj ka institute shumë serioze kërkimore dhe shkencore, të cilat realizojnë hulumtime fundamentale për trendët globale, sociale, ekonomike, politike e shkencore dhe të cilat më pastaj i furnizojnë këto ministri me të dhënat e tyre për të marrë vendime politike. Pra, kështu do të bëhej e mundur ndërtimi i një politike më shkencore, nëse mund të themi, apo të shprehem kështu, e cila do të shërbente si një lloj ndërlidhjeje të nduarnduart ndërmjet shkencës, politikës dhe shoqërisë, dhe kështu do të kombinohej dija, politika, prodhimi e zhvillimi dhe në këtë mënyrë vendimet të mos merren ad hoc pa bazë racionale apo në stilin e aksham pazarit siç është traditë te ne.

Ndërkaq, mundësia e krijimit të këtyre mekanizmave askund, thuaja se nuk figuron në këtë projektligj, ndërkaq mundësia e konfuzionit ekziston edhe te pjesa që merret me kriteret e gradimit shkencor, për shkak se në nenin 33 pika 2 e tij, në kriteret e kërkuara thuhet se duhet të ketë edhe publikime të njohura brenda vendit dhe në botë. Konsideroj se kjo duhet saktësuar se a është fjala edhe në gjuhë të huaja apo vetëm në vende të tjera, sepse dikush bie fjala, mund të bëjë punime, t'i dorëzojë në Universitetin e Tetovës, në ndonjë revistë atje dhe t'i mbrojë të gjitha në gjuhën shqipe si brenda, dhe të thotë se i ka mbrojtur edhe jashtë Kosovës, duke i mbrojtur në Universitetin e Tetovës, apo vetëm në Universitetin e Tiranës. Pra, këtu duhet të saktësohet që publikimet shkencore duhet të jenë, përpos në gjuhën amtare, edhe në gjuhë të huaja, edhe në vendet tjera, në mënyrë që gradimi shkencor të jetë valid dhe në përputhje me standarde ndërkombëtare.

Kurse sa i përket rritjes së efikasitetit të realizimit të programit kombëtar të shkencës, nganjëherë në dy vjet, si është tani në projektligj, duhet që Qeveria e Republikës së Kosovës çdo fund vit t'i paraqesë Kuvendit të Kosovës pasqyrën e realizimit të këtij programi. Pra, një herë në vit, jo një herë në dy vjet dhe ky raport duhet të përfshijë brenda vetes zbatimin e programit kombëtar të shkencës në vitin që e lamë pas - rezultatet e arritura nga bashkëpunimi shkencor e teknologjik me entitete tjera shkencore, ndërkombëtare e shtete, përdorimi i fondeve nga buxheti i shtetit dhe rezultatet e arritura nga bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shkencore, e në anën tjetër edhe deputetët në këtë mënyrë do të kishin qenë më të informuar për sfidat me të cilat ballafaqohet kjo sferë e shoqërisë.

Ambivalencat e këtij projektligji spikatin edhe sa i përket pjesës që përfshin relacione ndërmjet institucionit të Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe mekanizmave tjerë

institucional sikur që është Këshilli Shkencor i Ministrisë, madje në raport me Ligjin aktual dhe projektligjin që po e diskutojmë ka shprehur ambicie shkencore që edhe ministri të jetë pjesë e këtij institucioni ose ndonjë zyrtar nga Ministria e tij, që më duket absurde. Ndonëse këtij institucioni i atribuohen kompetenca gjenerale në propozimin kombëtar të shkencës apo edhe në nxitjen dhe përparimin e veprimtarisë kërkimore shkencore, tani edhe Këshilli Shkencor i Ministrisë është ai që propozon shpërndarjen e mjeteve nga buxheti i shtetit për veprimtarinë shkencore. Të parët i emëron Kuvendi i Kosovës, pas propozimit nga Qeveria, kurse të dytët vetë Ministria e Arsimit duke e bërë të paqartë se cili prej këtyre mekanizmave ka rol qenësor në zhvillimin dhe stimulimin e veprimtarisë shkencore.

Vërejtje ekzistojnë edhe sa i përket kriterëve që i ka paraparë Ministria për transferimin e teknologjisë, por unë nuk do të zgjatem se të gjitha këto do t'i them në Komision, në kuadër të amendamentimit të ligjit.

Përfundimisht, me këtë projektligj kjo ministri në shumëçka më shumë se çdo herë tjetër e bën realitet atë thënien popullore “Fulterja në zjarr, e peshku në det”, me shumë nga dispozitat kalimtare, të cilat do të mund të realizohen tek në vitin 2016 dhe atë vetëm nëse krijohen kushtet financiare për një gjë të tillë, ky projektligj më shumë më duket si një fontanë dëshirash që na ofron Ministria se sa një kuadër adekuat juridik për të ofruar zgjidhje për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe ia jep dritën jeshile për të bërë një punë shumë voluminoze në Komisionin për amendamentimin e këtij projektligji.

Nga ajo që e tha ministri që ky projektligj është në mesin e ligjeve, pra që janë me prioritet për t'i ndryshuar, besoni se shumë pak ndryshime ka nga ligji i kaluar dhe një pako e ligjeve që ne sot i kemi përpara nga kjo ministri, u përmendën por të mos i përsëritur edhe këto që u thanë nga parafolësit, të gjitha janë, implementimi i tyre fillon nga viti 2016 dhe atë nëse krijohen kushte. Pra, me një fjalë çka po bëjmë ne sot? Ne po e japim dritën jeshile, për të dhënë maksimumin nëpërmjet grupit të ekspertëve që i ka Aleanca, që të mund të bëjmë ndryshime thelbësore në këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është përfaqësuesi i Koalicionit Kosova e re, zoti Svirca.

Edhe një herë ju lus që të rrini në sallë për kuorum, dhe t'i thirrni kolegët që janë jashtë.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,
Kolegë deputetë,

Koalicioni për Kosovë të Re e përshëndet ardhjen e këtij projektligji për ndryshim-plotësim në Kuvendin e Kosovës.

Ne e kemi shqyrtuar Projektligjin për veprimtari kërkimore-shkencore, inovacione dhe teknologji, të cilin do ta përkrahim. Njëjtë, ashtu sikur edhe kolegët nga Komisioni për Arsim kemi disa vërejtje të cilat për hir të kohës dhe për të mos i përsëritur ne do t'i adresojmë në Komision, mirëpo këtu më lejoni që të kërkoj që të përcaktohet një fond më i madh për shkencë në mënyrë që t'u jepet hapësirë më të madhe shkencëtarëve të Kosovës që të punojnë që kjo lëmi - fushë të zhvillohet më shumë përmes të cilës do të fitojë shumë edhe shteti i Kosovës. Gjithashtu, përsëritjet të cilat janë në projektligj të eliminohen, si dhe të ketë sqarime tjera, si rasti i nenit 49 dhe gjithashtu edhe precizim ose sqarim të neni 79, të dispozitat kalimtare ku parashihet që një numër i konsiderueshëm i neneve me rëndësi në këtë projektligj, të hyjë në fuqi në vitin 2016.

Unë edhe një herë ju falënderoj për dëgjimin. Koalicioni për Kosovë të Re do ta përkrahë këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Buja, e dëshironi fjalën, në fund?

MINISTRI RAMË BUJA: Unë vetëm desha, në fund fare, të ju falënderoj për kontributin që tash dhatë me debatet tuaja dhe unë besoj shumë se kontributi do të jetë edhe më i dendur në këtë mes kohë prej leximit të parë e deri te i dyti. Unë i çmoj të gjitha mendimet që i keni dhënë, sinqerisht kanë qenë të zhukta dhe plotësisht të arsyeshme. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju njoftoj se në sallë kemi 61 deputetë. Kemi kuorum për t'i votuar të tri ligjet.

Lus që të fillojmë me votimin e pikës shtatë të rendit të ditës: *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare të Kosovës*

Votojmë tani!

Faleminderit! Konstatoj se me 61 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Kërkohet nga Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Tani, të nderuar deputetë, e votojmë pikën e tetë të rendit të ditës: *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme*

Në sallë janë të pranishëm 62 deputetë. Votojmë tani!

Konstatohet se me 61 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme.

Kërkohej nga Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Tash e votojmë pikën e nëntë të rendit të ditës: *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtari kërkimore-shkencore, inovacion dhe teknologji*

Votojmë tani.

Në sallë janë të pranishëm 62 deputetë. Faleminderit!

Konstatohet se me 62 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për veprimtari kërkimore-shkencore, inovacione dhe teknologji.

Kërkohej nga Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin profesional

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zotin Ramë Buja, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

(Ndërhyrje)

Le ta kryejë edhe ky, e pastaj bëjmë pauzë! Mendoj se do të qëndrojmë!

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra dhe zëvendëskryeministra,

Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional ka për qëllim të rregullojë sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës, përfshirë ndryshimet ekonomike dhe teknologjike, kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e individëve drejt ekonomisë së tregut duke shfrytëzuar në mënyrë optimale burimet financiare, njerëzore dhe të infrastrukturës.

Ky projektligj e rregullon strukturën, organizimin dhe menaxhimin e institucioneve që ofrojnë arsim dhe aftësim profesional. E drejta për organizimin e arsimit dhe aftësimin profesional, është e drejtë e institucioneve përkatëse dhe si e tillë e rregulluar dhe

garantuar me ligj. Përafrimi i legjislacionit nga kjo fushë, përkatësisht të Ligjit për arsimin dhe aftësimin profesional me standardet ndërkombëtare është një ndër prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Në Raportin e Progresit 2012 është rekomanduar ky ligj që të përplotësohet në bazë të atyre kërkesave që janë shtruar, prandaj Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur që ky akt ligjor të jetë një ndër ligjet me prioritet për këtë kohë të realizimit të tij.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 02/L-42 për arsimin dhe aftësimin profesional përmban gjithsej 37 nene.

Zbatimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin dhe aftësimin profesional, parasheh implikime buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës, por obligimet buxhetore janë apo fillojnë që nga viti 2016, sikur edhe në ligjin paraprak.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si organ propozues i këtij ligji, apo akti ligjor, sipas dispozitave të Rregullores së Punës të Qeverisë 09/2011, ka zhvilluar procesin e konsultimeve paraprake dhe publike. Konsultimi paraprak është zhvilluar qysh në fazën e parë të hartimit të këtij projektligji fillestar, ku janë konsultuar këto institucione: Ministria e Financave, Ministria e Integritetit Evropian, Zyra Ligjore e Kryeministrit, sekretari koordinues i Qeverisë, Zyra për Planifikim Strategjik dhe Zyra për Informim e Qeverisë.

Nga këto institucione, komentet janë bërë nga Zyra Ligjore e Kryeministrit, e cila konfirmon se projekti fillestar është hartuar konform rregullave ligjore.

Këshilli konsultativ për komunitete, Komisioni Evropian - ETF, GIZ-i, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Sindikata e Arsimit, përfaqësuesit e drejtorive komunale i kanë dhënë komentet e tyre në hartimin e këtij projektligji.

Po ashtu, nga data 7.3.2012 është zhvilluar diskutimi publik. Nga data 28.3 deri më 8.4.2012, në faqen elektronike të MASHT-it është hapur linku i veçantë dhe debatet e tilla e kanë dhënë kontributin e tyre dhe unë besoj se ky projektligj është i përplotësuar me ato nevoja që janë kërkuar për t'u përplotësuar. Unë kërkoj nga ju që ta zhvilloni debatin dhe natyrisht edhe ta votoni dhe ky projektligj të bëhet ligj. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e debatit. Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike e tjera, zoti Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional po ashtu e ka shqyrtuar në parim Projektligjin e lartpërmendur dhe ka vlerësuar se edhe ky projektligj i plotëson të gjitha kriteret e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe po ashtu në emër të komisionit u rekomandojmë deputetëve ta miratojnë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së, zonja Xhevahire Izmaqi e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAQI: Nënkyetar, Ramë Vataj, në emër të Grupit e pastaj unë flas në emrin personal. Faleminderit!

KRYESUESI: Pra, më falni. Zoti Vataj, në emër të Grupit.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar me vëmendje këtë projektligj i cili është ndër projektligjet e rëndësishme që ka figuruar edhe në kërkesën e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian.

Ky projektligj është një bazë e mirë për përafrimin e standardeve të BE-së për arsimin dhe aftësimin profesional. I hap rrugë të mirë të përafrimit këtyre standardeve, sepse parasheh themelimin e Agjencisë dhe Këshillit për arsim dhe aftësim profesional dhe arsimin e të rriturve, e që janë të domosdoshme për të rritur cilësinë e këtyre programeve të shkollave të arsimit dhe aftësimit profesional, e që kjo do t'u mundësojë të rinjve tanë që të konkurrojnë në tregun e vendeve të zhvilluara, sepse kur ta fitojnë besueshmërinë e cilësisë në këto shkolla ne do të kemi edhe absorbimin e të rinjve tanë nëpër tregun e vendeve të Evropës.

Ne do ta japim kontributin tonë në Komisionin Funkcional dhe do ta votojmë në parim, kështu që i ftoj edhe të gjithë kolegët ta përkrahin këtë ligj dhe kanë mundësi t'i japin të gjitha vërejtjet në komisionin, i cili është duke punuar intensivisht. Ju faleminderit për vëmendjen.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, zoti Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Edhe ne në Grupin Parlamentar të LDK-së e kemi shqyrtuar Ligjin për aftësimin profesional.

Fillimisht duhet ta përshëndesim iniciativën dhe sponsorimin e këtij ligji, ngase për herë të parë po vlerësohet e veçanta e shkollimit profesional dhe rëndësia e atij shkollimi, mirëpo po të shikojmë Ligjin e arsimit fillor dhe të mesëm dhe këtë që e kemi përpara shihet se nuk është shkuar shumë larg përtej domethënës ngjashmërive, që tregon se kemi mbetur në nivelin bazik. Edhe ideja e krijimit të këshillave dhe mënyrave të vlerësimit, është një hap i vogël përpara.

Ajo që do të kisha dëshiruar dhe me shumë dëshirë do ta japim kontributin tonë në kuadër të Komisionit apo grupeve punuese, që nga Ministria kompetente nuk duket qartë se cili

është vizioni, cila është strategjia dhe cilat janë format e atyre rezultateve për një periudhë afatmesme dhe afatgjate?

Duke ditur se pikërisht këto janë kuadrat që mendohet se duhet shpejt të jenë në dispozicion të ekonomisë, dhe që do t'i kontribuonte pastaj një ambienti biznesor të Kosovës, duke krijuar kuadro të tillë, edhe për nevoja të zhvillimeve dhe investimeve të ardhshme. Dhe pikërisht ndoshta me këtë ligj ka qenë momenti i mirë që të normohet jo vetëm aspekti bazik i funksionimit, por që të krijohen detyra, obligime dhe përgjegjësi për të gjithë aktorët që ata të marrin si një detyrim të dinamizmit të kësaj fushe, pra edhe të këtij suksesi, është rast i mirë. Nëse e lëmë kësaj, atëherë del se nuk ka obligim ekonomia të bashkëpunojë dhe të krijojë format e praktikave dhe aftësimeve gjatë shkollimeve, pastaj mjetet e konkretizimit që janë jetike për këto fusha, sepse nuk është lehtë ta aftësojmë do të thotë një profesionist të një zanati, po themi një inxhinier, një makinist, një elektro, një kimist dhe të tjera. Prandaj duhet domosdoshmërisht, përveç lidhja me ekonominë si një treg pune, një konkurrencë, bashkëpunimi me ekonominë për të parë se cilat janë kërkesat e tregut dhe pastaj të shkohet me hapjen e segmenteve të tilla dhe në këtë drejtim po shpresoj dhe do të kishim dëshiruar që nga kompetentët gjatë fazave të ardhme të punës saktësisht të shohim se cili është kapaciteti momental, cila është strategjia momentale, cila është ideja momentale dhe ato t'i inkorporojmë në ligj, të krijohen obligime, në mënyrë që vërtet ta kapim një dinamikë më të shpejtë në këtë drejtim.

Ndërsa, unë e përshëndes vetë iniciativën që kjo fushë të konsiderohet me të veçantat e saj, dhe të rregullohet me ligj të veçantë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryesues dhe të nderuar deputetë.

Po ashtu, edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për aftësimin profesional.

Është e vërtet se deficitet strukturore dhe arsimore në sferën e arsimit profesional kanë figuruar edhe në Raportin e fundit të Progresit, si një problem krucial për shoqërinë kosovare dhe mundësitë e saj zhvillimore. Por shtrohet pyetja se me nene që përmban ky projektligj a do t'i plotësojë të gjitha këto mungesa të specifikuar?

Dhe, ndoshta, krahas çështjes së projektligjit, Qeveria e Kosovës, konkretisht Ministria e Arsimit, në bashkëpunim edhe me ministrinë e tjera është dashur që të shqyrtojë mundësinë që në bashkëpunim edhe me vende të tjera të botës perëndimore të krijohet mundësia e hapjes së shkollave të tilla të cilat do të ofronin kapacitete të duhura profesionale dhe teknike në ngritjen e dijeve teknike edhe për nxënësit kosovarë.

Kështu ata do të kishin mundësi të mësonin edhe gjuhët e huaja dhe t'i plotësonin të gjitha kushtet e kërkuara në tregun e punës sa i përket vendeve evropiane. Një shembull i tillë madje është se si funksionon një shkollë e hapur nga norvegjezët në këtë drejtim.

Ndërkaq, është e ditur se në vitet në vijim Gjermanisë, si njëra nga ekonomitë qendrore të Evropës, vetëm gjatë viteve në vijim do t'i duhet një masë e madhe e fuqisë punëtore, që kanë shkathtësi teknike për të plotësuar nevojat e saj. Dhe, në këtë mënyrë pikërisht mundësia e bashkëpunimit me këto vende të tjera, për shembull si me Gjermaninë dhe me të tjera, do të kishte bërë të mundur hapjen e këtyre shkollave nga autoritetet gjermane dhe zbatimin e standardeve që ata i aplikojnë në vendet e tyre dhe në Kosovë, në mënyrë që të kishim një përgatitje të mirëfilltë teknike dhe profesionale të nxënësve që do t'i vijonin këto shkolla dhe jo që të na servohet një projektligj, i cili mban shumë pikëpyetje sa i përket mundësive të implementimit të tij.

Po ashtu, edhe ideja e këtyre shkollave duhet të jetë edhe fleksibile, pra që kur të krijohen nevojat e tregut, të hapet një shkollë e tillë, por pasi të plotësohen këto nevoja ajo shkollë të mos jetë e përjetshme, por të shikohet edhe mundësia e mbylljes, sepse atëherë janë plotësuar ato nevojat e tregut për një moment të caktuar dhe ajo shkollë mund të hapet përsëri ndoshta pas 10 a 15 vjetëve, atëherë kur përsëri krijohen nevojat e tregut edhe për një kuadër të caktuar teknik.

Ndërkaq, sa u përket edhe çështjeve konkrete, sikur neni 8, është e vërtetë që ky projektligj parasheh mundësinë e krijimit edhe të agjencisë, edhe të këshillit, mirëpo ka përzierje të kompetencave ndërmjet këtyre dy institucioneve dhe çka është më kryesore nuk dihet se kur do të krijohet kjo agjenci. Domethënë figuron në ligj se do të krijohet dhe Ministria e Arsimit do t'i rekomandojë Qeverisë së Kosovës, por është e paqartë data e krijimit të kësaj agjencie, e cila do të mund ta monitoronte implementimin e këtij projektligji.

Edhe në këtë projektligj, sikur edhe në projektligje tjera, po ashtu edhe ky nuk është imun ndaj sindromës së zhvendosjes së dispozitave të tëra dhe neneve për realizim tek në vitin 2016, pasi që të krijohen kushtet financiare. Pra, do të thotë ne po krijojmë projektligje, po i miratojmë, po i shndërrojmë në ligje por atëherë kur të krijohen kushtet financiare dhe mundësitë ndoshta në 2020, apo ku ta di kur. E nëse ky ligj është imediat dhe është i domosdoshëm për nevojat e tregut dhe për zhvillimin ekonomik dhe fillon së zbatuari tek në vitin 2020, atëherë krijohet konsekuenca logjike që edhe zhvillimi ekonomik i bazuar në këtë frymë nuk do të mund të fillojë as tek në vitin 2020. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zonja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim këtë projektligj dhe ky projektligj dhe sikur edhe projektligji tjetër në vazhdim janë shumë të lidhura ngushtë e që në realitet shumëçka kanë mund të rregullohen edhe me Ligjin për arsimin parauniversitar dhe unë për të mos i përsëritur disa gjëra që u thanë nga parafolësit, do t'i përmend shumë thjeshtë.

Në këtë ligj do të duhej të rregulloheshin plan-programet që askund nuk janë të miratuara dhe plan-programet nëpër shkolla profesionale të funksionalizohen, bie fjala në gjimnaz

për fusha gjegjëse apo në mjekësi që ndodh që më shumë ka lëndë jo profesionale se sa të profesionit. Pra, me një fjalë edhe ky projektligj, sikur edhe projektligjet tjera që janë sot nga Ministria e Arsimit, përmenden që do të fillojë implementimi i tyre në vitin 2016. Pra, ne po mundohemi të bëjmë diçka, mirëpo po frikohem që po bëjmë vetëm sa për të thënë ligje, prandaj ne do ta japim maksimumin në grupin funksional për të rregulluar një projektligj që do t'i rregullonte shumë çështje, pikërisht të shkollave profesionale, sepse është me interes jo vetëm për shkollat profesionale, por në përgjithësi për krejt shtetin e Kosovës, që këtyre shkollave profesionale njëherë e përgjithmonë t'u kthehet merita dhe të shihen jo si shkolla të rangut të dytë apo të tretë, por që i hyjnë shumë në funksion zhvillimit të shtetit të Kosovës. Prandaj, duhet të shihen shumë më seriozisht, duhet të punohet shumë më shumë në këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, zoti Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke ku mbështetur në qëllimin e këtij ligji i cili synon që në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës, përfshirë ndryshimet ekonomike dhe teknologjike, kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e individëve drejt ekonomisë dhe tregut, pra të rregullojë këtë fushë në bazë të këtyre që i cekëm më lartë, Koalicioni për Kosovë të Re do ta miratojë këtë projektligj dhe vërejtjet tona të cilat janë të pakta do t'i adresojmë në komisionin funksional ku edhe do ta japim kontributin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë konsideroj se sektori i arsimit në Republikën e Kosovës është duke bërë përpjekje që në mënyrë intensive dhe dinamike të bëjë reforma në gjithë sektorët, posaçërisht në këta sektorë ku kemi pasur sfidë dhe në këtë drejtim Ligji për arsimin dhe aftësimin profesional, mendoj se hap perspektivën e një arsimimi të mirëfilltë profesional për të gjithë nxënësit e këtij nivel.

Konsideroj se ky projektligj është i standardizuar dhe si i tillë i përgjigjet të gjitha nevojave të arsimit profesional të vendit tonë, duke qenë në harmoni të plotë me kornizën kombëtare të kualifikimeve dhe në përputhje me kornizën evropiane po ashtu të këtyre kualifikimeve.

Ky ligj konsideroj se do t'u shërbejë një pjese të madhe të nxënësve, pra kemi 56% të nxënësve të arsimit të mesëm, të lartë dhe kjo shihet një mundësi për të shtuar rëndësinë dhe ndikimin e këtij nënsektori në rrjetin e këtyre të rinjve, duke lidhur pra arsimin profesional me tregun e punës dhe nevojat e komunitetit, që për vendin tonë është jashtëzakonisht e rëndësishme në këtë fazë. Kjo do të thotë se shkollat tona profesionale nuk do të nxjerrin vetëm nxënës me diploma, që kanë vlerën e një letre me një vulë të një

institucioni arsimor, por do të përgatisin nxënës të kualifikuar me dije dhe shkathtësi profesionale që pra mund edhe t'i kërkojë tregu i punës.

Po ashtu, ky ligj do t'i ndihmojë reformat e tanishme, me një qasje të përmirësuar pra, në integrimin e sistemit të ri modular të kurrikulave për të gjitha drejtimet dhe profilet në shkollat profesionale, si dhe sigurimin më të madh në mes të nevojave të tregut dhe profileve të drejtimeve të afuara në shkollat profesionale.

Në këtë mënyrë, do të përmirësohet pra qasja, cilësia dhe rëndësia, do të përmirësohet koordinimi dhe relevanca apo rëndësia për tregun e punës, do të forcohet kapaciteti institucional dhe menaxhues i këtij sistemi dhe do të vendoset një bazë e shëndoshë, pra financiare, për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e tij në plan afatgjatë.

Unë do ta votoj pro, dhe konsideroj se është një ligj jashtëzakonisht mirë i punuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, a dëshironi të thoni diçka? Zoti Buja e ka fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: Të nderuar deputetë, faleminderit shumë për kontributin e dhënë.

Unë veç dua të sqaroj, as një gjë të polemizoj, sepse arsyeja s'e do sepse janë thënë gjëra shumë të kuptimshme, por desha ta sqaroj se kurdo të themelohet agjencia, që është një organ ekzekutiv dhe që do të mundësojë një organizim më të mirë dhe më profitabil të tërë arsimit dhe aftësimit profesional, ne po presim që ligji të aprovohet në Kuvend dhe pastaj të përimitojmë dhe bëjmë sqarimin e organizimit të kësaj agjencie me një udhëzim të veçantë administrativ dhe kjo do të bëhet besoj si shpejt, sepse të gjitha përgatitjet i kemi bërë. Bile kemi bërë të mundshme tri alternative për themelim, sepse mundësitë tona financiare janë bukur të kufizuara, por megjithatë ne kemi krijuar edhe mundësinë që ta bëjmë, brenda mundësive tona. Ia kemi bërë një kërkesë të veçantë Ministrisë së Financave që të na ndihmojë në këtë çështje dhe po kështu ia kemi bërë një kërkesë Komisionit Evropian që na ka premtuar se do të jetë ndihmë solide për themelimin e kësaj agjencie që do të bëjë me shumë prioritet këtë arsim dhe aftësim profesional, për të cilin, ju e dini dhe veç po ju rikujtoj se 60% e shkollave tona janë profesionale në Kosovë. I kemi dy shkolla kompetente që sot vërtet sot janë me një kuadër shumë profesional dhe me kuadër që nxjerrin me aftësi profesionale dhe që janë jo të tregut kosovar, por që besoj se do të jenë edhe për tregun e rajonit dhe më gjerë dhe dy që janë në ndërtim në Prizren dhe në Ferizaj, po kështu që pretendohet të jenë po kështu me kapacitete të konsoliduar mirë. Dhe ky aftësim dhe arsim profesional ka prioritet të veçantë tanimë në Kosovë, edhe me Ligjin që ju e keni para jush, për faktin që tërë Evropa e ka prioritet të veçantë këtë gjë. Por problemet e përputhshmërisë së ekonomisë me arsimin dhe aftësimin profesional janë probleme që nuk na përkasin vetëm ne, nuk dua të arsyetohem me këtë, por janë probleme që i përkasin rajonit dhe më gjerë. Unë ju falënderoj për kontributin dhe ju ftoj që ta votoni. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas asaj që po shoh këtu, nuk kemi kuorum as për ta votuar edhe këtë ligj. Tani e kam një kërkesë nga ministri, që ta shqyrtojmë edhe një ligj tjetër, pikën 11 të rendit të ditës, nëse jeni dakord, e në qoftë se jo, e shtyjmë.

(Ndërhyrje)

Po, zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti nënkryetar dhe kryesues i seancës! Kishim dy ligje, kemi tri ligje të arsimit sot këtu.

Është mirë të sqarohet si votohet sot këtu për to. Nuk është mirë që të mbahet mbledhje pas votimeve, siç ndodhi në herën tjetër. Janë në regjistrin e ligjeve që quhen me rëndësi vitale, unë them, themelore.

Atëherë, ju lutem shumë, sidomos koalicionit qeverisës që edhe ashtu e përbën shumicën, merruni vesh, mos na shtini të votojmë e pastaj të thoni - jo nuk kanë qenë pakicat t'i votojnë.

Referenca është neni 81 dhe 149 i Kushtetutës. Studioni, e mbasandaj mund të votohet, por ju kisha lutur edhe një herë, studioni, mos na qitni në pozitë të lajthitjeve, se unë po ju garantoj, nuk lajthitem, sepse me letra përpara punoj, po nuk është mirë që kjo të ndodhë.

Kemi tri ligje të asaj natyre sot, apo sot do të votohet me tjetër rregullore e rregull e nesër me tjetër. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! A jeni dakord që të vazhdojmë me pikën 11, edhe 20 minuta ta kryejmë, apo të shkojmë në pauzë?

(Ndërhyrje)

Atëherë, shkojmë në pauzë deri në orën 15:00.

(Pas pauzës, mbledhja plenare e vazhdoi punën.)

(Seancën e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Deputet, ju lutem, zini vendet tuaja!

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës. Të pranishëm janë 67 deputetë.

Pra, pasi për këtë ligj kërkohen edhe votimi i komuniteteve pakicë, me shumicën e pranishme, dhe këtu nga komunitetet pakicë i kemi 7 deputetë, kishim votuar tash, me ngritje dore. Do të thotë me ngritje dore, vetëm për komunitetet pakicë.

(Ndërhyrje)

Thuhet këtu: shumica e të pranishmëve. Te 81-shi, është shumica e të pranishmëve. Tani janë 69 deputetë. Kërkohej votimi i komuniteteve pakicë për ligjin, ju lutem me ngritje dore. Është fjala për komunitetet pakicë!!

Pra, kush është për? Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë. Pra, të gjithë të pranishmit votojnë për. Do të thotë nga shtatë që janë të pranishëm - shtatë janë për. Faleminderit!

Tash, po ashtu lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 63 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për arsimin dhe aftësimin profesional.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj ministrin e Administratës Publike, zotin Mahir Yagcilar që në emër të Qeverisë ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuari zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuari ministër,

Më lejoni që në pika të shkurtra të prezantojë Projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit.

Me qëllim të avancimi të gjitha raporteve shoqërore në Kosovë që i përgjigjen rrethanave dhe kërkesave të reja si dhe standardeve të legjislacionit evropian, paraqitet nevoja për projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit.

Ky projektligj e ka për qëllim përcaktimin e organeve qeveritare përgjegjëse për zhvillimin e shërbimeve të shoqërisë së informacionit në institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe kompetencat, përgjegjësitë, organizimin dhe funksionimin e tyre.

Krahas të arriturave bashkëkohore në fushën e shoqërisë së informacionit si dhe përmbushjes së zbrazësive ligjore, me këtë projektligj, Departamenti për qeverisje dhe proceset administrative në Ministrinë e Administratës Publike do të shndërrohet në Agjenci për Shoqërinë e Informacionit, që ndër të tjera do t'i ketë edhe këto përgjegjësi.

Propozimin dhe koordinimin e të gjitha politikave që ndërlidhen me teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në institucionet e Republikës së Kosovës;

Hartimin dhe sigurimin e zbatimit të strategjisë së qeverisjes elektronike dhe të planit të veprimit përkatës;

Udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve që ndërlidhen me teknologjinë e informacionit në institucionet e Republikës së Kosovës;

Zgjerimin e shërbimeve të Internetit, dhe përmbajtjeve të Internetit në institucionet e Republikës së Kosovës;

Akumulimin, administrimin, përhapjen dhe ruajtjen e të dhënave duke krijuar qendrën shtetërore të dhënave, e tjera.

Po ashtu, sipas këtij projektligji çdo institucion i Republikës së Kosovës duhet të ketë njësinë apo zyrtarin për menaxhimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, i cili është përgjegjës për kryerjen e shërbimeve të përbashkëta dhe përkrahjen e TIK-ut në institucionet përkatëse.

Prandaj, rëndësia e këtij projektligji është i madh nga se për herë të parë me këtë akt ligjor themelohet Agjencia për Shoqërinë e Informacionit si organ qendror i Administratës shtetërore për zhvillimin dhe zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për institucionet e Republikës së Kosovës.

Projektligji përmban gjithsej 12 nene.

Ky projektligj është aprovuar nga Qeveria në mbledhjen e mbajtur më 7 gusht.

Projektligji është hartuar në përputhje me Rregulloren e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Projektligji është hartuar në formën dhe strukturën ashtu siç parashihet me Udhëzimin administrativ për hartimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore.

Projektligji nuk ka elemente diskriminuese.

Projektligji është në pajtim me Kushtetutën dhe sipas Deklaratës së lëshuar nga Ministria për Integritet Evropian.

Projektligji për organet qeveritare, për shoqërinë e informacionit, nuk i cenon parimet e përgjithshme të aqvi komunitare, por gjithashtu është edhe një prej sfidave në raportin e progresit evropian.

Prandaj, të nderuar deputetë ju propozoj ta aprovoni këtë projektligj në parim, duke besuar se në procedurat parlamentare ligji do të strukturoret edhe më mirë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Kryetari i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputeti Idriz Vehapi e ka fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Komisioni Funkcional më 29.8.2012 e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit dhe ka vendosur që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandim- të miratohet ky projektligj në parim nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, fjalën e ka Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi ynë parlamentar e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë – Projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit. Është një projektligj me përmbajtje minore, mirëpo një projektligj shumë i saktë, do të thotë me një përmbajtje shumë profesionale të hartuar dhe në këtë drejtim i gëzohemi faktit që për herë të parë domethënë me miratimin e tij do të krijohet Agjencia për Organizmin e Shoqërisë së Informacionit, e cila agjenci ka munguar dhe në këtë drejtim kemi pasur edhe vërejtje, pra në Raport të Progresit edhe për mungesë të legjislacionit në sferën e organizmit të shoqërisë informative.

Është shumë e rëndësishme që me miratimin e këtij ligji, çdo institucion qeveritar është i obliguar që të ketë një zyrtar apo menaxher të teknologjisë informative. Po ashtu i paraprimë pra me krijimin e agjencisë që detyrohet në bazë të ligjit, i paraprimë edhe hartimit të një legjislacioni i cili do të mundësojë dhe do të ketë një bazë për krijimin e legjislacionit edhe për nënshkrimin elektronik, gjë e cila do të mundësojë që të ketë më shumë siguri në sferën e komunikimeve qeveritare. Në këtë fazë, Grupi ynë parlamentar do ta votojë pro dhe sigurisht se do ta japim kontributin edhe në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit,

I nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë,

Edhe ne, në Grupin Parlamentar të LDK-së e kemi shqyrtuar propozim-ligjin dhe e mirëpresim objektivin kryesor të ligjit që të krijohet një agjenci apo një qendër e cila do të bëjë menaxhimin dhe monitorimin e aktiviteteve në fushën e teknologjisë informative të institucioneve qeveritare. Po ashtu, në memorandumun shpjegues jepet se ky rregullim po ashtu do të ndikojë në një ambient më të volitshëm biznesor që nga vlerësimet e ndryshme duke filluar që nga Banka Botërore e të tjera, Kosova akoma konsiderohet si

një shtet, një vend që nuk ka ambient të volitshëm biznesor dhe mua më vjen mirë që dalëngadalë duke përpunuar ligje dhe vendime tjera e kemi vu në fokus të veçantë zhvillimin ekonomik dhe krijimin e parakushteve për zhvillim ekonomik, prandaj ne edhe e përshëndesim.

Ajo që ne në parim pajtohemi me këto ambicie, do të jemi bashkëpunues dhe do të provojmë që t'i kontribuojmë këtij ligji në punën e Komisionit apo grupeve punuese, do të jetë të shohim se a është kjo ambicia e plotë dhe cila do të jetë ndarja, apo duhet të shkohet përtej kësaj ambicie, përveç një agjencie e cila deri tash ka qenë e rregulluar me ligj dhe ky mund të konsiderohet një ligj apo një vendim i krijimit të agjencisë nga se fushë veprimtaria është tepër e ngushtë. Dhe do të provojmë që meqë kemi përpara një ligj ta shfrytëzojmë rastin në kuadër të këtij ligji të krijojmë kompetenca, përgjegjësi dhe obligime në mënyrë që kjo fushë të rregullohet edhe në kuptimin më të gjerë.

Pra, edhe një herë, në parim ne jemi për që të votohet, por që do të bëjmë përpjekje që ta begatojmë akoma këtë ligj.

KRYETARI: Faleminderit deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Lëvizja Vetëvendosje do ta përkrahë në parim këtë projektligj.

Është e ditur se ky projektligj na është servuar vetëm me qëllim të krijimit të një agjencie. Si të tillë, ne vërejtjet tona do t'i bëjmë edhe në kuadër të Komisionit në mënyrë që ta përmirësojmë edhe më tepër përmbajtjen e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim Projektligjin në fjalë dhe për të mos i përsëritur ato që i thanë edhe parafolësit, kontributin tonë do ta japim në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke marrë për bazë se Projektligji për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit përcakton funksionet dhe përgjegjësitë në lidhje me zhvillimin e shoqërisë të informacionit dhe bën konsolidimin e funksioneve dhe të përgjegjësiave të institucioneve ekzistuese qeveritare, në lidhje me fushën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, duke i kaluar përgjegjësitë në organet e reja të formuara me këtë

projektiligj, funksione dhe përgjegjësi që ndërlidhen me zhvillimin e shoqërisë së informacionit dhe të TIK-ut.

Duke pasur parasysh raportin e Bankës Botërore në të cilin Kosova rangohet në mesin e vendeve që është vështirë të bëhet biznes dhe raportet e organizatave vendore ndërkombëtare që kërkojnë krijimin e organeve qeveritare të shoqërisë së informacionit, si dhe duke u bazuar në strategjinë e Qeverisë për zhvillimin ekonomik dhe të qeverisjes, Koalicioni për Kosovë të Re do ta miratojë këtë projektiligj, objektivi i të cilit është pra krijimi i një qendre apo agjencie e cila do të merrej me menaxhimin dhe monitorimin e të gjitha aktiviteteve në fushën e teknologjisë informative që zhvillohen në kuadër të ministrive dhe institucioneve tjera.

Gjithashtu Koalicioni për Kosovë të Re do ta japë kontributin e vet në komisionin përkatës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit SLS, nuk ka. Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, fjalën e ka Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar dhe analizuar këtë projektiligj, gjegjësisht Projektiligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit dhe do të votojmë për këtë projektiligj, ndërsa kontributin tonë do ta japim përmes punës së komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Tash është radha e deputetëve dhe fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë,

Më lejoni fillimisht të përshëndes ardhjen e këtij ligji shumë të rëndësishëm në Kuvendin e Kosovës. Është një ligj që duhet trajtuar si ligj i pakos së reformës së Administratës Publike dhe uroj edhe për një arsye krejt personale, sepse përmes këtij ligji po implementohet plotësisht ideja e qeverisjes elektronike. Para dy vjet i kemi punuar shumë me përkushtim strategjinë për qeverisjen elektronike dhe disa ide që i kemi pasur atëherë, tani po marrin edhe mbrojtje ligjore.

Janë tri efekte që duhet t’i arrijë ky ligj. Efekti i parë është krijimi i agjencisë nacionale për menaxhimin e komplet teknologjisë informative dhe nevoja për këtë agjenci ka qenë e kamotshme. Diçka e tillë ka qenë e paraparë edhe me strategji edhe me planin operativ dhe diçka të tillë kanë bërë të gjitha shtetet e suksesshme, me tranzicion të suksesshëm të Administratës Publike. Po i përmendi vetëm disa shtete, sepse ne edhe i kemi marrë modele, bile ne kemi organizuar edhe udhëtime zyrtare në nivele shumë të larta: Estonia, Sllovenia, Austria, do të thotë kanë ndjekur praktika të tilla dhe me formimin e

Agjencisë, në fakt ne do ta kemi një institucion shumë kredibil dhe përkatës, i cili është përgjegjës për progresin e Administratës Publike.

Çështja e dytë, sigurisht kjo agjenci do të ketë të gjithë autoritetin edhe pse e ka edhe Departamenti për qeverisje, të gjithë autoritetin që të menaxhojë komplet me teknologjinë informative në nivel të Administratës Publike dhe të ndikojë në modernizimin e administratës.

Ne kemi nevojë tash edhe për një ligj të ri dhe sigurisht Ligji për nënshkrimin elektronik dhe jam i sigurt se ministri e ka në agjendë dhe jo shumë larg do të na vijë edhe Ligji për nënshkrimin elektronik, në mënyrë që të kompletohet komplet infrastruktura ligjore sa i përket qeverisjes elektronike.

Dhe çështja e tretë, unë e lexova zoti ministër procesin e tranzicionit që i keni paraparë për 90 ditë, tranzicionit të Departamentit që ju e keni në ministri, në Agjenci Kombëtare të Informacionit dhe unë uroj që ju brenda 90 ditëve t'i kryeni këto, por ajo që ju sugjeroj, si ministër i resorit përkatës, që ju të keni bashkëpunimin e mirë me të gjitha ministratë tjera, sepse nga përvoja ime si ministër ka munguar nganjëherë një politikë unike shtetërore dhe të merrni përgjegjësinë edhe për postimin e të dhënave elektronike, sistemin e krijimit të platformave digjitale elektronike në Administratën Publike, por edhe mbrojtjen e këtyre të dhënave.

Unë e di që është në proces edhe formimi i Qendrës nacionale të dhënave por detyrë e ministrisë tuaj, por mënyrë e veçantë e kësaj agjencie, është edhe të mbrojë nga proceset e krimit elektronik, që jo rrallë nganjëherë edhe bëjnë ndërhyrje në portalet elektronike të Qeverisë, apo në adresat elektronike të ministrive dhe jam i sigurt se me miratimin e këtij ligji ne po krijojmë një bazë solide që vërtet edhe Kosova të hyjë në epokën e modernizimit të plotë të administratës dhe të marrë përvojat e praktikat më të mira, pikërisht nga shtetet që ne i kemi marrë modele me rastin e hartimit të strategjisë kombëtare për qeverisje dhe planin operativ, kështu që zoti ministër edhe një herë ju uroj dhe uroj që ky ligj të kalojë edhe në leximin e dytë dhe të fillojë implementimi i tij praktik. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi të lajmëruar për diskutim. Shkojmë në votim.

Të pranishëm janë 70 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 70 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raport me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e radhës, pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të dhënat në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj zëvendëskryeminstirin dhe ministrin për Qeverisje Lokale, zotin Slobodan Petroviq, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

(Ndërprerje e incizimit)

Projektligji e ka arsyeshmërinë e vet dhe ftoj kryetarin e Komisionit, Idriz Vehapin, që ta japë mendimin e Komisionit.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Po ashtu, Komisioni FunkSIONAL pas shqyrtimit në parim të Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ka vlerësuar se ky projektligj i plotëson të gjitha kriteret për lexim të dytë, prandaj lus deputetët që ta miratojnë në parim projektligjin. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputetja Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj. Është një projektligj, i cili i ka paraprirë një debati shumë të gjerë, si të përfaqësuesve të institucioneve, po ashtu edhe të aktorëve të shoqërisë civile. Është shumë i rëndësishëm, posaçërisht për zhvillimin e komunave, meqë deri tani dihet që kanë pasur shumë pak pavarësi në menaxhimin e pronave të tyre dhe në këtë drejtim, me miratimin e ligjit, ato do të kenë mundësi që ta kenë një autoritet mbi pronën e tyre. Po ashtu, do t'u ofrohet mundësia edhe investitorëve të ndryshëm që të kenë qasje në investimet e ndryshme në komunat e Republikës së Kosovës.

Grupi ynë parlamentar do ta japë kontributin edhe në komision, ndërsa tani sigurisht që do të votojë pro. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Edhe ne në grupin parlamentar dhe unë personalisht në komision, pas leximit në tërësi të këtij ligji, do t'i them mendimet e momenteve të pëlqyeshme ose të mira të tendencës, sidomos të ndërrimit të pronës, kur dihet që komunat tona kanë mungesë të jashtëzakonshme të pronave, që do t'i kishin dhënë në shfrytëzim të interesit publik.

Por, megjithatë, duhet tërheq vërejtjen se një tendencë e këtij ligji, në krahasim me ligjin e deritashëm, që prona të jepet në shfrytëzim për 40 vjet, e tash tendenca të kalojë 99 vjet, e ka rrezikun e vet, sidomos duke marrë parasysh dendësinë dhe gjendjen që e kemi nëpër komunat tona, në zonat e ngushta. Unë frikohem se nëse nuk tregohemi të kujdesshëm, fëmijëve tanë nuk do t'u lëmë asnjëherë dhe asnjë mundësi, qoftë as për një shkollë, qoftë për një çerdhe dhe për nevojat tjera që mund t'i kenë qytetet në të ardhmen. Prandaj, unë do të angazhohem dhe në kuadër të komisionit dhe grupeve punuese që ta specifikojmë se tendenca e mbështetjes, e zhvillimit ekonomik, nuk lidhet me zonat e para, me zonat ultra urbane, që i kanë komunat, për të cilat realisht do të ishte dashur të jemi të kujdesshëm dhe t'i ruajmë ato prona për nevojat publike, ndërsa për pasuritë që janë në zonat e treta, pra në periferi të qyteteve, eventualisht edhe mund t'i mbështetim që ata ta kenë të drejtën që të hyjnë në transaksione të ndryshme për përfitime publike, apo qoftë për mbështetje të zhvillimit ekonomik.

Prandaj, ky ligj e ka një tendencë të mirë që të ndërrojë prona dhe të përfitojë Komuna, por ekziston edhe rreziku që ato t'i japim në përdorim shpejt për 1,2,3 vjet dhe gjeneratat e ardhshme të mos kenë më asnjë minimum të pronës në interes publik. Pra, në parim jemi pajtuar që do ta mbështetim këtë ligj, por do të angazhohemi që t'i shmangemi këtij rreziku. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe ne si Lëvizje “Vetëvendosje” e kemi shqyrtuar këtë projektligj dhe po ashtu kemi disa vërejtje serioze për shkak të paqartësive që ekzistojnë në të, përkatësisht në nenet e tij.

Për shembull, kur bëhet fjalë për afatin kohor të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, nënkupton periudhën nga 1 deri në 15 vjet, që bëhet nëpërmjet ankandit publik. Po ashtu, afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës nënkupton periudhën kohore prej 15 deri në 99 vjet nëpërmjet konkurrimit të hapur. Në kuadër të këtyre dispozitave të këtij neni janë të specifikuar vetëm vitet dhe kohëzgjatja për sa jepet në shfrytëzim prona e Komunës, por ne konsiderojmë se duhet të jenë të specifikuar edhe aktivitetet se për çka lejohet dhënia në shfrytëzim e pronës së Komunës për këto dy afate, si për afat të gjatë, ashtu edhe për afat të shkurtër.

Sa u përket vërejtjeve tjera, kur bëhet fjalë sidomos te krijimi i komisionit vlerësues, detyrave dhe përgjegjësisë, neni 8, paragrafi 1, thotë se për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim krijohet një komision vlerësues i përbërë prej shtatë anëtarëve. Kryetari i Komunës, në kuadër të këtij komisioni, i propozon tre anëtarë, tre të tjerë nga Kuvendi i Komunës dhe vetëm një ekspert nga Shoqëria Civile. Për ne mbetet e paqartë se cili do të jetë principi i brendshëm i votimit, veçanërisht i tre anëtarëve të propozuar nga Kuvendi i Komunës; vetëm me shumicë të thjeshtë, apo me 2/3 e asamblistëve të

përfaqësuar në Kuvendin Komunal? Aq më tepër kur specifikohet në kuadër të ligjit se dhënia e pronës bëhet për një interes publik dhe miratimi i rekomandimeve të komisionit vlerësues dhe aprovimi i tij duhet të bëhet nga Kuvendi Komunal, me një shumicë të thjeshtë. Ne konsiderojmë nëse kjo pronë duhet të jepet në shfrytëzim për një interes madhor publik, atëherë interesin madhor publik mund ta mbrojë më mirë një kolektivitet më i gjerë, që i bie se do të ishte mirë që procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës së Komunës të bëheshin me 2/3 e asamblistëve në Kuvendin Komunal, duke e përfshirë edhe opozitën, natyrisht.

Prandaj, duke i marrë parasysh këto vërejtje, ne do të abstenojmë lidhur me këtë projektligj dhe do t'i paraqesim amendamentet tona lidhur me korrigjimin e këtyre paqartësive dhe nëse ato amendamente do të miratohen nga komisioni, atëherë do ta miratojmë në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Ne si grup parlamentar mendojmë që ky Projektligj duhet ta marrë dritën e gjelbër për më tutje për të punuar në Komisionin Funkcional, meqë besojmë fuqishëm që ky do të ndikojë në zhvillimin e komunave tona, ngase jemi dëshmitarë që kryetarët e komunave deri më tani i kanë dhënë pronat e tyre për 10 vjet në shfrytëzim, me mundësi vazhdimi pastaj edhe për 30 vjet të tjera. Por, gjithsesi duhet biseduar edhe me tri ministratë tjera. Në këtë rast ne do të punojmë që të ndikojmë, duke u bazuar edhe në sugjerimet që kanë ardhur nga Asociacioni i Komunave, sepse është një bord që i fuqizon të gjitha komunat e shtetit të Kosovës. Jemi dëshmitarë që investitorët nuk kanë mundur të vijnë nëpër komuna për të investuar, sepse nëse u jepet një pronë për 10 vjet, ne mund të themi që ata mund ta bëjnë një objekt montazhi, jo diçka më tepër.

Prandaj, duke besuar fuqishëm që në këtë rast, jo vetëm t'u jepet një kompetencë e shtuar kryetarëve të komunave, por duke besuar që ata do ta marrin edhe si një kompetencë shtesë, por njëkohësisht duhet të jenë shumë të përgjegjshëm për pronat e komunave. Ne do të punojmë që ta bëjmë këtë ligj të implementueshëm, por njëkohësisht edhe shumë funksional. Pra, me këtë rast, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e jep dritën jeshile për më tutje.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, fjalën e ka deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar këtë projektligj, të cilin do ta miratojë në parim.

Ligji aktual në Kosovë nuk i ka plotësuar nevojat e komunave sa i përket mënyrës së menaxhimit të pronës komunale. Ne e përshëndetim Ministrinë e Administratës Pushtetit

Lokal që e ka nxjerrë një ligj të ri, i cili ka legjislacion të përafërt me Bashkimin Evropian. Projektligji në fjalë synon që autoritetet lokale nëpërmjet zgjatjes së afatit për dhënien e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme komunale, me procedura më të lehta t'u mundësojë komunave më shumë të drejta në menaxhimin e tokës me qëllim të zhvillimit të ekonomisë lokale.

Gjithashtu, ky projektligj ndikon në interesimin për investimin nga investorët e ndryshëm nëpërmjet, të cilëve do të mundësohet zhvillimi ekonomik lokal. Edhe njëherë Koalicioni për Kosovë të Re do ta votojë këtë projektligj në parim, kurse vërejtjet tona eventuale do t'i përcjellim në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “6+”, fjalën e ka deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Parlamentarna Grupa “6+” podržace Nacrt zakona o davanju na korišćenje i razmena nepokretne imovine opština. Za dalje poboljšavanje ovog kvaliteta svoj doprinos daćemo u komisiji nadležne za njega. Hvala!

KRYETARI: Nga deputetët është lajmëruar Hydajet Hyseni. E ke fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe unë nuk mund të mos e mbështes projektligjin që ka ardhur. E kuptoj rëndësinë e jetësimit të këtij ligji, sidomos për funksionimin e komunave. Përpiqem ta kuptoj edhe trendin e përgjithshëm të decentralizimit dhe të bartjes së kompetencave te komunat, e di që ka nevojë. Por, shqetësimi im është i ngjashëm me atë që edhe dëgjova, sidomos në faktin që është fjala për pasurinë e komunave dhe nuk është sqaruar sa duhet, siç thuhet “për tokën dhe objektet që janë në pronësi të Komunës”. Dhe, për mendimin tim, kjo krijon edhe mundësi abuzimi, jo vetëm material, por edhe në forma tjera, deri edhe politik. Dhe, nuk shoh që ka mekanizma të duhur të kontrollit në një fushë të tillë të ndjeshme. Keni parasysh, vetëm te neni 8. Është fjala për një komision, i cili më duket i pamjaftueshëm që të sigurojë pastaj sundimin e ligjit në këtë proces të ndjeshëm. Një tendencë për shitjen e pasurisë së Kosovës është gjithkund dhe është e vërtetë që është një rast i mirë për ata që e kanë në dorë që edhe të bëjnë mirë, por edhe të abuzojnë. Pa kontroll, mendoj që do të mund të ishte edhe me probleme.

Në nenin 10, te dhënia e pronës së paluajtshme të Komunës për raste të veçanta janë specifikuar 3-4 raste të veçanta. Çka janë ato? Institucionet qendrore, që nuk është problem; përfaqësitë diplomatike, po ashtu nuk është problem; legalizimet e vendbanimeve jo formale, më del e paqartë çka janë këto dhe çka mund të fshihet nën këtë formulë gjithçka. Pastaj, bashkësitë fetare, në rregull, por a ka nevojë këtu që të jenë, ta zëmë: shkollat, spitalet etj., sepse mendoj që nuk është sqaruar sa duhet. Prandaj, angazhohem që gjatë amendamentimit të plotësohet, të sigurohen mekanizmat e kontrollit me mundësinë edhe të ankesave tjera, që nuk i shoh se janë, dhe në këtë mënyrë të parandalohet mundësia e abuzimit me pronën e komunave, sidomos në ambientin tonë vunerabël edhe në aspektin e instrumentalizimit, jo vetëm të brendshëm, por edhe të jashtëm. Ju faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Tani kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës. Në mbledhje janë të pranishëm 64 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Konstatohet se me 49 vota për, 10 abstenime, 1 kundër, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kalojmë në pikën e 13 të rendit të ditës:

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. E ftoj ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, zotin Buja, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI RAMË BUJA: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rriturit ka për qëllim ta rregullojë tërësinë e proceseve për arsimin dhe aftësimin e të rriturve, si pjesë përbërëse e sistemit arsimor të Republikës së Kosovës.

E drejta për organizimin e arsimit dhe aftësimit për të rritur është e drejtë e institucioneve përkatëse dhe si e tillë e rregulluar dhe e garantuar me ligj. Përafrimi i legjislacionit nga kjo fushë, përkatësisht të këtij Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur me standardet ndërkombëtare, është një ndër prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në Raportin e Progresit 2012 është rekomanduar që ky ligj të përafrohet me standardet evropiane dhe kjo ka ndodhur me këtë projekt që jua kemi ofruar. Projektligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur përmban gjithsej 22 nene. Zbatimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për arsimin dhe aftësimin për të rritur parasheh implikime buxhetore, siç ishin edhe dy ligjet tjera. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si organ propozues i këtij akti ligjor, sipas dispozitave të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011, e ka zhvilluar procesin e konsultimeve paraprake dhe publike dhe konsultimi paraprak është zhvilluar qysh në fazën e parë të hartimit të projektit, kur janë konsultuar këto institucione: Ministria e Financave, ajo e Integritimit, Zyra Ligjore e Kryeministrit, Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Zyra për Planifikim Strategjik, Zyra për Informim e Qeverisë etj.

Debatet e konsultimet janë mbajtur nga data 6.3.2012. Po ashtu nga data 7.3.2012 është zhvilluar diskutim publik me të gjitha institucionet e lartpërmendura dhe kompetente për këtë projektligj. Nga data 28.3.2012 gjer më 8.4.2012, në faqen elektronike të MASHT-it është hapur një link i veçantë për diskutim publik dhe këto e kanë dhënë kontributin e vetë. Andaj, ky draft ose projektligj është ky që ju e keni përpara dhe unë kërkoj nga ju që ta votoni, duke u plotësuar me diskutimet dhe kontributin tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL, zoti Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Projektligji për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës është shqyrtuar nga Komisioni FunkSIONAL përkatës dhe si komision kemi vlerësuar se ky projektligj i plotëson të gjitha kriteret që të shkojë në lexim të dytë. Prandaj, i lus deputetët që ta miratojnë në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesit e grupeve parlamentare, Grupi Parlamentar i PDK-së, fjalën e ka zoti Vataj.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj të rëndësishëm. Ne jemi për miratim në parim dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin FunkSIONAL. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, Grupi Parlamentar i LDK-së, fjalën e ka zonja Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Lidhja Demokratike e Kosovës e ka parë ligjin me kujdes. E shoh se e ka ofruar pjesën e mirë të ndryshimeve, megjithatë mbetet mjaft punë, të cilën do ta japim në angazhim gjatë punës në komision. Megjithatë, edhe ty ky ligj nuk mund të mos e përmendim atë që u tha edhe më herët. Qeveria na del mjaft futuriste, sepse përmenden nga 22 nene të ligjit, e dalin më shumë se gjysma që nuk hyjnë fare në fuqi për 4-5 vjet. Kështu që me të vërtetë ndoshta është një nguti, edhe ajo jo e paqëllimtë, sa për t'u plotësuar pjesa e stafit, sa për t'u vendosur njerëzit e përzgjedhur. Ndërkohë që, ajo që është më esenciale, mbetet për një kohë tjetër. Megjithatë, ne jemi të prirë që ligji të shikohet me kujdes, ta marrë formën e nevojshme, me qëllim që kur të vijë në aplikim, ai t'i plotësojë këto nevoja për këtë kategori. Ne do ta vazhdojmë punën në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, fjalën e ka zoti Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryesues dhe të nderuar deputetë!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe i ka disa vërejtje ndaj këtij projektligji.

Vlen të përmendet një karakteristikë se këto projektligje që na kanë ardhur nga Ministria e Arsimit, kësaj here është mirë që kanë ardhur edhe me vërejtjet dhe me rekomandimet e aktorëve tjerë, të cilët kanë qenë të interesuar lidhur me korrigjimin e tyre, gjë që edhe neve na e ka lehtësuar punën, sepse kemi pasur mundësi të shohim edhe qëndrimet e aktorëve tjerë dhe vlerësimin e tyre se si do të bëheshin projektligjet më të mira kur të amendamentohen. Vërejtjet janë që nga ato lidhur me përkufizimet, për shembull, tek arsimi formal dhe joformal. Arsimi joformal thotë: “I referohet të nxënësve të jashtëm atij që ofrohet nëpërmjet programeve të përshkruara në përkufizimin arsimi formal”. Pra, kjo i bie që arsimi joformal është gjithçka që nuk është formal, në njëfarë mënyre gjithçka edhe asgjë, sepse nuk është qartë e precizuar se çka është. Mendoj se duhet të precizohet qartë se çka është arsimi joformal.

Po ashtu, kemi vërejtje të përkufizimit vijuese dhe kandidatët, që shpeshherë janë konfuze. Edhe në këtë projektligj, sikur në ato tjera, është krijuar hapësirë kur thotë: “MASHT-i me akt nënligjor i rregullon problemet e këtij projektligji”, domethënë është lejuar shumë hapësirë që me akte nënligjore të intervenohet në implementimin e këtij ligji.

Më duhet të pajtohem plotësisht edhe me kolegen paraprake, e cila thotë se nga 19 nene realisht, sa i ka ky projektligj, më tepër se gjysma e tyre nuk do ta shohin dritën e zbatimit deri në vitin 2016, pra edhe atëherë, po që se krijohen kushtet financiare për implementimin e tij. Në këtë kontekst, ne do ta miratojmë në parim këtë projektligj, por problemi është se mos po krijohet një ambivalencë juridike, kur një pjesë e ligjit zbatohet, kurse pjesa tjetër nuk zbatohet dhe krijohet konfuzion sa i përket aspektit juridik lidhur me këto probleme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, fjalën e ka zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Shumica e vërejtjeve u dhanë pak më parë, prandaj unë edhe një herë po e përmend se të gjitha këto tri projektligje që erdhën sot nga Ministria e Arsimit e kishin koston financiare, pra që u përmend që fillimi i implementimit të tyre do të jetë tek në vitin 2016.

Pra, e përmendi edhe parafolësi se veç në dy nenet e fundit, e unë po i lexoj nenet 20 dhe 21, që mendoj se duhet diskutuar, e shpresoj se me punën tonë në komision do të rregullojmë shumëçka. Përmenden dispozitat e neneve 3, 5, 6, 9, 10, 11, 12, 16, 17 dhe 20, që do të thotë 50% e neneve, sa ka aktualisht ë ligji, të cilat pra do të fillojnë të zbatuari në vitin 2016, po që se krijohen kushtet financiare dhe pas një vlerësimi ekzakt të koston financiare të periudhës vijuese.

Pastaj, e përmendi edhe parafolësi, se në nenin tjetër, në nenin 21, thuhet: “MASHT-i në konsultim me institucionet tjera nxjerr akte nënligjore për ta plotësuar dhe implementuar këtë ligj dhe për çështje që nuk rregullohen me këtë ligj në afat prej një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji”. Çka do të thotë, përmendet viti 2016, kurse thotë: “Me akte nënligjore do të bëjmë që të implementohet vetë ligji”. Pra, kemi shumëçka për të rregulluar në këtë

projektligj. Janë edhe disa çështje që ndoshta nuk u përmendën, janë programet trajnuese, të cilat akreditohen, pra duhet caktuar periudha kohore, në mënyrë që të ketë mundësi edhe për ndryshime të kohëpaskohshme.

Pastaj, u përmendën që duhet të harmonizohen disa lëshime. Përmenden fjalët “nxënës”, “vijues”, “kandidat”, duhet të unifikohen. Pastaj, janë rezultatet e mësimit. Nuk përmendet se nga kush do të bëhet vlerësimi. Edhe disa çështje të tjera. Por, megjithatë, prapë Aleanca e përkrah në parim dhe do të punojmë në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, fjalën e ka zoti Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari ministër,

Kolegë deputetë,

Ne e kemi shqyrtuar projektligjin në fjalë, për të cilin mendojmë se i adreson në mënyrë të duhur nevojat e kësaj kategorie. Vërejtjet tona konkretet do t'i japim në komisionin përkatës, kështu që ne do ta votojmë këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Për Grupin “6+”, fjalën e ka zoti Kervan.

ENIS KERVAN: Faleminderit, nënkryetar!

6+ Parlemtar Grubu olarak Yasa Tasarısını kabul ediyor, önerilerimizi mevcut komisyonda sunacağız.

KRYESUESI: Është radha e deputetëve, fjalën e ka deputetja Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për arsimin dhe aftësimin për të rriturit sigurisht është një ligj i nevojshëm dhe i rëndësishëm. Por, do të doja të them që edhe projektligjet e sponsoruara nga ministrinë tjera që vijnë në Parlament janë të pastrukturuara mirë dhe gjuhësisht me defekte të shumta.

Do të doja që pikërisht, ministria të cilën e drejtoni ju, zoti ministër, të jetë një model për ministrinë tjera për ofrimin e këtyre dokumenteve të përpiluara më mirë. Ju e flitni mirë dhe bukur shqipen, zoti ministër, por nuk do të thotë që ju të bëni lekturimin e këtyre dokumenteve, apo ta korrigjoni petkun gjuhësor dhe korrekt, mirëpo do të doja që këtë përvojë tuajën t'ua bartni personave që i keni në Ministri, apo ka edhe personave të tjerë të thirrur, që mund ta bëjnë këtë gjë shumë mirë, do të thotë, t'i sjellin tekstet të përpiluara më mirë. Dhe, për këtë gjë besoj që as ju nuk jeni kundër. Pra, do të doja të merrja vetëm një shembull, për të mos ju lodhur me shembuj të shumtë. E kemi nenin 2 tek arsimi informal, thotë: “nuk është i autoritetizuar”, të them të drejtën s'e kam dëgjuar dhe as se kam parë asnjëherë këtë fjalë. Është fjala për autoritet apo për autorizim? Do të thotë, të dyja nocione të ndryshme.

Mësimi informal është “i paqëllimshëm”, besoj që çdo gjë që bëhet edhe në mënyrë informale e ka një qëllim të vetin. Ndoshta, do të duhej një nocion tjetër, i rastësishëm apo i rastit, e kështu me radhë.

Vërejtjet i dhanë edhe shumë prej deputetëve, mirëpo nuk do të bëhej e tepërt t’i them disa. Ka kosto shtesë buxhetore dhe e thatë edhe ju që ky projektligj posedon 22 nene, mirëpo shumë dispozita të këtyre neneve, siç janë: 3, 5, 6, 9, 10, 11, 12, 16, 17 dhe 20, fillojnë tek në vitin 2016 dhe edhe atëherë është pikëpyetje se a do të jetësohen këto dispozita të këtyre neneve? Dhe, duke e parë kësisoj, mendoj që gjatë dhjetë vjetëve të ardhshme ky ligj të mos ketë një implementim të plotë. Por, meqenëse është një kërkesë e Raportit të Progresit dhe duke marrë parasysh vullnetin dhe përkushtueshmërinë e anëtarëve të Komisionit, besoj që në leximin e dytë do ta kemi një draft më të kompletuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur.

Në sallë janë 65 deputetë. Edhe ky projektligj duhet të votohet me votim të dyfishtë në bazë të Kushtetutës. Atëherë, siç u praktikua më herët nga kryetari, po vazhdojmë në të njëjtën mënyrë, që të konstatojmë sa deputetë të pakicave janë në sallë. Ju lutem, numrin e deputetëve.

Janë 10 deputetë. Ju lus që të votoni për së pari, pastaj kundër, nëse ka kundër ligjit në parim.

Përfaqësuesit e pakicave, a jeni për ta miratuar këtë shqyrtim të ligjit, që e bëmë deri tash, për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës? Votoni!

1, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, nga 10 deputetë 9 janë për. Konstatohet sipas rregullave dhe Kushtetutës. Tani votojmë ligjin në tërësi, nga të gjithë deputetët e pranishëm. Bëhemi gati për votim. Votojmë tani.

Konstatohet që me 63 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime. Ju lus që të mos dilni nga salla, meqenëse duhet t’i votojmë amendamentet dhe duhet që të ketë kuorum brenda.

Pika e katërmëdhjetë e rendit të ditës:

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve të Kuvendit, ta arsyetojë raportin me rekomandime. Zonja Safete Hadërgjonaj, e keni fjalën

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, menjëherë pas miratimit në parim të Projektligjit për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve, ka formuar Grupin punues në kuadër të Komisionit, i cili ka shqyrtuar të gjitha dispozitat e ligjit një nga një, në praninë e Ministrisë së Financave, ku kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit nga Ministria e Financave, meqenëse kanë qenë si sponsoruese e këtij projektligji.

Grupi punues ka hartuar amendamente, të cilat më tutje janë diskutuar një nga një në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni, të gjitha këto amendamente i ka miratuar njëzëri në Komision. Me këto amendamente të propozuara janë bërë rregullimet e nevojshme edhe përmbajtjesore teknike dhe gjuhësore dhe është harmonizuar i tërë teksti me teknikën juridike të hartimit të legjislacionit.

Meqenëse projektligji është votuar njëzëri nga të gjithë anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa, ftoj të gjithë deputetët që amendamentet, të cilat janë të propozuara të miratohen edhe në seancën plenare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka, miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? S'ka.

(Ndërhyrje)

Urdhëro! Mirë. Pse?

Në qoftë se jeni kundër, mund ta ngrini dorën.

Për amendamentin 2, a ka kundër? Atëherë votojmë me elektronikë. Votojmë tani!

Konstatohet se me 35 vota për, 17 kundër dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti i dytë.

Amendamenti 3. A doni ta votoni me elektronikë edhe këtë? Amendamenti i tretë - me elektronikë. Votojmë tani

Në sallë janë 63 deputetë. Me 29 për, 5 abstenime, 20 kundër, miratohet amendamenti i tretë.

Amendamenti i katërt, me elektronikë edhe këtë apo..? Ok. Amendamenti i katërt me elektronikë. Votojmë tani!

Më 31 vota për, 19 kundër, 5 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti i pestë, votojmë tani!

Me 29 vota për, 21 kundër, 2 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti i gjashtë, votojmë tani!

27 vota për, 15 kundër, 3 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti i shtatë, votojmë tani!

Më 33 vota për, 17 kundër, 3 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti i tetë, votojmë tani!

Me 32 vota për, 19 kundër, 4 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 64 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Konstatohet që me 33 vota për, 27 kundër, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve.

Kalojmë në pikën e radhës:

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zotin Damka, që para deputetëve të Kuvendit të arsyetojë raportin me rekomandime.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës e ka bërë amendamentimin e këtij projektligji. Ky projektligj gjithsej ka 5 amendamente, të cilat të gjitha komisionet funksionale i kanë përkrahur, vetëm për amendamentin e tretë nuk e kemi përkrahjen prej Komisionit për Legjislacion.

Por, Komisioni mendon se pasi që rregullorja e re ende nuk ka hyrë në fuqi dhe sipas Rregullores së vjetër kemi të drejtë të parashtrojmë amendamentet edhe në ligjin në fuqi dhe se amendamenti i propozuar është përmirësim i ligjit në fuqi dhe është i harmonizuar edhe me Ministrinë përkatëse.

Ashtu që, kërkoj prej deputetëve të përkrahin këto amendamente. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A dëshironi me elektronikë edhe këtë, Ismet? A po vazhdojmë? Mirë, atëherë zoti Hyseni e ka kërkuar fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit!

Mendova që megjithatë do të hapet debat, unë s'dua të ju marr kohë. E kuptoj momentin, por dua vetëm të tërheq vërejtjen në përshtypjen time, besoj që është edhe e atyre, që e kanë lexuar, se është një tendencë e ngushtimit të hapësirës së grevës.

E greva është një e drejtë elementare e njeriut dhe mendoj që gjatë amendamentimit duhet pasur kujdes që të mos lejohet kjo. Ne jemi të obliguar edhe me konventa ndërkombëtare që të drejtat elementare të njeriut t'i respektojmë. Dhe, apeli im është vetëm ky, të mos lejojmë që të cenohen ato, janë të drejta elementare që i duhen pikërisht sundimit të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL.

Në mbledhje janë 64 deputetë.

Amendamenti 1.

A ka kundër? 1 kundër. Miratohet.

Amendamenti 2, i Komisionit FunkSIONAL.

A ka kundër? 3 kundër. Miratohet.

Amendamenti 3. Komisioni FunkSIONAL, pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion.

A ka kundër? S'ka. Miratohet

Amendamenti 4.

A ka kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka. Miratohet.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Në mbledhje janë të pranishëm 65 deputetë. Votojmë tani.

Me 52 vota për, 2 abstenime, 1 kundër, Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për grevat.

Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës:

16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Metrologji dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti, që para deputetëve të Kuvendit, ta arsyetojë raportin me rekomandime, pra të Ligjit për metrologji. Faleminderit!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni për Zhvillim, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar Projektligjin për metrologjinë. Shfrytëzoj rastin ta falënderoj grupin punues, të gjithë deputetët e Komisionit dhe po ashtu të gjitha institucionet, që e kanë mbështetur, kanë punuar gjatë në amendamentet në këtë projektligj dhe po ashtu, duke ju treguar që Komisioni ka qenë unanim në mbështetje ose në aprovim të këtyre amendamenteve, ju ftoj po ashtu edhe grupet parlamentare dhe deputetët që ta mbështesin dhe t'i aprovojnë amendamentet dhe ligjin në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë nuk ka të tjerë të paraqitur. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në Komisionin Funksional.

Në mbledhje janë të pranishëm 65 deputetë.

Amendamenti 1

Kundër nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 3

Kundër nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër nuk ka,

Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër nuk ka,
Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 7.
Kundër nuk ka,
Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 8.
Kundër nuk ka,
Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 9.
Kundër nuk ka,
Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 10.
Kundër nuk ka,
Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 11.
Kundër nuk ka,
Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 12.
Kundër nuk ka,
Abstenim nuk ka, miratohet.
Amendamenti 13.
Kundër nuk ka,
Abstenim nuk ka, miratohet.

Amendamenti 14.
Kundër nuk ka,
Abstenim nuk ka, miratohet.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Në mbledhje janë të pranishëm 66 deputetë.
Votojmë tani!

Konstatohet se me 59 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës:

17. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit numër 03/L-049 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka mbikëqyrur zbatimin e Ligjit numër 03/L-049 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj, e ka fjalën për arsyetimin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka caktuar si raportues Xhevdet Nezirajn, meqenëse ka qenë kryetar i grupit punues gjatë monitorimit të këtij ligji.

Prandaj, kisha kërkuar që fjalën t’ia jepni Xhevdet Nezirit, kurse unë do të flas në emër të Grupit Parlamentar.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Neziraj e ka fjalën në emër të Komisionit, Safetja në emër të Grupit Parlamentar.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuari zoti kryesues,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, përveç punëve që ka si komision i përhershëm që të shqyrtojë projektligje për implementimin dhe implikimet buxhetore, ka marrë për detyrë të bëjë edhe monitorimin e ligjeve që kalojnë nga ky komision.

Prandaj, duke u bazuar në rregullën 73 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka autoritetin të mbikëqyrë zbatimin e ligjeve dhe Komisioni për Buxhet i ka dhënë prioritet Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit për dy arsye.

Arsyeja e parë është se në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2011 janë ngrehur disa çështje që kanë të bëjnë me këtë fushë.

Gjithashtu, Qeveria e ka paraparë në programin legjislativ ndryshimin e këtij ligji.

Prandaj, për këtë arsye, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka formuar një grup punues, i cili ka vizituar dhe monitoruar të gjitha institucionet që merren me zbatimin e këtij ligji.

Në përbërjen e grupit punues kanë marrë pjesë anëtarët e të gjitha grupeve parlamentare dhe në përbërje të këtij grupi ka qenë zoti Latif Gashi, nga PDK-ja, Jelena Bontiq, Hikmete Bajrami, Albana Fetoshi, dhe në të gjitha takimet ka qenë edhe kryetarja e Komisionit, Safete Hadërgjonaj.

Grupi punues ka vepruar në bazë të një plani të veprimit dhe ka përcaktuar subjektet që merren me implementimin e këtij ligji dhe janë vizituar këto institucione: Ministria e Financave, Njësia e Inteligjencës Financiare, Doganat e Republikës së Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, Prokuroria Speciale e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Grupi punues, gjatë monitorimit të këtyre institucioneve, ka ardhur në përfundim që ky ligj ka filluar të zbatohet, por zbatimi i tij ka pasur edhe zbrazëtira dhe ngecje, sepse bartja e kompetencave nga Qendra e Inteligjencës Financiare te Njësia e Inteligjencës Financiare është bërë nga qershori i vitit 2012 dhe Njësia e Inteligjencës Financiare tek tani vepron me kapacitet të plotë. Gjatë monitorimit, Komisioni për Buxhet ka dhënë këto rekomandime.

1. Ministria e Financave, në bashkëpunim me të gjitha institucionet përgjegjëse në zbatimin e Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit në proces të plotësim-ndryshimit të këtij ligji, të paraparë në programin legjislativ të Qeverisë për vitin 2012, duhet t'i përcaktojë saktësisht kompetencat e Njesisë së Inteligjencës Financiare sa i përket inspektimit, kurse sidomos janë vërejtur zbrazëtira në inspektimin e raportimin e bankave dhe institucioneve financiare dhe kazinove.
2. Të gjitha institucionet, të cilat janë të detyruar ta zbatojnë ligjin për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, t'i nxjerrin procedurat e brendshme të shkruara, apo t'i ndryshojnë dhe t'i plotësojnë ato ekzistuese.
3. Si rezultat i transformimit të kompetencave, institucionet përgjegjëse t'i rishikojnë marrëveshjet e tyre ndërinstitucionale sipas autorizimeve që dalin nga Ligji për parandalimin e shpëlarjes së parave.
4. Bordi menaxhues të funksionalizohet, ta mbikëqyrë dhe ta sigurojë pavarësinë e Njesisë së Inteligjencës Financiare, t'i shqyrtojë raportet e Njesisë së Inteligjencës Financiare dhe ta vëzhgojë dhe ta vlerësojë në mënyrë periodike performansën e drejtorit, siç kërkohet në nenin 5 dhe 6 të këtij ligji.
5. Gjithashtu, Njësia e Inteligjencës Financiar duhet të hartojë raport si dhe t'u japë rekomandime institucioneve përgjegjëse, të përcaktuar me nenin 14, paragrafin 1.8. Për masat që duhet të merren dhe për legjislacionin që duhet të miratohet, apo ndryshohet, për të luftuar shpëlarjen e parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste.
6. Ministria e Financave, në bashkëpunim me Njësinë e Inteligjencës Financiare, Prokurorinë e Shtetit dhe institucionet tjera janë përgjegjëse për zbatimin e ligjit, për parandalimin e shpëlarjes së parave. Në Projektligj, për ndryshim-plotësimin e këtij ligji të propozojë një nen të posaçëm që do të definonte çështjen e sekuestrimi të pasurisë së fituar nga veprat joligjore në kornizën e këtij ligji.

Dhe në fund, rekomandimi 7 është sipas nenit 29, mosdeklarimi i mjeteve monetare në vlerë në shumë prej 10 mijë eurove në rastin e hyrje-daljes nga Kosova konsiderohet

vepër penale, e cilat gjobitet në shumën prej 25% të vlerës së mjeteve monetare të padëklaruar.

Gjatë monitorimit, sidomos në Doganat e Kosovës, në këtë rekomandim është vërejtur se kryesisht janë gjobitur njerëzit, të cilët nuk kanë qenë të informuar. Gjithashtu, punëtorët ose njerëzit tanë që me mund dhe djersë i ka fituar këto mjete, prandaj parashohim që në legjislacionin për ndryshim të këtij ligji të shikohet nëse ato para janë fituar në mënyrë të ndershme, apo në forma të tjera. Nëse gjendet mënyra se si janë fituar, që nuk është në kundërshtim me ligjin, të mos sanksionohen më 25%, për arsye se goditen njerëzit, të cilët me mund dhe djersë kanë kontribuar për këtë vend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e dëshiron fjalën. Është radha e grupeve parlamentare. në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin me rekomandime të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe e ka vlerësuar punën e komisionit që ka bërë në monitorimin e këtij ligji, meqenëse ky ligj e rregullon një sferë shumë të ndjeshme në shoqëri dhe disa çështje që kanë të bëjnë me pastrimin e parave kanë qenë të përfshira edhe në Raportin e Progresit, i cili ka qenë i hartuar nga Komisioni Evropian, domethënë si shqetësime në këtë raport.

Raporti në përgjithësi përfshin problemet e identifikuar gjatë mbikëqyrjes, zbatueshmërisë së ligjit dhe ka identifikuar edhe kërkesat dhe nevojat për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji.

Kështu që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i ka analizuar me kujdes rekomandimet e dhëna nga Komisioni dhe kërkon nga Ministria e Financave t'i ketë parasysh me rastin e plotësimeve dhe ndryshimeve të këtij ligji, të cilin e ka paraparë edhe në strategjinë legjislative për këtë vit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e voton raportin me rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe ua rekomandon deputetëve që ta votojnë këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së, zonja Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ne si parti, duke qenë pjesë e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, kemi pasur rastin e mirë të njihemi me gjendjen në terren sa i përket zbatimit të tij.

Në raport janë përfshirë vërejtjet, pikëpamjet dhe rekomandimet tona, të cilat kanë derivuar pikërisht nga vizitat e takimet që janë bërë në terren.

U përmend edhe më herët që grupi punues ka qenë i hendikepuar, sepse procesi i mbikëqyrjes ka ndodhur paralelisht me procesin e transferimit të kompetencave nga Qendra e Inteligjencës Financiare në kudër të EULEX-it të Njësia e Inteligjencës Financiare, në kuadër të Ministrisë së Financave.

LDK-ja i përkrah konkluzionet dhe rekomandimet e komisionit se gjendja në terren nuk është e mirë. Kemi një sërë institucioneve që merren me këtë punë, ndërkaq mungon koordinimi i aktiviteteve. Meqenëse ligji është në agjendën e Kuvendit këtë vit, kompetencat e institucioneve duhet të definohen qartë.

Njësia e Inteligjencës Financiare duhet ta ketë të drejtën e inspektimit nëpër banka, në institucione financiare dhe kazino, sepse me ligjin e tanishëm këtij institucioni nuk i jepet kjo e drejtë.

LDK-ja e përkrah fuqizimin e Njesisë së Inteligjencës Financiare dhe nuk është për atë që kjo njësi të ketë vetëm rol administrativ karshi institucioneve të tjera që merren me zbatimin e këtij ligji, e që janë Doganat e Kosovës, ATK-ja, Banka Qendrore, Policia, Njësia për Krime Ekonomike dhe Prokuroria Speciale e Shtetit.

LDK-ja, gjithashtu, e përkrah idenë dhe kërkesën e Prokurorisë që me amendamentimin e ligjit të adresohet çështja sekuestrimit dhe çështja e përdorimit të provave të Njesisë së Inteligjencës Financiare si dëshmi në gjykatë.

Edhe një çështje tjetër që u përmend këtu dhe që është shqetësuese gjithashtu edhe për ne dhe është pjesë e raportit, është çështja e konfiskimit të parave në kufij, në pikat kufitare dhe aeroport, në rastet ku nuk deklarohen.

Marrja e 25% nga shuma e të hollave, edhe në rastet kur vërtetohet prejardhja e tyre, duket e padrejtë. Kjo dukuri mund t'i dëmtojë shumë bashkatdhetarët tanë, të cilët kursimet e veta i dërgojnë në Kosovë për t'i mbajtur familjet e tyre. Kjo përqindje është e madhe dhe duhet të rishikohet patjetër.

Meqenëse kompetencat nga Qendra e Inteligjencës Financiare në Njësinë e Inteligjencës Financiare, do të thotë nga EULEX-i në Ministrinë e Financave, në tërësi kanë kaluar më 1 qershor, ne mendojmë që Kuvendi, respektivisht Komisioni Funkcional, gjatë amendamentimit të ligjit do të ketë edhe më shumë informata dhe ne rekomandojmë që amendamenti i ligjit të bëhet me një proces të gjerë konsultativ me të gjitha institucionet e përmendura, të cilat gjatë punës së tyre duhet të zbatojnë nene respektive të këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zonja Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Sa i përket Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit gjatë monitorimit, që i është bërë këtij ligji në terren për të parë zbatimin apo moszbatimin e tij, është vërejtur që Njësia e Inteligjencës Financiare nuk i ka pasur

kompetencat e nevojshme që të veprojnë dhe për këtë arsye mendoj që puna në terren nuk është bërë për shkak se, edhe pse ky ligj ka hyrë në fuqi në vitin 2010, mendoj që deri në qershor të vitit 2012 kjo Njësia e Inteligjencës Financiare nuk i ka pasur kompetencat e nevojshme që ta kryejë punën e saj.

Këto kompetenca i ka pasur EULEX-si dhe për këtë arsye institucionet përkatëse që janë obliguar sipas ligjit ta kryejnë punën e tyre, nuk kanë pasur mundësi të veprojnë për shkak të mungesës së këtyre kompetencave.

Përveç mungesës së kompetencave, të cilat kanë bërë që kjo njësi të mos jetë funksionale, përfaqësuesit e këtij institucioni kanë prezantuar të metat e këtij ligji që është në fuqi, duke thënë se NIF-i, pra Njësia e Inteligjencës Financiare, në bazë të këtij ligji nuk ka të drejtë të bëjë inspektimin e bankave, institucioneve, mikrofinanciare dhe kazinove.

Pra, sa i përket të drejtës që të ketë në inspektimin e bankave, të institucioneve, mikrofinanciare dhe kazinove, Njësia e Inteligjencës Financiare ka shprehur shqetësimin e saj, duke kërkuar që ta ketë këtë të drejtë.

Konsiderojmë që Njësia e Inteligjencës Financiare duhet të ketë kompetencë ligjore që të bëjë inspektimin e këtyre institucioneve dhe njëkohësisht të lejohet që këto të dhëna t'i përdorë si provë në gjykatë.

Përfaqësues nga Ministria e Financave nuk janë pajtuar që kjo njësi ta ketë të drejtën e hetimit dhe të inspektimit, me arsyetimin se Prokuroria, ATK-ja Doganat dhe Policia i kanë njësitë e specializuara që merren me këtë çështje, pra në luftën kundër shpëlarjes së parave.

Nuk konsiderohet e tepërt që edhe kjo njësi t'i ketë këto kompetenca. Madje, konsiderojmë që duhet t'i ketë domosdoshmërisht, sepse pikërisht Njësia e Inteligjencës Financiare është institucione që do të duhej e para të merrej me luftën kundër shpëlarjes së parave, pasi mendoj se për këtë arsye edhe është themeluar ky njësiti.

Gjatë vizitës në Prokurorinë Speciale edhe ata e shprehën shqetësimin sa u përket të dhënave që i ofron NIF-i, por ato të dhëna përdoren vetëm si informacione, e jo edhe si prova. Pra, punën që e bën NIF-i, të njëjtën po e bënë e Prokuroria. Kjo i bie që këto dy institucione e kanë të njëjtën punë, kur mund vetëm njëra ta kryejë këtë, përkatësisht Njësia e Inteligjencës Financiare.

Sa u përket rekomandimeve të këtij raporti, e që kanë të bëjnë me saktësimin e kompetencave të NIF-it, lidhur me inspektimin, rishikimin e marrëveshjeve ndërinstitucionale sa u përket institucioneve përgjegjëse, definimin e çështjes së sekuestrimit të pasurisë së fituar nga veprat joligjore etj., Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” i përkrah këto rekomandime dhe raportin në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Së pari, ne të gjithë e dimë se ky ligj është vërtet me rëndësi tepër të madhe në pjesën e sundimit të ligjit, në sektorin e sundimit të ligjit dhe në luftën kundër krimit të organizuar, përkatësisht në parandalimin dhe luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe dua ta përgëzoj edhe komisionit në tërësi, edhe grupin punues, për punën dhe angazhimin që e kanë bërë dhe rekomandimet që i kanë nxjerrë.

Ne si Grup Parlamentar i Aleancës, definitivisht do t'i mbështetim rekomandimet që kanë ardhur nga grupi punues dhe nga komisioni. Por, në të njëjtën kohë kërkojmë me insistim që rekomandimet që i ka bërë grupi punues të mos mbeten vetëm në letër, të mos mbeten dhe të harrohen aty, por definitivisht të përfshihen patjetër në fazën e re të ndryshim-plotësimit të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i cili tashmë është në agjendën e Qeverisë dhe të Ministrisë së Financave.

Pra, këto rekomandime duhet të përfshihen sepse dëshirojmë ta kenë edhe votën e Aleancës në ndryshim-plotësimin e ligjit në fjalë.

Grupi i Aleancës i voton rekomandimet dhe do të doja të them që edhe ky komision, por edhe grupi punues, tashmë e kanë edhe një barrë të re që ta ndjekin me vëmendje se çka po ndodh me këto rekomandime, a po përfshihen ato në ndryshim-plotësim të ligjit dhe të njëjtën kohë të insistojnë, besoj edhe në qartësimin dhe zgjerimin e këtyre kompetencave për pjesë, ose njësi për të cilat po flitet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Duke marrë parasysh punën e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe grupit punues në punën e tij për shikimin e implementimit të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave, mund të themi se Komisioni për Buxhet dhe grupi punues e kanë bërë një punë shumë të mirë, në një.

Nën dy, rekomandimet të cilat i ka dhënë Komisioni Parlamentar mund të themi se janë rekomandime të cilat Ministria e Financave duhet t'i marrë shumë seriozisht për arsye se janë parë mjaft mirë problemet e identifikuara gjatë implementimit të ligjit.

Fatbardhësisht, rekomandimet e japin në mënyrë shumë të saktë çështjen e implementimit të ligjit, ku si rekomandim, Komisioni Parlamentar ka nxjerrë 7 rekomandime dhe prej këtyre rekomandimeve shihet mjaft qartë se, duke u bazuar në rekomandime, ky ligj duhet të pësojë ndryshime për arsye se ka probleme, mirëpo prapëseprapë mund të themi se në esencë janë parë dobësitë, të cilat e kanë krijuar mundësinë që Ministria të mos mund ta zbatojë, jo ndoshta edhe për arsye të veta, por për arsyet, të cilat janë theksuar në këtë raport.

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah raportin e Komisionit Parlamentar dhe i falënderon deputetët që e kanë bërë atë. Mirëpo, njëkohësisht kërkon nga Ministria, e fatkeqësisht që ministri nuk është këtu, që ky ligj të zbatohet për arsye se kemi edhe vërejtje nga Komisioni Evropian. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të tjerë të paraqitur nuk ka.

Vazhdojmë me votimin e raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit numër 03/L-049 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Në sallë janë të pranishëm 68 deputetë. Votojmë tani!

Konstatoj se me 59 vota për, një kundër dhe një abstenim, Kuvendi e miratoi raportin me rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit numër 03/L-049 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Mirupafshim nesër!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë